



Shkodër, 2011

**Përkthyes:** Evans Drishti  
**Redaktor:** Irida Hoti  
**Konsulent teologjik:** Elona Sytari  
**Titulli original:** Asr-1 Saâdet Toplumu



**PROGRESI** sh.p.k. \_\_\_\_\_

**Adresa:** L: Vasil Shanto Rr: Çajupi Shkodër / Shqipëri  
**Tel:** +355 22 25 46 34 **Fax:** +355 22 25 46 33  
**Mob:** +355 69 20 76768 **Mob:** +355 67 20 86767  
**http:** www.progresibotime.com **e-mail:** botime@progresibotime.com  
**Design:** Bledar Xama

---

**Adresa Kosovë:** Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren  
**Mob:** +377 4411 98 48 **Fax:** +381 29 222 797  
**e-mail:** kosova@progresibotime.com

---

**Adresa Maqedoni:** Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup  
**Tel:** +398 71 956 271 **e-mail:** maqedoni@progresibotime.com

*Shoqëria*  
*e epokës*  
*së lumturisë*

OSMAN NURI TOPBASH



## PARATHËNIE

*Falënderime të pafundme i qofshin Zotit tonë që na mundësoi të jemi pjesë e bashkësisë Muhamedane dhe e bëri atë shembullin e moralit më të mirë për njerëzimin.*

*Salate dhe selame i dërgojmë të Dërguarit të Tij, i cili i lartësoi sahabët si yjet në qiell dhe i dhuroi njerëzimit një shoqëri të lumtur, shembulli i së cilës nuk gjendej askund.*

**Epoka e Lumturiisë** do të thotë periudha e qetësisë dhe e lumturiisë, epoka në të cilën njerëzit kanë qenë më të lumtur.

Epoka e Lumturiisë është periudha në të cilën zbriti Kurani si udhëzues për mbarë njerëzimin dhe ku nderoi me qenien e tij vetë i Dërguari i Allahut ﷺ; si mëshirë për gjithë njerëzimin. Ajo është një periudhë që përçon në shekuj dritën peygamberore, është një kohë që ka edukuar brezin shembullor të sahabëve që ndërtuan qytetërimin e virtyteve, duke e ngritur atë në shkallën më të lartë të etikës dhe humanizmit në historinë e botës.



Epoka e Lumturisë shpesh ka përfshirë në të edhe periudhat e Hulefa-i Rrashidin, Tabiinëve dhe Tebe-i Tabiinëve.

Pejgamberi ﷺ ka thënë:

*“Më të vlefshmit e bashkësisë sime janë ata që jetojnë në kohën time. Më pas ata që ndjekin këta dhe më pas ndjekësit e tjerë...”* (Buhari, Ashabu'l Nebi, 1.)

Nisur nga kjo, Epoka e Lumturisë është koha më ideale. Është ajo periudhë e historisë islame, e cila do të përkujtohet vazhdimisht me admirim të madh.

Ka disa komentues të cilët shprehen se Sureja Asr, përveç kuptimit të saj mbart në vetvete edhe kuptimin tjetër të betimit në “Epokën e Lumturisë”. Kjo epokë është koha kur u ndanë prerazi nga njëra-tjetra e vërteta dhe e shtrembërta.

Epoka e Lumturisë nuk ishte një periudhë e lumturisë, e qetësisë dhe mirëqenies për kohën dhe nefsin. Përkundrazi ishte një kohë plot sakrifica dhe përpjekje ku jeta bëhej në kushte shumë të vështira. Ajo ishte një periudhë në të cilën njerëzimi, i cili kish-te rënë pre e dhunës dhe forcës, u lartësua me etikë dhe drejtësi, u përjetua rimëkëmbja më e madhe, vendin e errësirave epshore e zunë shpirtat e ndritur dhe shpirtat shpëtuan nga robëria, pra njerëzit



arritën lumturinë e duhur dhe qetësinë shpirtërore.

Për të njohur bukuritë e pafundme të Islamit, i cili e nxori njerëzimin nga errësira në dritë, duhet të bëhemi pjesë e Epokës së Lumturisë.

I nderuar lexues!

Me anë të këtij punimi, i cili është një përmbledhje e disa artikujve të mëparshëm, përfshi këtu edhe disa shkrime të reja, synuam të konceptonim më mirë atë epokë të mrekullueshme. Nisur nga ky qëllim, dëshiroam që nëpërmjet disa shembujve shumë domethënës të asaj periudhe të zbardhnim çështjen në fjalë duke treguar se ç'zhvillime të mahnitshme ka patur besimi, adhurimi, veprat dhe etika.

Falënderojmë me këtë rast birin tonë. Dr. Murat Kaja për punën e bërë në përgatitjen e këtij materiali duke iu lutur Zotit që këtë shërbim që ka bërë ta pranojë si sadaka e veprave të mira.

**Osman Nuri Topbash**

Dhjetor 2009

Yskydar







بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

وَالسَّائِقُونَ الْاُولُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْاَنْصَارِ وَالَّذِينَ  
اتَّبَعُوهُمْ بِاِحْسَانٍ رَضِيَ اللهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ

*"Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve  
dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me  
të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e për-  
kushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë..."*  
(Tevbe, 100)



# SHOQËRIA

E EPOKËS SË LUMTURISË



## SHOQËRIA E EPOKËS SË LUMTURISË

Njerëzimi, në kohën e injorancës, ishte varrosur në një errësirë të sterrshme. Injoranca ishte rrënjosur thellë, anormaliteti dhe ashpërsia kishin arritur çmendurinë, shpifja dhe përçarja ishin rishfaqur dhe bërë si hijet e fantazmës, ndërsa shkretëtirat ishin kthyer në liqene gjakrash si rrjedhojë e gjakmarrjeve.

E drejta i përkiste përherë të fortit. Kush e merrte forcën në dorë bëhej mizor dhe i shtypte të dobëtit dhe të vetmuarit e shoqërisë. Po jetohej ai tmerr që kishte thënë i ndjeri Akif:

*“Një njeri pa dhëmbë? Atë e hanin vëllezërit e tij...”*, të burgosurit e nëpërkëmbur bënë një jetë të dhimbshme, ata përpiqeshin të jetonin.

### **Parimet e besimit në kohën e injorancës e poshtëronin njeriun e kohës**

Ishte thyer besimi i vërtetë. Një pjesë e njerëzve besonin se një fuqi hyjnore që, më shumë se prej tyre vinte nga një Allah, të cilit i besonin prej së largu, kishte zbritur në qeniet natyrore si guri, mali,



zjarri, pema, kodra etj ishin shfaqur tek ata duke u dhënë një madhështi hyjnore. Kishte nga ata që i besonin diellit, yjeve. Ata pandehnin dhe shpresonin në të njëjtën kohë se do lidheshin me Allahun ﷻ, ndërkohë që u besonin atyre.

Një pjesë tjetër e njerëzve adhuronin qeniet jofizike si engjëllin, xhindin dhe shejtanin. Ata mendonin, se me kryerjen e një adhurimi të tillë i respektonin plotësisht ato dhe kështu do ndërmjetësoheshin nga Allahu ﷻ.

Nga njëra anë kishte nga ata që pretendonin se i besonin Allahut ﷻ, nga ana tjetër kishte nga jobesimtarët që i bënë shok Allahut ﷻ me gjërat që bënë me duart e tyre. Megjithëse pretendonin të ishin “Bijtë e Ibrahimit dhe të Ismailit”, e kishin lënë besimin e “tevhidit” të sjellë prej tyre dhe ishin ndarë nga rruga e Hanefizmit. Këta i bënë shok Allahut ﷻ çdo gjë që u vinte në mendje.

Kishte edhe nga mohuesit, të cilët e mohonin plotësisht Allahun ﷻ dhe ditën e gjykimit dhe besonin se çdo gjë është kjo që shihet në këtë botë.

Babai prej qumështi i Pejgamberit (a.s.), Haris, pas shpalljes së Profetësisë, vjen për vizitë tek i Dërguari i Allahut ﷻ në Mekë. Mushrikët Kurejshitë e pyetën:

- A nuk e ke dëgjuar o Haris se ç’thotë ky djali yt?



- Çfarë thotë?

- Hedh tezën se Allahu ﷻ do t'i ringjallë njerëzit pasi të vdesin. Thotë gjithashtu se Allahu ﷻ ka përcaktuar dy vende, Xhenetin dhe Xhehenemin dhe ata që i dalin kundër do të vuajnë aty, ndërsa ata që i binden do të shpërblehen me të mira. Me këto teza që hodhi na prishi rregullin dhe na shpërndau grupimin.

Haris vjen tek Pejgamberi ﷺ duke i shprehur mendimet e mushrikëve:

- Biri im, ku qëndron problemi me popullatën? Ata ankohen për ty. Thonë se u paske thënë që njerëzit do ringjallen pas vdekjes dhe se më pas do të shkojnë ose në Xhenet ose në Xhehenem.

I Dërguari i Allahut ﷺ iu përgjigj:

*- Po baba, unë besoj kështu dhe këtë ua them edhe njerëzve! Ah sikur të arrij të ta shpjegoj edhe ty të vërtetën e kësaj fjale!*

Haris më pas u bë mysliman dhe me kalimin e kohës filloi të merrte frytet e Islamit. Pasi hyri në Islam, Haris thoshte:

- Ah sikur biri im të më merrte për dore dhe të më tregonte të vërtetat e atyre fjalëve! Me lejen e Allahut ﷻ të mos më linte në asnjë vend, deri sa të më dërgonte në Xhenet! (Ibn-i Ishak, Siret, fq 218; Suhejli,

Ravdu'l Unuf, 1, 284-285.)

Si përfundim, njerëzit në kohën e injorancës u ishin futur shumë besimeve të gabuara. Ata binin në gjendje mjaft qesharake duke përçmuar virtytet më të larta njerëzore, si mendjen, konceptimin, vetëdijen dhe meditimn. Kështu, jetohej një dramë e rëndë njerëzore.

Është e vështirë të gjesh një mendim të drejtë dhe një ide të saktë. Idetë e gabuara kanë marrë udhën. Për rrjedhojë, gruaja në shoqëri është shtypur, nënat janë përbuzur, ndërsa vajzat janë pranuar si qenie të turpshme.

Një ditë, njëri nga sahabët erdhi tek Profeti ﷺ dhe i tha:

- O i Dërguari i Allahut! Ne ishim pjesë e kohës së injorancës. Ne u besonim ikonave dhe i varrosnim vajzat tona për së gjalli. Unë kisha një vajzë të vogël, e cila më donte pa masë. Më donte aq shumë, sa që kur e thërrisja, thuajse fluturonte nga gëzimi dhe vinte me vrap tek unë. Një ditë e thirra. Erdhi me të shpejtë pranë meje dhe filloi të më ndiqte nga pas. Eca deri sa arrita tek një pus i familjes sonë. E mora vajzën dhe e hodha në pus. Fjalët e fundit të saj ishin ulurimat e saj: babi, babi!

Me të dëgjuar këto fjalë, Pejgamberi ﷺ nisi të qante. Një nga sahabët, që ndodhej aty, duke parë



Profetin ﷺ, nisi të zihej me sahabiun që po rrëfente ndodhinë duke i thënë:

- O ti njeri! E mërzipte të Dërguarin e Allahut!

Profeti ﷺ ndërhyu dhe tha:

- *Mos e pengoni atë! Ai do të pyesë diçka shumë të rëndësishme dhe t'i japë fund mërzitjes dhe vijoi:*

- *Përsëriti ato që the. Sahabiu me t'i përsëritur fjalët që tha Profeti ﷺ, përsëri nisi të qante. Lotët ranë në mjekër. Më pas vijoi e tha:*

- *Allahu ﷻ ua fali gabimet që bënë mysli-manët në kohën e injorancës. Tani fillo një jetë të re!* (Darimi, Mukaddime, 1.)

Siç shihet, njerëzimi kishte ardhur deri buzë zjarrit. Jeta sociale në aspektin shpirtëror ishte shkaktërruar. Ardhja e Islamit i shpëtoi nga ky rrezik duke krijuar kështu shoqërinë e Periudhës së Lumturisë. Allahu ﷻ thotë:

**“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të**



**drejtoheni në udhën e drejtë.”** (Al-i Imran, 103.)

### **Adhurimet dhe veprat qenë bërë kurban të Interesave të së përbotshmes**

Shumica e adhurimeve qenë harruar. Pjesa që kishte mbetur u keqinterpretua dhe u shtrembërua. Disa adhurime si: haxhi, umreja apo kurhani, qenë mbështetur dhe madje u përkufizuan në bazë të disa besimeve të gabuara dhe të interesave përkatëse. Madje kanë vlerësuar më shumë imoralitetin me mendimin se po i japin rëndësi adhurimeve. Ata i detyronin haxhinjtë të bënin tavaf lakuriq. Më pas, ata po e rritnin më tepër krenarinë dhe mendjemadhësinë e tyre duke u dhënë veshje.

E vetmja formulë e veprave ishte fuqia. E drejta dhe përparësia i përkiste të fortit, i dobëti s’kishte asnjë të drejtë. Në shoqëri s’kishte siguri dhe qetësi.

### **Cilësitë e pashmangshme morale qenë të distancuara nga e vërteta**

Ka disa parime, si pjesë e cilësive të moralit, të cilat i kanë qëndruar kohës dhe janë shndërruar në interesa epshore. Ose janë tejkaluar ose janë dobësuar. Virtytet janë kthyer në të plotfuqishme. U bënë shpenzime të tepërta në emër të bujarisë, vajzat varroseshin të gjalla duke u bërë kështu krimet më të rënda në botë, në emër të nderit.





Po, njeriu i kohës së injorancës ishte i fortë dhe nuk e ndante prej vetes pushkën. Kurajoja dhe guximi qenë bërë pjesë e natyrës së tij, por fuqia e tij matej me numrin e njerëzve që vriste në emër të nderit të fisit të tij. Kurajoja buronte nga egoizmi. Nën kurajon dhe guximin e tij fshihej dëshira për të dëshmuar superioritetin individual dhe farefisnor. Për rrjedhojë, luftrat e pafundme mes farefiseve i shkatërronin ato si materialisht, ashtu edhe shpirtërisht.

Islami i hoqi zakonet e gabuara të shoqërisë së injorancës dhe solli parimet jetike më të mrekullueshme. Njeriu i kohës së injorancës doli nga kontrolli dhe inatin e tij e vuri në dukje me cilësi të larta si: durimin, të vërtetën dhe drejtësinë. Ai e racionalizoi kurajon e pavetëdijshme, duke e pastruar nga ndjeshmëritë dhe ndjesitë epshore. Kurajon epshore e vuri në shërbim të qëllimeve pozitive. E mësoi atë ta çonte në vend drejtësinë dhe ta përdorte për qëllime të larta.

Njeriu i kohës së injorancës ishte **bujar** dhe **mikpritës**. Qëllimi i këtyre virtyeteve që përgatitja e një terreni për një adhurim të shëndetshëm. Ideali më i lartë ishte respekti, fama me kurajo dhe vullnet, përhapja e frikës dhe e admirimit mbi njerëzit. Prandaj, në një çast, priteshin gjashtë apo shtatë dele, u merreshin mushkëritë me të cilat bëheshin qebapë ndërsa pjesa që mbetej hidhej.

Islami e çoi më tej bujarinë dhe mikëpritjen



duke u dhënë atyre nuanca etike. Myslimanët nuk tregoheshin bujarë sa për sy e faqe, përkundrazi synonin vetëm pëlqimin e Allahut ﷻ. Në zemrat e njerëzve ishte rrënjësuar ideja se Allahu ﷻ është **“Zotëruesi i çdo gjëje”**.

Për rrjedhojë, çdo gjë në të vërtetë i përket Allahut ﷻ, njeriu është thjesht një amanetqar<sup>1</sup> me të drejta të kufizuara shpenzimi. Prandaj, pasuria dhënë njeriut si amanet është e nevojshme të përdoret në atë mënyrë që Allahu ﷻ të mbetet i kënaqur dhe në rrugën që Ai ka treguar. Përdorimi i pasurisë së Allahut ﷻ në shërbim të robërve të Tij, është një shërbim që i bëhet Krijuesit të gjithësisë në respekt të krijesave.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

*“Dora që jep është më me vlerë se ajo që merr”*<sup>2</sup>, por e rëndësishme ishte që të jepej vetëm për të fituar pëlqimin e Allahut ﷻ, larg egos dhe përfitimit material. Në Kuran thuhet: **“Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!”**<sup>3</sup>

Islami e ndaloi edhe shpenzimin e tepërt. Në atë periudhë nuk shpenzohej me tepri qoftë edhe një pjesë nga mishi i deles, i prerë me ndjenja bujarie.

1. Shih: Al-i Imran, 26; en-Nur, 33
2. Buhari, Vasaja, 9; Muslim, Zekat, 97.
3. El-Insan, 9.



Kishte edhe nga ato raste, kur për shkak të kësaj bujarie, një dele kurhani sillej në shtatë familje dhe mbërrinte sërisht aty ku kishte nisur.

Jeta e shkretëtirës e kishte drejtuar njeriun e periudhës së injorancës në idenë e një **lirie** fillestare. Ata s'njihnin asnjë lloj autoriteti dhe dilnin kundër tyre dhe për rrjedhojë, s'kishte asnjë drejtori qëndrore. Grupimet sociale në raste të rralla i tejkalonin grupimet farefisnore. S'kishte një rregull drejtësie, as si sistem dhe as si institucion. Mosmarrëveshjet ose i kalonin ndonjë gjyqtari të përcaktuar ashtu si me ngut ose përfundonin me armë dhe me forcë.

Islami, vetëm për një pjesë të njerëzve ka dalë kundër idesë së një lirie të pranueshme dhe të kufizuar. Shpallja e Kuranit se, një rob besimtar është më me vlerë se një mosbesimtar i lirë<sup>4</sup> i çmendi jobesimtarët. Prandaj reagimi më i madh ndaj Islamit erdhi nga shtresa e terroristëve të quajtur të lirët. Ata e kishin njoftuar Pejgamberin ﷺ se do uleshin në bisedime, megjithëse i kishin përzënë robërit dhe Allahu ﷻ e kundërshtoi kategorikisht.<sup>5</sup>

Etika Islame fillimisht e drejtoi çështjen në aspektin shpirtëror dhe idenë e lirisë e shtroi në këndvështrimin etik. Islami solli masa që do t'i siguronin njeriut që vetë ky i fundit të kufizonte lirinë

4. Shihni, el-Bakare, 221.

5. Shihni: el-Kehf, 28.

në shpirtin e tij. Në një ajet thuhet:

“**Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.**” (Kaf, 16)

“**A nuk e dinë ata se Allahu di çfarë fshehin dhe çfarë shpallin?!**” (el-Bekare, 77; el-Enam, 3)

Prandaj njeriu është i detyruar t’i kontrollojë veprimet e tij. Kjo ide themelore solli një ndryshim të thellë dhe po aq të shpejtë në shpirtin e njeriut të periudhës së injorancës, në botëkuptimin e jetës dhe në vlerat përkatëse. Tashmë njeriu ishte vënë nën autoritetin mbinjerëzor, duke hyrë nën urdhrat e shpirtit dhe të vullnetit të vet. Tashmë s’ishte e nevojshëm përdorimi i forcës në rast mosmarrëveshjeje, pasi mjaftonin ligjet e Allahut ﷻ dhe thëniet e të Dërguarit. Të gjithë myslimanët kishin pranuar se ishte e nevojshme “bindja ndaj Allahut ﷻ, të Dërguarit dhe dijetarëve të mëdhenj.”<sup>6</sup>

Në periudhën e injorancës **ndihma** dhe **solidariteti** nuk i kalonin kufijtë e zbarkimit në praktikë. Individu nuk dilte jashtë kufijve të rrethit të tij farefisnor. Njeriu i periudhës së injorancës ishte i pamëshirshëm për të tjerët, në varësi të afrimitetit farefisnor. Njerëzit dhe qeniet kishin vlerë në syrin e tij, për sa kohë që përfitonte prej tyre. Për rrjedhojë, në kohën e injorancës nuk njihesh asnjë kufi

që të parandalonte njerëzit të grabisnin pasurinë e tjetrit. Ata nuk hezitonin të grabisnin edhe pagesat e punëtorëve përkatës.

Islami, e ndërtoi ndihmesën dhe solidaritetin, mbi bazën e një dashurie njerëzore dhe mëshirës, të lartësuar me parimet e moralit. Islami u mësoi të gjithë njerëzve të mbledhur nën petkun e besimit islam, t'i shihnin gjërat me syrin e vëllazërisë dhe t'i pranonin ato si të ishin pjesë të trupit të njeriut.<sup>7</sup>

I Dërguari i Allahut ﷺ, një ditë tha:

*“Ndhmoje vëllain tënd, qoftë ai edhe dhunues edhe i dhunuar”* Myslimanët, me të dëgjuar këtë fjalë, u habitën shumë që një fjalë e tillë dilte nga goja e të Dërguarit të Allahut ﷺ, fjalë e cila më parë, kishte qenë një parim bazë i racizmit dhe ndërkaq, njëri prej tyre pyeti:

O i Dërguar! Unë e ndihmoj vëllain tim nëse ai është i vuajtur, por si mund ta ndihmoj nëse ai është dhunues? I Dërguari dha këtë përgjigje të mahnitshme që shprehte një prej tipareve të botëkuptimit islam:

*- E ndihmoni atë t'i shmanget dhunës. Padyshim që kjo, është një ndihmesë për të.* (Buhari, Mezalim, 4; Ikrah, 6; Veçanërisht shihni Tirmidhi, Fiten, 68.)

Kështu, Islami ndreqi botëkuptimin e gabuar

7. Shih: Buhari, Edep, 27.



të “ndihmesës” në etikën e periudhës së injorancës duke i dhënë asaj thelbin e duhur. Tashmë, ndihmesa ekzistonte vetëm për çështjen e “mirësisë dhe të devotshmërisë”, kurse ndihmesa në çështjen e “së keqes dhe armiqësisë” ishte ndaluar rreptësisht.<sup>8</sup>

### **Mrekullia e madhe e Profetit ﷺ: Njeriu i Epokës së Lumturisë**

**Kurafi** (v 684), si një nga figurat më të rëndësishme të metodologjisë së jurisprudencës islame, dha një përkufizim të tillë:

*- I Dërguari i Allahut ﷺ edhe sikur të mos kishte pasur asnjë mrekulli, do mjaftonin sahabët për të vërtetuar Profetësinë e Tij.*

I Dërguari ﷺ, me etikën hyjnore dhe edukatën e Tij që i solli gjithë njerëzimit, ndikoi aq dukshëm, saqë shoqëria e periudhës së injorancës, pjesa më e madhe e së cilës ishte gjysëm e egër, brenda një kohe të shkurtër solli një qytetërim të lartë virtutesh, me të cilin historia e njerëzimit akoma edhe sot mburret. Njerëzit injorantë u bënë të kulturuar, ata të egrit u bënë të qytetëruar, kriminelët u bënë njerëz të sakrificës të cilët jetonin me frikën ndaj Allahut ﷻ.

Mendoni një njeri, i cili ia merr dhunshëm fosh-

njën e saj nënës dhe me një zemër të ngurtë dhe antinjerëzore, e vorros atë për së gjalli... Ky është aq mizor, saqë skllaven që ka zënë në dorë, e koncepton si një mall të çfarëdoshëm dhe çdo sjellje antinjerëzore ndaj saj i duket normale.

Ja pra, këta njerëz të pavetëdijsëm dhe mizorë, me t'u udhëzuar në rrugën e islamit, formohen në dije dhe edukatë, duke sjellë një qytetërim virtutesh. Këta njerëz, të cilët arritën shkallën më të ulët të njerëzimit dhe të qytetërimit në periudhën e pavetëdijes, me t'u pajtuar me ligjet dhe moralin islam, arritën shkallën kulmore, sikurse pika kulmore e malit Everest.

### **U formuan njerëz të paharrueshëm**

Shoqëria e asaj kohe, e cila për shekuj me radhë nuk arriti dot të arsimonte qoftë edhe një njeri të vetëm, në sajë të edukimit dhe udhëzimit shpirtëror të të Dërguarit të Allahut ﷺ, nxori shumë personalitete të shquar, të cilët u bënë shembull për njerëzimin. Frytet dhe begatitë që morën nga Kurani dhe Suneti e përcollën në katër anët e botës si fryt besimi, dijeje dhe mençurie. Ata nuk u lodhën dhe as nuk u treguan skeptikë. Shpirtrat e tyre u bënë vendstrehim shpirtëror. Zemrat u bënë “këndvështrime të krijesave me syrin e Krijuesit”. Drita që ra në shkretëtirë rrezatoi drejtësi për gjithë njerëzimin,



duke marrë pafundësinë nën krahët e mëshirës.

Besimtarët e Epokës së Lumturisë, të rritur dhe edukuar me etikën e të Dërguarit, si shembulli më i mrekullueshëm për gjithë njerëzimin, nuk ishin miqtë e Allahut ﷻ dhe të Dërguarit të Tij ﷺ vetëm në dukje, përkundrazi ishin të tillë edhe me zemër, edhe me dije edhe me urtësi edhe me mëshirë edhe me modesti. Ajo ishte Epoka e njohjes nga afër të Allahut ﷻ dhe të Dërguarit të Tij ﷺ me një meditim të thellë.

Sahabët vunë **tevhidin** në qendër të mendimit dhe idealit. Ata arritën të mposhtnin interesat e kohës, lëkundjet epshore dhe kënaqësitë e rrënjosura në zemrat e tyre. Pasuria dhe shpirti nuk ishin thjesht qëllim, por më shumë se kaq, ishin një mënyrë jetese. U shijua kënaqësia e besimit. **Mëshira** u pasurua. **Shërbimi** u bë mënyrë jetese. **Personaliteti islam** u prezantua me një përpjekje dhe sakrificë të madhe. Sahabiu, megjithëse sakrifikonte shumë me udhëtime që zgjatnin edhe një muaj, për të transmetuar qoftë edhe një hadith të vetëm dhe ndërkohë që po shihte transmetuesin, i cili po e mashtronte kalin e tij me një torbë boshe ushqimi për kafshë, nuk e pa të arsyeshme të merrte hadith për shkak të karakterit të tij të dobët.

**Ebu'l Alije**, si një nga imamët më të mëdhenj të Tabiinëve, tregon një tjetër shembull të këtij tipi dallues të Islamit:





Kur shkonim tek filani për të mësuar hadith, uleshim pranë tij dhe shihnim mënyrën si falej, me mendimin se, nëse falej në rregull edhe punët e tjera duhet t'i bënte në rregull, por nëse falej gabim, edhe punët e tjera i bënte gabim dhe kështu largoheshim prej tij. (Darimi, Mukaddime, 38/429.)

### **Ç'kishin marrë sahabët nga i Dërguari i Allahut ﷺ?**

1. Reflektim (Të qenët shumë pranë të të Dërguarit një rrjedhë intensive e begatisë).

2. Edukimi farefisnor. Pra edukimi në njohjen e Tij me zemër.

Tek sahabët ishte krijuar një botëkuptim i ri lidhur me Allahun ﷻ, gjithësinë dhe nefsin. Qëllimi i tyre madhor ishte të ndodheshin sa më pranë të Dërguarit me sa të kishin mundësi, sikurse tejçimi i rrezeve të diellit në një pasqyrë të vogël, në sajë të së cilës e mira dhe e vërteta në jetën e tyre u shfaq dukshëm me të gjitha bukuritë, ashtu sikurse e keqja dhe e shtrembëta me të gjithë shëmtitë. Në çdo sjellje dhe frymëmarrje kërkimi i pëlqimit të Allahut ﷻ u bë parim jetësor.

Ata ishin bujarë dhe të mëshirshëm, ishin njerëz të shërbimit, të sakrificës, të përkushtimit dhe të etur për adhurim...



Sahabët në Mekë përjetuan një provë besimi. Ata mposhtën çdo lloj pengese që ndalonte besimin e tyre. Kur ishte e nevojshme sakrifikonin edhe pasurinë edhe shpirtin e tyre për të pasqyruar identitetin islam. Ndjesia dhe emocioni i besimit që përjetohej në Mekë, përgatiti të ardhmen e qytetërimit të pashembullt në Medinë, botën shpirtërore dhe terrenin e një atmosfere shpirtërore.

Kështu u ndërtua një shoqëri islame që u jepte qetësi gjithë krijesave të Allahut ﷻ. Shkretëtirat e përvëlura nga zjarri i shpifjeve gjetën qetësi, madje edhe pemët ranë në qetësi, u rrit gjelbërimi. U ndalua këputja pa vend e një dege peme. Me vizionin e drejtësisë dhe së vërtetës që solli Islami, edhe gjallesat e tjera shpëtuan nga dhuna, sikurse njerëzimi.

### **Islami u përhap me të shpejtë si agimi i mëngjesit**

Kufijtë e shtetit të vogël islam, i cili u krijua në Medinë, brenda të cilit ishin afërsisht katërqind familje, për dhjetë vite arritën në Irak dhe Palestinë. Me ndarjen nga jeta të të Dërguarit të Allahut ﷺ, ushtritë Islame luftonin me Bizantin dhe Iranin. Por gjendja e sahabëve si përpara dhjetë viteve, mënyra e sjelljes, e jetesës, qetësia dhe shtëpitë s'kishin ndryshuar. Ata vijonin të jetonin në përkujdesje të plotë ndaj nefsit. Shpenzimet e tepërta, mendjemadhësia,



luksi dhe ana sipërfaqësore, ishin një mënyrë jetese e panjohur për shoqërinë e sahabëve. Ata mendonin përherë këtë: **“Nesër, varri do bëhet vendi i këtij nefsi”**. Ata iu shmangën përherë zotërimit të mirësive të kësaj bote dhe përdorimit të tepërt të tyre. Ata i përdorën këto mirësi së bashku me kënaqësitë dhe emocionin e besimit, për të udhëzuar njerëzimin në rrugë të drejtë. Ata u drejtuan vetëm për të fituar pëlqimin e Allahut ﷻ.

Një nga arsyt kryesore të përhapjes me shpejtësi të Islamit në mesin e shoqërive të dhunuara, të shtypura dhe të poshtëruara, sikurse agimi i një mëngjesi, ka qenë ekspozimi nga ana e sahabëve kudo që ata shkuan, i një **identiteti të mrekullueshëm Islam**. Sahabët, si nxënësit e posaçëm të të Dërguarit të Allahut ﷺ, ishin njerëz që përkujdeseshin me dhembshuri dhe mëshirën e Krijuesit të gjithësisë për robërit e Allahut ﷻ, ishin të drejtë, zemërgjerë dhe besimtarë të përkushtuar ndaj predikimit.

Në epiqendër të miqësisë së ngushtë kishin vënë Allahun ﷻ dhe të Dërguarin e Tij ﷺ. Kështu, një shoqëri që s'dinte shkrim e këndim kishte arritur fazat kulmore në qytetërim. Zemra dhe shpirtrat mendonin përherë **“Çfarë do Allahu ﷻ prej nesh? Si do të na shohë i Dërguari i Allahut ﷻ ne!”**

## U thelluan ndjenjat

Ata arritën në pikën më të fundit që mund të mbërrinte mendja, shpirti dhe nefsi. I shpëtuan plogështisë dhe arritën në një maturi shpirtërore. U bënë njerëz që i kërkonin llogari vetes. I verbuan kënaqësitë epshore dhe hodhën hapa të rëndësishëm në rrugën e “**mbërritjes tek e Vërteta**”, duke kapërcyer aftësitë zotëruese. Njerëzit e ashpër u bënë melekë.

Njerëzit që qëndronin në fund të Oqeanit Indian - nëse mund të shprehemi kështu-përsa i përket injorancës dhe dhunës, u bënë pjesë e ndjesive shpirtërore të profetit, duke arritur me syrin e Krijuesit kështu, në shkallë të larta të mëshirës, të dhembshurisë dhe përkujdesjes ndaj krijesave.

Njeriu i egër dhe i pamëshirshëm, që e hoqi foshnjën nga gjiri i nënës dhe e vorrosi për së gjalli, pas Islamit u bë si një melek i dhembshur me sy të përlotur. Shpirtrat u bënë një vend ngushëllimi dhe qetësie. Zemrat u bënë strehim për gratë e veja, jetimët dhe të vetmuarit.

Omeri رضي الله عنه zemërngurt, para Islamit u bë Omeri رضي الله عنه zemërbutë pas Islamit. Ai arriti të gjykonte aq thellë, sa të mendonte se “*Sikur një qengj të jetë në gjendje të mjerë në breg të Eufratit, kam frikë se Allahu ﷻ do më kërkojë llogari për këtë*”. (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VIII, 153.)



Netëve u soll në mesin e të vdekurve me thesin e miellit mbi supe. Ndjenja e përgjegjesisë për lumturinë dhe qetësinë e bashkësisë u bë një problem shumë i madh për të.

Një tjetër shembull është edhe ai i **Abdullah bin Mes'udit**, i cili në Luftën e Bedrit i ulet në gjoks Ebu Xhehlit që qe rrëzuar përtokë dhe, ndërkohë që ky jobesimtar i tërbuar po jepte shpirt, i drejtohet me fjalë ofenduese:

- Je ngritur shumë lart o çoban i shkretë dhensh!  
(Ibn-i Hisham, II, 277.)

Pra, në të kaluarën, Ibn-i Mes'ud ishte thjesht një çoban dhensh që nënçmohej në syrin e njerëzve. Me t'u udhëzuar në rrugë të drejtë dhe me të marrë mësimet e të Dërguarit të Allahut ﷺ u bë shpirtmadh dhe njeri me botë të pasur shpirtërore.

Pikërisht, Shkolla e Kufes, mjaft e njohur si një shkollë e madhe e drejtësisë, është vepër e këtij sahabiu të njohur,<sup>9</sup> **Imam Adham Ebu Hanife**, i njohur si dijetar që për herë të parë predikoi shkencën e fikhut dhe shumë muxhtehidë të tjerë, ish nxënës të kësaj shkolle. Në këtë shkollë u edukuan gjeni të tillë të mëdhenj. Këta ishin aq të përgatitur sa Soloni dhe Hammurabi, të njohur në mbarë botën si juristë të famshëm, s'mund të bëheshin as shërbëtorë të Ebu

9. Ali Hajdar Efendi, Dureru'l Hukkam Sherhu Mexhelleti'l ahkam, Stamboll, 1330, fq 11.



Hanifes. Në çfarëdo lloj shkence islame le t'i hedhim sytë, në krye të listës do të shohim atë sahabë, pra emrin e Abdullah bin Mes'ud.

Ata ishin shembull real i mrekullisë së Kuranit. Kishin arritur fazën kulminante të pjekurisë duke përfaqësuar vlerat njerëzore.

### **Mendja dhe zemra ishin në harmoni të plotë**

Mendja dhe zemra, si dy elemente kyçe të formimit të besimtarit, në atë kohë ishin në përputhje të plotë dhe funksiononin së bashku. Besimtarin e mbante të gjallë emocioni dhe dashuria dhe për rrjedhojë u thellua meditimi.

Njerëzit jetuan të vetëdijshëm se kjo botë është një vend provimi. Zemrat e tyre përjetuan rrahje të fuqishme hyjnore. Nuk u lodhën dhe s'u mërzitën nga udhëtimet që ndërmorën në **Kinë** dhe **Semerkand** për të udhëzuar të mirën dhe ndaluar të keqen. I influencuar nga ajeti Kuranor "**Mos e hidhni veten në rrezik me duart tuaja**"<sup>10</sup> Ebu Ejjub el-Ensari udhëtoi në Stamboll, ndërkohë që ishte tek tetëdhjetat e ca, vetëm të mos shmangej nga detyra e predikimit për të mirë. Trupi i tij u bë një përkujtimore e lartë për Stambollin që solli edhe

begati. Shembujt e atyre që vijuan më pas u bënë udhërrëfyes deri në **Anduluzi**.

**Ukbe bin Nafi**, prej Tabiinëve, u dërgua në Afrikë në kohën e Emevive. Ukbe mori në dorë zonën e Kajravanit. Zubejr bin Kajsini e emëroi drejtues të vendit duke i thënë:

**- Unë ia fala shpirtin Allahut ﷻ. Do vijoj deri në ditën e gjykimit të luftoj me ata që mohojnë Allahun ﷻ.** I këshilloi për ato gjëra që duheshin bërë.

Ndërkohë që Ukbe me një etje të madhe vijonte udhëtimin e tij, para i doli një oqean. Vijoi me kalin e tij drejt oqeanit duke thënë:

يَا رَبِّ لَوْ لَا هَذَا الْبَحْرُ لَمْضَيْتُ  
فِي الْبِلَادِ مُجَاهِدًا فِي سَبِيلِكَ

**- O Zoti im! Po të mos ishte ky oqean do vijoja në qytetet e tjera duke luftuar në rrugën Tënde.**<sup>11</sup>

11. **Ukbe bin Nafi** ishte një individ, lutja e të cilit pranohej. Me ngadhënjimin e Afrikës erdhi e u vendos aty ku sot ndodhet qyteti Kajravan. Ky ishte një vend i pyllëzuar, një vend plot gurë, gjarpërinj e shumë kafshë të tjera të egra. Ukbe iu lut Allahut ﷻ dhe me zë të lartë përsëriti tre herë:

O i Zoti i këtij vendi! Le të shpresojmë që ne të vendosemi këtu. Largohuni prej këtu!

Në këtë kohë u vu re se të gjitha kafshët e egra të tokës e nëntokës dolën dhe menjëherë u larguan. Ukbe mori parinë e tij me vete dhe u vendos në këtë vend duke u thënë njerëzve:

-Me emrin e Allahut ﷻ tashmë do vendosemi këtu.

(Ibnu'l Esir, el-Kamil fit-Tarih, Bejrut, 1385, IV, 105-106.)

Tre shekujt e parë të shtetit Osman, themelet e të cilit u hodhën nga pasardhësit, të cilët erdhën me 400 kuaj, përbënte një shembull të ripërsëritjes së kohës së sahabëve.

### U zgjerua meditimi

Shoqëria e periudhës së injorancës, e cila më parë jetonte në një errësi të thellë, me udhëzimin e Profetit u bë shoqëria e **“të diturve të vërtetë”**. Netët u bënë ditë. Dimrat pranverë. U zhvillua gjykimi. Njeriu nisi të mendonte thellë se trupi vjen nga një pikë uji, se zogu vjen në jetë nga një vezë e vogël, pemët e ndryshme rriten dhe zhvillohen nga një farë e vogël... Jeta u përqendrua në fitimin e pëlqimit të Allahut ﷻ. Mëshira dhe dhembshuria u bënë akoma më parësore.

---

Një pjesë e mirë e vendasve që dëgjuan këtë ndodhi u bënë myslimanë. (Shihni Zehebi, Tarihu'l Islam, 1, 601; Ibn Abdi-ber, Istiab, 1, 331; Ibn-I Kethir, el-Bidaje, VIII, 45.)

Ukbe gjatë kohës së ngadhënjimeve ishte ndalur në një vend tjetër. Atje s'kishte ujë. Njerëzit ishin aq shumë të etur për ujë, sa gati po u binte të fikët. Ukbe fali dy reqate namaz dhe bëri një lutje. Kali i Ukbes po hapte një gropë me këmbët e tij të përparme. Për një çast nga poshtë këmbëve nisi të buronte ujë. Ukbe i thirri njerëzit. Ata me duart e tyre e hapën vendin edhe më shumë dhe e kthyen në një burim uji. Më pas shuan etjen. Ai ujë mori emrin “Mau'l Feres: Uji i kalit” (Ibnu'l Esir, el-Kamil fi-t' Tarih IV, 106)





## Predikimi u bë puna që u jepte më shumë kënaqësi në jetën e tyre

Sahabët paraqitën karakterin dhe personalitetin e një myslimani të mirë. Në çdo fushë të jetës dhe në çdo moment deshën **pëlqimin e Allahut** ﷻ duke bërë çdo lloj sakrifice. Me një formim të tillë shpirtëror këshilluan të mirën dhe të drejtën dhe kërkuan shmangien nga e keqja, sjellja e shëmtuar dhe imoraliteti. Momentet më domethënëse dhe më të bukura në jetën e tyre ishin ato kohë kur u përcillnin njerëzve mesazhet e tevhidit.

Takimet e Pejgamberit ﷺ me gratë në lidhje me predikimin e Islamit nuk ishin aq të shumta sa ato me burrat. Për rrjedhojë, gruaja sahabe **Guzejje** ﷺ në kohën e Mekës jepte kontribut të shquar në përhapjen e Islamit. Ajo përfshihej fshehurazi në mesin e grave Kurejshite duke i ftuar ato në Islam.

Këtë punë e vijoi derisa Mekasit mësuan për Islamin. Kurejshitët, me t'u informuar për situatën, e kapën dhe ua dhanë për ta internuar disa anëtarëve të fisit Devs të bashkëshortit të saj që po largoheshin në atë kohë nga Meka. Devsitët e torturuan atë në të gjitha mënyrat. E hipën të zhveshur në deve dhe e lanë pa ujë. Ata vijuan me tortura deri sa ajo humbi mendjen, dëgjimin dhe shikimin. Mirëpo, të influencuar nga durimi, sinqeriteti dhe dashuria e saj për besimin, Devsitët pranuan Islamin. (Ibn-i Sa'd,



VIII, 155-157, Ibn-i Habin el Muhabbar, fq 81-82, 02, Ebu Nuajm, Hilje, II, 66-67, Ibn-i Haxher, el-Isabe, IV, 447.)

I Dërguari i Allahut ﷺ bëri hixhret në Medinë dhe, me të dëgjuar për këtë edhe Guzejje ﷺ bëri hixhret. Në disa transmetime thuhet që ajo erdhi tek Profeti si përfaqësuese e bijve Abdulkajs.<sup>12</sup>

Një herë, një grua, e cila po dërgonte ujë në fisin e saj, ishte takuar me të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe ishte bërë dëshmitare e një mrekullie të Tij. Profeti ﷺ e trajtoi me bujari atë. Kur qe kthyer në rrethin e saj dhe i pati treguar se çfarë i kishte ndodhur, të gjithë sa ishin aty hynë në fenë Islame.<sup>13</sup>

As robëreshat që kishin pranuar Islamit nuk ngeleshin prapa nga gratë e tjera të lira, duke marrë pjesë në aktivitetet e predikimit. Një e tillë nga Isfahani, e cila ishte bërë myslimane para **Selma-i Faris**, kishte bërë disa udhëtime për të ardhur tek Pejgamberi.<sup>14</sup>

Sahabes i ishin dhënë tre minuta kohë nga mohuesit, para se të kalonte në dënimin e saj me varje dhe në atë moment i kishte falënderuar ata duke u thënë:


12. Ebu'l Hatip, Esmau's- Sahabe, 142a, Biblioteka A 1101  
Universiteti Stambollit,

13. Shih, Buhari, Tejemmum, 6.

14. Ebu Nuajm el-Isfahani, Tarihu'l Isfahan, 1, 43; Ibnu'l Esir, Usdu'l Gabe, VII, 25; Ibn-i Haxher, el-Isabe, IV, 233.



- Kjo do të thotë se kam tre minuta kohë që t'u predikoj diçka.



**Ebu Hurejre** , lidhur me rëndësinë e predikimit pati thënë:


- Dëgjonim (këtë të vërtetë në mesin e sahabëve): Në ditën e gjykimit një i panjohur të afrohet pranë. Burri habitet dhe pyet:

- Çdo nga unë? Unë nuk të njoh. I panjohuri i shpreh shqetësimin e tij, duke i thënë:

- Kur ishim në atë jetë më shihje tek merresha me punë të shëmtuara dhe nuk më këshilloje dhe as nuk më ndaloje.<sup>15</sup>

## U mbështetën fort tek Kurani

Pejgamberi  u mësonte Kuranin sahabëve, edhe në kushte të vështira. **Ebu Talha** një ditë e vuri re atë tek qëndronte në këmbë dhe u mësonte Kuranin as'hab-i Suffe **Profeti**  **kishte lidhur gurë në barkun e tij që të drejtonte belin pasi ishte kërrysur nga uria.** (Ebu Nuajm, Hilje, 1, 342)

Ja pra, impenjimi më i rëndësishëm i sahabëve ishte të kuptonin librin e Allahut , ta mësonin, të ishin pjesë e urtësive të Tij dhe natyrshëm, ta

15. Mundhiri, et-Tergip, ve't Terhib, Bejrut, 1417; III, 164/3506; Rudani, Xhem'ul Fevaid, përkthim Naim Erdogan, Stamboll, V 384.



vinin Atë në jetë. Kënaqësinë dhe shijen e jetës ata e gjenin në rileximin dhe ridëgjimin disa herë të Kuranit.

Si përfundim, ashabët jetuan me Kuranin, me përmbajtjen e Tij, duke e vënë gjithë jetën e tyre në shërbim të Tij. Ata u përpoqën dhe kryen një shërbim të paparë gjatë historisë, mbetën pre e dhunës, e shtypjes dhe e presionit, por nuk hoqën dorë asnjëherë nga vlerat e tyre. Ata bënë hixhret për të vënë në jetë ajetet e shpallura të Allahut ﷻ duke lënë shtëpitë dhe pasuritë e tyre dhe duke sakrifikuar gjithçka në emër të këtij qëllimi.

Ata u përpoqën që çdo ajet ta mësonin dhe ta vinin në jetë siç duhej. Edhe në momentet më të vështira nuk u ndanë nga Kurani. Abbadi, të cilin Pejgamberi ﷺ e la mbikqyrës, u shkëput një moment për të falur namazin. Armiku nisi të gjuante me shigjeta. Abbadi arriti në ruku dhe sexhde dhe më pas do përfundonte namazin vetëm pasi u godit me dy - tre shigjeta. Më pas njoftoi mikun e tij Ammarin, i cili e pyet se përse nuk e kishte njoftuar që me goditjen e parë dhe ndërkaq s'vonoj përgjigja:

- Po thosha një sure dhe nuk doja ta prishja namazin pa e përfunduar, por kur shigjetat goditën njëra pas tjetrës, e ndërpreva suren dhe rashë në ruku. Betohem për Allah se të mos frikësohesha për humbjen e kësaj që urdhëroi i Dërguari i Allahut



ﷺ, më mirë do kisha preferuar të vdisja sesa të lija suren për gjysëm dhe të ndërprisja namazin. (Ebu Davud, Taharet, 78/198; Ahmet, III, 344; Bejhaki, Delail, III, 459; Ibn-i Hisham, III, 219; Vakidi, 1, 397.)

Sahabët jetonin duke vënë në jetë parimet e Kuranit. Çdo parim fetar për ta ishte një kënaqësi e pashtershme. Çdo ajet i zbritur ishte për ta sikurse një sofër e begatë, e zbritur nga qielli. Të gjitha përpjekjet bëheshin për të kuptuar më së miri Kurandin, për ta jetuar Atë dhe për të qenë shembull në këtë drejtim. Shembulli i një zonje sahabe, e cila në kurorëzimin e martesës i kërkoi të shoqit si mehir vetëm t'i mësonte pjesët që dinte nga Kurani, është një tregues i qartë për të vërtetuar shkallën e besimit të tyre.<sup>16</sup>

Sahabët morën si shembull sakrificat e të Dërguarit të Allahut ﷺ, për të mësuar Kurandin dhe më në fund, Medina u mbush me hafiza dhe dijetarë.

### **Cilët ishin faktorët që i drejtuan sahabët drejt Kuranit?**

a. Ata ishin të bashkuar dhe nuk influencoheshin nga asnjë kulturë e huaj. Më pas, të gjithë fuqinë e tyre mendore dhe shpirtërore e përqendruan

---

16. Shih: Buhari, Nikah, 6, 32, 35; Fedailu'l Kuran, 21, 22, Muslim, Mikah, 76.

tek Kurani. Kështu u krijua një kulturë e mirëfilltë. Kjo kulturë ndaloi dhunën dhe padrejtësinë, duke i dhuruar gjithësisë një jetë të qetë. Është e domosdoshme për njeriun të rritet përpikmëria islame dhe të krijohet një jetë shpirtërore, pasi vetëm me një formim të lartë shpirtëror mund të prodhohet një kulturë dhe një art. Meditimi arrin fazën e tij kulmore, në përfundim edukohet njeriu ideal dhe në këtë mënyrë ridalin në pah trashëgimtarë të Mevlanës, Sinanit, dhe Fuzulit.

b. Zbritja një e nga një e ajeteve kuranore lehtësoi mësimin përmendësh të tyre, praktikimin dhe përgatitjen shpirtërore të njerëzve. Kjo ishte një mundësi e mirë edukimi për brezin e sahabëve.

c. Leximi domosdoshmërisht i Kuranit në namaz u bë një udhërrëfyes i përhershëm për ta, duke u rritur kështu edhe përkushtimi i tyre ndaj Kuranit. Ata e përjetuan në çdo moment të ditës domethënien e Fatiha-së, e cila përsëritet në çdo reqat.

d. Ata morën mësim nga rrëfimet e Kuranit, që të ishin në përputhje me parimet dhe veprat e tyre të pranoheshin.

### **I gjithë njerëzimi i admiroi**

Ja pra, kështu ishte Periudha e Lumturisë, të cilën Kurani e nxori në pah brenda një kohe të



shkurtër. E gjithë bota e ndoqi me admirim atë shoqëri të arsimuar të kohës. Edhe sot e kësaj dite vijon ta ndjekë admirueshëm këtë.

Vallë, nëse mblidhen të gjithë psikologët, sociologët, pedagogët, antropologët dhe filozofët e botës së **shekullit të XXI**, a do mund të edukonin qoftë edhe disa individë të formuar me virtytet e shoqërisë së Periudhës së Lumturisë? Kurani dhe Suneti që sollën në pah Periudhën e Lumturisë, vijnë akoma sot të njëjtën freski, influencë dhe pranueshmëri. Shoqëritë që hyjnë në Islam janë përherë të suksesshme, ndërsa ata që e braktisin përkundrazi shkatërrohen. **La Fajette**, një studiues i njohur që ka bërë kërkime lidhur me normat e drejtësisë dhe të lirisë së Islamit, e ka admiruar shumë Pejgamberin ﷺ duke thënë:

***- O arab i njohur! Sado të përgëzohesh, përsëri është pak, pasi ti vetë ke gjetur drejtësinë!*** (Kamil, Miras, Tecridi Sarih, Përkthim, IX, 289.)

### **Etika islame nuk qe sipërfaqësore, por praktike**

Qëllimi i Islamit nuk është shqyrtimi sipërfaqësor i çështjeve të etikës, hyrja në diskutime të pavlera për të bindur mendjet e merakosura dhe përfshirja në një filozofi etike të shkëputur nga jeta e vërtetë. Qëllimi i Islamit është që, nëpërmjet zgjidhjeve



praktike, t'u japë përgjigje nevojave etike të njerëzve dhe me kalimin e kohës t'i bëjë të vetëdijshëm për gabimet përkatëse dhe t'u ofrojë mundësi t'i shmangin këto gabime. Islami kërkon që t'i vërë në zbatim parimet etike që ka sjellë, në mënyrën më të mirë dhe më të sigurt. Islami nuk ka për qëllim të formojë vetëm etikën “e njohur”, por edhe atë “të jetuarën” Është mjaft domethënëse edhe zbritja e ajeteve<sup>17</sup>, që urdhërojnë shmangien e njeriut nga e keqja menjëherë pas ajeteve që urdhërojnë “leximin”, të zbritura Pejgamberit ﷺ.

Idetë e filozofëve, të paedukuar me frymën e shpalljes, të cilat dolën në pah në emër të etikës për të siguruar qetësinë sociale, kanë mbetur thjesht në librat e pluhurosur nëpër raftet e bibliotekave, ndërsa ato të cilat u hodhën në jetë, nuk zgjatën shumë. Natyrisht, këta filozofë nuk sollën shembuj të atyre mendimeve as në jetën e tyre dhe as për njerëzit që i besuan. Idetë dhe mendimet e tyre mbetën thjesht sipërfaqësore dhe naive.

Megjithëse **Aristoteli** hodhi bazat e disa parimeve dhe ligjeve të filozofisë etike, nuk kemi parë qoftë edhe një person të vetëm të ketë arritur lumturinë e vërtetë në besim të filozofisë së tij, duke i vënë ato parime në jetë, pasi vizioni i tij ishte larg shpalljes hyjnore. Edhe vepra “*el-Medinetu'l fadila: Qyteti*





*i virtyteve*” një nga veprat më të rëndësishme që përmban idetë e Farabiut lidhur me “qytetin e bukurisë dhe shoqërisë ideale” të formuluar në imagjinatën e tij, nuk gjeti asnjë vend praktikimi. Idetë e tij nuk arritën të dilnin përtej faqeve të librave, por mbetën një ushqim për lexuesit. Këto nuk ishin gjëra të thëna nga përvoja e jetës dhe as me burim hyjnor. Filozofët thonë: “Sipas meje është kështu” ndërkaq peygamberët thonë “Urdhëri i Allahut ﷻ është kështu”. Si përfundim, Allahu ﷻ e tregoi edhe një herë fuqinë e Tij, duke i dhënë një peygamberi që s’dinte shkrim e këndim moralin më të lartë për të udhëzuar gjithë njerëzimin në rrugë të drejtë. Është ky moral i lartë, të cilin Peygamberi ﷺ ia shpalli gjithë njerëzimit në mënyrën më të mirë të mundshme, duke dhënë veten e tij si shembull për të treguar se si duhet të jetë njeriu model dhe i formuar.





بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَمَنْ النَّاسِ مَنْ يَشْرِي نَفْسَهُ ابْتِغَاءَ  
مَرْضَاتِ اللَّهِ وَاللَّهُ رَؤُوفٌ بِالْعِبَادِ

*“Ka njerëz që e fllojnë veten, për të fituar  
pëlqimin e Allahut. Allahu është shumë i  
mëshirshëm me robtë e Tij.”*

(Bekare, 207.)



# NDJESIA E BESIMIT

NË SHOQËRINË  
E EPOKËS SË LUMTURISË



## NDJESIA E BESIMIT NË SHOQËRINË E EPOKËS SË LUMTURISË

Sahabët përpiqeshin t'i jepnin formë jetës së tyre me një dashuri dhe ndjesi të madhe besimi, në themel të së cilës qëndronte “një botë shpirtërore dhe intensive” e trashëguar nga i Dërguari i Allahut ﷺ.

Trashëgimtarët e sahabëve, të cilët ishin pjesë e shoqërisë së kohës së injorancës, të mbetur larg besimit, të vërtetës dhe moralit të lartë, u brumosën më pas me frytet e mëshirës dhe të begatisë shpirtërore të rrethit të ngushtë të Profetit ﷺ. Bota shpirtërore, e cila u pasqyrua nga shpirti i të Dërguarit të Allahut ﷺ, në atë të ymetit të Tij, solli personalitete të njohur që do bëheshin udhërrëfyes për njerëzimin deri në ditën e gjykimit. Një njeri i edukuar në errësitat e injorancës, i pashpirt, zemërngurtë, aq sa arrin të varrosë për së gjalli edhe vajzën e tij, një njeri i zakonshëm që s'njeh drejtësi, u bë një besimtar i ndjeshëm, sakrifikues, i kujdesshëm dhe i urtë.



## Ata nxituan të bëheshin pjesë e parimeve islame

Të gjithë anëtarët e Shoqërisë së Epokës së Lumturisë, i madh dhe i vogël, ecnin drejt besimit. **Abdullah bin Zubejr** ishte fëmija i parë që u lind pas Hixhretit. Atë e patën dërguar menjëherë tek i Dërguari i Allahut ﷺ, i cili mori një hurmë dhe pasi kafshoi një pjesë, tjetrën ia dha fëmijës, u lut për të dhe ia vuri emrin Abdullah. Abdullahu e hëngri hurmën dhe, në moshën tetë vjeçare, i ati e dërgoi të betohej tek Profeti ﷺ, i cili, me ta parë, i buzëqeshi dhe e pranoi betimin e tij. (Muslim, Adap, 25.)

Abdullahu ishte akoma gjashtë vjeçar kur e ëma Zejnep binti Humejd në kohën e çlirimit të Mekës, e dërgonte tek Profeti ﷺ duke i thënë:

- O Profet! Pranoje birin tim si mysliman! Ai iu përgjigj: - Është akoma i vogël! E përkëdheli dhe u lut për të. Kur u rrit edhe pak, **Abdullah bin Hisham** ﷺ dilte në pazar dhe blinte ushqimet. Ibn-i Omeri dhe ibn-i Zubejri me ta parë në pazar iu afruan dhe i thanë:

- Na bëj edhe ne ortakë në këtë mall! Vetë Profeti ﷺ ka bërë lutje begatie për ty. Abdullahu pajtohej me ta. Nganjëherë ndodhte që fitonte shumë dhe e dërgonte në shtëpi. (Buhari, Shirket, 13.)

**Ebu Kursafe** ﷺ ishte një tjetër prej tyre, i cili



që në moshë të re i ishte futur rrugës së besimit. Ja si e tregon një ngjarje të ndodhur atë kohë:

- Kur unë, nëna dhe tezja pranuan të Dërguarin e Allahut ﷺ u ndamë prej Tij. Më pas, nëna dhe tezja më thanë:

- Biri im! Është hera e parë që shohim një njeri të tillë, kaq fytyrëqeshur, me veshje kaq të pastra dhe kaq fjalëmbël. Nga goja e tij thuhetse dilnin rreze drite. (Hajsemi, VIII, 279-280.)

### **Për hir të besimit nuk hezituan të jepnin as jetën**

Janë të njohur për heroizmin e tyre Sumejje dhe bashkëshorti i saj Jasiri, të cilët sakrifkuan jetën për hir të besimit. Të njohur gjithashtu në këtë drejtim janë edhe Ammar bin Jasir, Bilal-i Habeshi, Habbab bin Eret, Suhejb bin Sinan, Zinnire, Amir bin Fuhejre, Ebu Fukejhe, Mikdad bin Amir, Ummu Ubejs Libejme, Nehdije dhe e bija. Ahbatë i patën mbrojtur besimet e tyre edhe në raste vuajtjesh të papërballueshme. Ata sakrifkuan pasurinë dhe jetën që kjo mirësi hyjnore të mbërrinte deri tek ne.

Omeri ﷺ e pati pyetur **Habbab bin Eret** ﷺ, si një nga myslimanët e parë në kohën e halifatit të vet:



- A mund të na flasësh për vuajtjet e përjetuara në rrugën e Allahut ﷻ? Habbabi i qe përgjigjur:

- O prijësi i besimtarëve! Pa shih shpatullat e mia! Omeri, me t'i hedhur sytë, tha:

- S'kisha parë kurr një shpinë kaq të dërrmuar!  
- dhe mbeti i habitur teksa shihte.

Habbabi ﷻ më pas vijoi:

- Qafirët ndiznin zjarr dhe më shtrinin të zhveshur mbi të. Zjarri shuhej vetëm me vajrat që shkriheshin në shpinën time. Mushrikët i merrnin gurët e skuqur në zjarr dhe ia ngjisnin në shpinë Habbabit dhe nga kjo dhunë mizore mishi nisi të binte. Megjithë këtë, ai nuk i thoshte fjalët që kërkonin mushrikët. (Ibn-i Esir, Usdu-i Gabe, II, 114-115.)

Zejd bin Desine dhe Hubejbi, të rënë robër të mushrikëve, binin dëshmorë të kësaj dhune. Secilit iu bë një pyetje para se të ndaheshin nga kjo jetë:

- A do doje ta kishe Profetin, alejhi selam, në vendin tënd që ta shpëtoje jetën? Që të dy e panë me dhembshuri mushrikun që pyeti dhe iu përgjigjën:

***- Jo vetëm që kisha dashur të ishte këtu pranë nesh, por nuk do të kisha dashur kurrë që as ferra ti hynte në këmbë.***

Ebu Sufjani i habitur, nga kjo dashuri e madhe tha:





- Të them të vërtetën çuditem! Nuk kam parë kurrë një shoqëri të dojë prijësin e saj sa sahabët Profetin! (Vakidi, I, 360-362, Ibn-i Sa'd, II, 56.)

Në fund të Luftës së Uhudit **Safija** ﷺ kërkoi të shihte të vëllain Hamzanë, trupi i të cilit ishte bërë copë - copë. Me këtë qëllim, iu drejtua vendit ku ndodheshin dëshmorët. Dukej e vështirë përballja e saj me atë pamje. Atë e priti i biri, Zubejri, i cili i tha:

- Nënë! Profeti ﷺ urdhëron të kthehesh! Ajo iu përgjigj:

- Përse? Që mos ta shoh vëllain tim? E di se ai është copëzuar në mënyrë të tmerrshme. Ai dha jetën për hir të Allahut ﷻ. Natyrisht as neve s'mund të na ngushëllonte diçka tjetër përveçse kësaj. Le të durojmë, pasi fundi vjen vetëm prej Allahut ﷻ!

Zubejdi shkoi më pas tek Profeti ﷺ dhe i transmetoi fjalët e nënës. Profeti ﷺ iu përgjigj:

- *Atëherë lëre ta shikojë!* Shkoi pranë trupit pa jetë të vëllait të saj, rënë dëshmor dhe u lut për të. (Shihni, Ibn-i Hisham, III, Ibn-I Haxher, el-Isabe, IV, 349)

Gratë, të cilat në kohën e injorancës rraheshin me ditë të tëra për një gjë shumë të vogël, në sajë të fuqisë dhe besimit që u kishte dhënë Allahu ﷻ ishin bërë shembull të një durimi të pashoq.



Një tjetër shembull i mrekullueshëm i këtij duri-  
mi ishte edhe nëna e **Sa'd bin Muadh** ﷺ:

I Dërguari i Allahut ﷺ, i plagosur rëndë në  
Uhud, qëndronte hipur në kalë, ndërkohë që po  
kthehej në Medinë dhe ndërkaq, litarin e kalit po e  
mbante Sa'd Bin Muadhi, e ëma e të cilit Keshbe  
binti Ubejd erdhi pranë Profetit ﷺ. Sa'd iu drejtua  
Profetit ﷺ duke i thënë:

- O i Dërguar! Kjo është nëna ime!

- Përshëndetje! - vijoi Profeti ﷺ.

Gruaja i afrohet dhe vështron fytyrën e Tij të  
bekuar dhe më pas thotë:

**- Falë të qofshin prindërit e mi, o i Dër-  
guar! Meqë të pashë shëndosh e mirë, tash-  
më çfarëdo fatkeqësie të më zërë, nuk më  
tremb!**

I Dërguari i Allahut ﷺ, pasi e ngushëllon për  
rënien dëshmor të të birit, Amir bin Muadh, vizon  
e thotë:

**- O nëna e Sa'dit! Kam një lajm të mirë për  
ty! Ky lajm i mirë le të jetë për gjithë anëtarët e  
familjes! Të gjithë dëshmorët e fisit tuaj do jenë  
në një rresht në Xhenet. Kishin dhënë dymbëdh-  
jetë dëshmorë. U lejua edhe ndërmjetësimi për  
anëtarët e familjes.**



Gruaja u përgjigj:

**- Jemi dakort, o i Dërguar! Kush do derdhë lot për ta tashmë?**

- O i Dërguar! Lutuni edhe për ata që kanë lënë nga pas dëshmorët! I Dërguari bëri një lutje të tillë:

*- Zoti im! Largoje mërzinë që kemi në shpirtirat tanë dhe lehtësoji fatkeqësitë! Dili për zot sa më mirë atyre që mbetën prapa!*

Më pas vijoi rrugën. Sahabët po ecnin një rresht prapa dhe kjo nisur nga dashuria që kishin për të Dërguarin e Allahut ﷺ. Ata nuk ktheheshin në shtëpitë e tyre. Profeti ﷺ i tha Sa'dit ﷺ:

*- Ka shumë të plagosur me plagë të rënda nga fisi yt. Ditën e gjykimit të gjithë do jenë të përgjakur nga plagët e tyre. Ngjyra do jetë e gjakut, por aroma do jetë e këndshme. Thuaju atyre të shkojnë në shtëpi dhe të kurohen. Tani askush të mos vijë me mua. Thuaju këtë si një urdhër të prerë!*

Sa'd transmetoi:

- Është urdhër i prerë i Profetit ﷺ. Askush nga fisi Beni Eshhel të mos e ndjekë nga pas. Të gjithë të plagosurit u kthyen prapa. Gjithë natën u morën me kurimin e plagëve. Kishte tridhjetë të plagosur nga ky fis. (Vakidi, I, 315-316, Dijarbekri, I, 444.)



Një tjetër sahabë, ishte edhe **Sumejra** ﷺ, e cila shfaqti një guxim tepër të fortë, nisur nga besimi i saj i fuqishëm ndaj Allahut ﷻ. Në ditët e luftës së Uhudit, një lajm tronditi Medinën. Me t'u hapur lajmi se "Muhamedi u vra" shpërthyen vajtimet. Të gjithë dolën nëpër rrugë për të pritur ndonjë lajm që mund të vinte. Sumejra prej Ensarëve nuk ia vinte veshin lajmit të hidhur për rënien dëshmorë të dy djemve të saj, të të atit, burrit dhe vëllait, por ishte e shqetësuar për çështjen në fjalë. Ajo thoshte përherë:

- A i ka ndodhur gjë të Dërguarit të Allahut ﷺ?

Sahabët iu përgjigjën:

- Faleminderit Zotit, gjendja është mirë. Ai është në jetë.

Sumejra vijoi:

- Nuk mund të qëndroj e qetë pa e parë. Më tregoni Profetin ﷺ.

Me ta parë, i shkoi pranë dhe tha:

**- Të qofshin falë prindërit e mi o i Dërguari i Allahut! Asgjë nuk më hyn në sy, mjafton që ti të jesh mirë!** (Shihni, Ibn-i Hisham, III, 51, Vakidi, I, 292, Hejthemi, VI, 115.)



## Ata morën rrugën e hixhretit dhe të xhihadit për të mbrojtur besimin e tyre

Sahabët emigruan në vende të largëta për të mbrojtur fenë e tyre si dhe për t'i shpëtuar dhunës mizore të mushrikëve, duke lënë pasuritë, fëmijët dhe atdheun. Kurani famëlartë nxjerr në pah fuqinë e besimit të tyre duke thënë:

**“Ata që besojnë, mërgojnë e luftojnë për çështjen e Allahut ﷻ dhe ata që u japin strehim atyre e i ndihmojnë, pa dyshim, janë besimtarë të vërtetë; për ta ka falje dhe shpërblim bujar.”**

(el-Enfal, 74.)

Është mjaft influencuese biseda që bëri **Xhafer-i Tajjar** ﷺ përpara Nexhashiut, të cilin Pejgamberi ﷺ e kishte ngarkuar me detyrë në krye të karvanit të parë të Hixhretit, gjë që përbën një shembull të qartë për të kuptuar se si njeriu i injorancës u kthye në shoqërinë e Epokës së Lumturisë dhe ç'besim mbart në vetvete:

O kuvendues! Ne ishim njerëz të injorancës. Adhuronim si hyjni ikonat prej guri dhe druri. Hanim mishin e kafshëve të ngordhura dhe merreshim me çdo lloj prostitucioni. Nuk mernim parasysh të drejtën farefisnore duke shkëputur në këtë mënyrë edhe lidhjet mes njëri-tjetrit. Nuk njihnim të drejtat e komshijve, duke u bërë çdo lloj të keqeje. Më të fortët shtypnin të varfrit. Ndërkohë që ne ishim të



tillë, Allahu ﷻ na dërgoi nga mesi ynë një njeri të zgjedhur si Pejgamber, i cili na thirri të besonim në njësinë e Zotit. Na ftoi të adhuronim vetëm Atë dhe t'i linim mënjanë ikonat prej guri, që të parët tanë kishin adhurar më parë. Na urdhëroi të bëheshim fjalëdrejtë, besnikë ndaj porosive, të forconim lidhjet farefisnore duke çuar në vend të drejtat përkatëse, të sillëshim mirë me komshijtë, t'u shmangeshim harameve dhe gjakderdhjeve. Na ndaloi prostitucionin, fjalët e këqija dhe gënjeshttrat, ngrënien e pasurisë së jetimit dhe shpifjen ndaj grave të pafajshme.

Na urdhëroi të adhuronim vetëm Atë dhe të mos i bëheshim ortak për asgjë. Edhe ne e miratuam, i besuam dhe e respektuam për parimet që solli. Adhuruam vetëm Allahun ﷻ. Nuk i bëmë shok Atij asgjë, çdo gjë të bërë haram prej Tij e pranuan si të tillë, po kështu çdo gjë që e bëri hallall e pranuan të tillë. Pas të gjitha këtyre, fisi ynë u armiqësua me ne, na dhunuan që të ktheheshim nga adhurimi ndaj Allahut ﷻ në atë të ikonave dhe të ktheheshim sërish në punët e këqija që kishim bërë më parë. U përpoqën të na hidhnin në humnerë. Me rritjen e dhunës, gjendja jonë u bë e papërbalueshme dhe ajo që është më e rëndësishme **erdhëm në vendin tënd, duke qenë se nuk arritëm të jetonim si duhet fenë tonë.** Të zgjodhëm Ty në mesin e sunduesve. E pamë të arsyeshme të qëndronim pranë Teje. Shpresuam se nuk do dhunohemi



o Sundimtar! (Ahmed, I, 202-203; V, 290-291; Hejthemi, VI, 25-27; Ibn-I Hisham, I, 358-359.)

Grupi i fundit i muhaxhirëve, që udhëtuan në Etiopi, u kthyen te Profeti në rrugë detare gjatë kohës së çlirimit të Hajberit. Në mesin e tyre ishte edhe **Esmā Binti Umejs** ﷺ. Një ditë prej ditësh, ajo kish shkuar për vizitë tek Hafsaja, bashkëshortja e Profetit. Më pas erdhi edhe Omeri ﷺ. Me të parë Esmānë, e pyeti:

- Kush është kjo?

Ajo iu përgjigj:

- Esmā binti Umejs ﷺ.

Omeri ﷺ vijoi si me shaka:

- Është ajo e Etiopisë? Është ajo grua që mori pjesë në udhëtimin në det?

- Po! - iu përgjigj Esmaja:

- Ne ju kaluam në Hixhret, vijoi Omeri ﷺ, prandaj ne e meritojmë më shumë se ju të jemi pranë Profetit ﷺ.

- Jo, - tha ajo, betohem për Zot se mendoni gabim, o Omer ﷺ. Ju ishit me të Dërguarin. Ai po ushqente të uriturin nga mesi juaj dhe po mësonte të pavetëdijshmin. Kurse ne jetonim të përzënë, në mesin e qafirëve dhe të huajve, në rrënjët e thella të



Etiopisë. Edhe kjo ishte për hir të Allahut ﷻ dhe të Dërguarit të Tij ﷺ.

Betohem për Allah se as nuk ha, as nuk pi pa i treguar Pejgamberit për ato që më the. Ne binin pre e vuajtjeve dhe frikësoheshim. Unë do t'i them Pejgamberit dhe do e pyes se ku qëndron e vërteta e kësaj pune. Betohem për atë Zot se as nuk gënjej, as nuk devijoj nga rruga dhe as nuk shtoj diçka nga ato që kam thënë, ia tregoj ngjarjen siç ka ndodhur.

Me të ardhur Profeti ﷺ, Esmā nisi të fliste:

- O i Dërguar! Omeri ؓ ka thënë kështu e kështu!

Ai ia ktheu:

- Po ti ç'the? Nisi të tregonte ndodhinë duke thënë:

- Thashë kështu e kështu.

- Sipas meje ai nuk ka më shumë të drejtë nga ju, vijoi Profeti ﷺ. Atij i pranohet një hixhret, ndërsa juve, o udhëtarë të anijes dy hixhrete.

- Kur u kthyem nga Etiopia me anije së bashku me Ebu Musa el-Esh'ari dhe sahabët e tjerë, ato po vinin grupe - grupe dhe po më tregonin këtë ngjarje, shtoi ajo.

Nuk kishte gjë më të madhe në botë që t'i gë-





zonte ata sesa kjo fjalë e Pejgamberit ﷺ dhe s'kishte shpresë më të madhe se kjo. Ebu Musa ma ripërsëriste disa herë këtë ngjarje dhe kështu ndjehej krejt ndryshe kur e dëgjonte me herë të tëra këtë fjalë të mirë të Pejgamberit ﷺ për ta. (Buhari, Megazi, 36; Muslim, Fedailu'l Sahabe 169.)







*“Dhe adhuroje Zotin tënd  
derisa të të vijë vdekja!” (el-Hixhr, 99.)*

ENTUSIAZMI  
I ADHURIMIT  
NË SHOQËRINË  
E EPOKËS SË LUMTURISË



## ENTUSIAZMI I ADHURIMIT NË SHOQËRINË E EPOKËS SË LUMTURISË

Adhurimet për sahabët ishin momente bashkëbisedimi dhe afrimiteti me Allahun ﷻ. Për rrjedhojë, ishin momente qetësie dhe mundësi shumë të rëndësishme. Adhurimet ata i bënin me dëshirën e madhe që t'i çonin në vend urdhrat e Allahut ﷻ dhe çdo lloj adhurimi të kryer e shihnin si një nder dhe mirësi të madhe.

### **Tregoheshin të kujdesshëm të ishin përherë me abdest**

Besimtarët e Epokës së Lumturisë tregoheshin të kujdesshëm të ishin vazhdimisht me abdest, duke marrë abdest sa herë që falnin namaz. Një mëngjes, i Dërguari i Allahut ﷺ e thirri Bilalin dhe e pyeti:

*- Bilal! Ç'punë bëre që hyre para meje në Xhenet? Sa herë që shoh në ëndërr të hyj në Xhenet dëgjoj të ecurat e tua. Edhe mbrëmë shkova në Xhenet dhe sërish të dëgjova ty.*

Bilali u përgjigj:



O i Dërguar! Sa herë që thërras ezanin, me doemos fali dy reqate namaz. Me të prishur abdestin e marr sërish dhe mendoj se i detyrohem Allahut dy reqate namaz.

I Dërguari ﷺ vijoi:

- *Ja pra, në sajë të këtyre dy elementeve.*

(Tirmidhi, Menakip, 17/3689; Ahmet, V, 354.)

Ja si tregon Ebu Gutajf el-Huzeli:

Kam dëgjuar **Abdullah bin Omerin** ﷺ tek ulej në vendin e tij në mesxhid. Me të mbërritur koha e namazit të drekës, u ngrit, shkoi të merrte abdest dhe fali namazin. U kthye sërish në vendin e tij. Me të afruar koha e iqindisë, u ngrit të merrte abdest dhe nisi të falte namazin e iqindisë. Më pas, u kthye sërish. Kur erdhi koha e namazit të akshamit, u ngrit të merrte përsëri abdest dhe fali namazin. Më pas, u kthye sërish. E pyeta:

- Allahu ﷻ të bëftë prej të devotshmëve. A është farz rimarrja e abdestit për çdo namaz apo sunet?

Ai m'u përgjigj:

Mos vallë je duke më ndjekur mua dhe veprimet e mia?

Po! - i thashë.

- Jo nuk është farz. Unë mund t'i falja të gjitha



namazet vetëm me abdestin e marrë për namazin e sabahut. E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ tek thoshte:

*“Atij që merr abdest mbi abdest i jepen dhjetë sevape.”* Unë dëshirova t’i fitoj këto sevape. (Ibn-i Maxhe, Teharet, 73.)

Sahabët merrnin abdest në mënyrë të rregullt duke i dhënë hakun çdo pjese të abdestit. Ebu Hazim nga Tabinët kishte parë **Ebu Hurejren** ﷺ tek merrte abdest, duke larë krahët deri poshtë dhe e pati pyetur:

O Ebu Hurejre! Ç’është ky lloj abdesti kë-shtu?

O Ebu Ferruh! Këtu ishit ju? Sikur ta dija se ishit këtu nuk merrja abdest në këtë mënyrë. Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ tek thoshte:

*- Në ditën e gjykimit, drita dhe shkëlqimi i besimtarit arrin deri aty, ku ka mbërritur uji i abdestit.* (Muslim, Taharet, 40.)

Një ditë Profeti ﷺ kishte shkuar në varreza dhe kish thënë:

*- Selam ju qoftë juve besimtarë të botës tjetër! Le të shpresojmë që një ditë edhe ne do jemi pranë jush. Sa shumë deshët t’i shihnit vëllezërit tuaj!*

Ashabët e pyetën Profetin ﷺ, ashtu të habitur:



- Pse, nuk jemi ne vëllezërit tuaj, o i Dërguar?

- Ju jeni sahabët e mi, ndërsa vëllezërit e mi janë ata që akoma nuk kanë ardhur në jetë, u përgjigj Profeti ﷺ.

- Si do i njihni ata që nuk kanë ardhur akoma në këtë jetë, o i Dërguari i Allahut?

- Mendoni sikur balli dhe këmbët e dikujt janë një kalë i bardhë. A nuk do mund ta njihnit atë kalorës në mesin e të tjerëve të zinj?

- Po, i Dërguar, do e njihnim.

- *Ja pra, edhe vëllezërit e mi do të vijnë fytyrëndritur me duar dhe këmbë të shndritshme, pasi ata kanë qenë me abdest. Unë do shkoj më përpara, që t'i pres ata. Bëni kujdes! Disa do të përzihen nga vendi prej melekëve, sikurse deveja që përzihet nga kopeja e huaj. Unë do u sugjeroj atyre që të vijnë këtu. Ndërsa mua do më thuhet:*

- *Ata i ndryshuan mendimet e tyre mënjeherë pas teje. Ata nuk e pranuan sunetin tënd dhe devijuan rrugën. Ndërsa unë do t'u përgjigjem:*

- *Qofshin sa më larg, qofshin sa më larg!* (Muslim, Teharet, 39; Fedail, 26; Nesai, Teharet, 110/150; Ibn-I Maxhe, Zuhd, 36; Muvatta, Teharet, 28; Ahmet, II, 300, 408.)





## Namazi ishte drita e syve të tyre

Besimtarët e Epokës së Lumturisë, kur falnin namaz, përjetonin një kënaqësi shpirtërore, me qëllim që **“të lidheshin me Allahun ﷻ”**. Namazet i falnin me një përkushtim dhe mall shumë të madh, si të ishte namazi i fundit i një njeriu që ndahet nga jeta.<sup>18</sup>

**Sa'd bin Ebi Vakkas** ﷺ tregon:

Ishin dy vëllezër. Njëri prej tyre ndahet nga jeta dyzet ditë përpara tjetrit. Pejgamberit i folën për virtytet e vëllait që vdiq i pari.

- *A nuk ishte mysliman tjetri?* - pyeti Profeti ﷺ.

- Po, o i Dërguar, edhe ai ishte mysliman. Atëherë nisi të fliste për vëllanë që kish vdekur më pas:

- *Nga mund ta dini ju se çfarë i kanë dhënë atij namazet e falura? Namazi i ngjan një lumi me ujë të bollshëm dhe të ëmbël që rrjedh para shtëpisë së njerit prej jush dhe ku çdo ditë, secili hyn dhe lahet pesë kohët e faljes. Si mendoni, në një situatë të tillë, a mbetet ndonjë njollë në të? Ju nuk mund ta dini se në ç'shkallë e ka sjellë namazi atë!* (Muvatta, Kasru's Salat, 91.)

**Ebu Talha** ﷺ po falte namaz nën hijen e pemëve të oborrit. Zogu Dubsi fluturoi për të gjetur

18. Shih: Ibn-I Maxhe, Zuhd, 15, Ahmed, V, 412.



një strehë, u soll sa andej këndej dhe u kthye. Kjo i pëlqeu shumë Ebu Talhas, i cili në një moment e ndoqi me sy. Më pas vijoi sërisht namazin, por s'u kujtua sa reqate kishte falur. "Ky më ngatërroi, më prishi qetësinë!" -tha me vete, dhe shkoi tek i Dërguari i Allahut ﷺ. I tregoi se çfarë i kishte ndodhur në oborrin e shtëpisë:

- O i Dërguar! Kjo pasuri e imja është sadaka për hir të Allahut, mund ta përdorni si të dëshironi, mund ta jepni ku të dëshironi. (Muvatta, Salat, 69.)

Kështu i pati shkruar Omeri ﷺ valive të tij:

- Sipas meje, puna më me rëndësi për ju është namazi. Kush i respekton rregullat dhe tregohet i kujdesshëm për kohët e namazit, ka mbrojtur njëkohësisht edhe fenë e tij. Kush e nënvlerëson namazin, ka nënvlerësuar akoma më shumë edhe urdhrat e tjera të fesë. (Muvatta, Vukutu's Salat, 6.)

Misver bin Mahreme ﷺ tregon:

Shkova tek Omer bin Hattabi ﷺ (kur u plagos me hanxhar). Kishte hedhur mbi supe një mbulesë dhe ishte shtrirë në atë mënyrë që të jepte përshtypjen se kishte humbur vetveten. Pyeta përreth:


- Si duket?

- Siç e sheh, - më thanë.


- Çojeni në namaz, u thashë, asgjë s'mund ta



shpëtojnë atë përveç namazit.


- O udhëheqësi i besimtarëve , ejani në namaz!  
Omeri  u ngrit dhe tha:

- Betohem për Allah se kush e lë namazin nuk ka vend në Islam! (Hejthemi, 1, 295; Veçanërisht shihni Muvatta, Taharet, 51; Ibn-I Sa'd, III, 35.)


Edhe **Aliu**  i pati thënë njërit prej nëpunësve:

- **Çdo gjë varet nga namazi yt!**<sup>19</sup>

Ala bin Abdurrahman tregon këtë ndodhi:

Një ditë shkuam tek **Enes bin Malik** . Me të vajtur aty, Enesi u ngrit për të falur namazin e iqindisë. I tërhoqëm vëmendjen, pasi namazin e fali herët. Ai u shpjegua:

- Kam dëgjuar se Pejgamberi  ka thënë:

*Ai është namazi i munafikëve (pra ata që në zemrat e tyre kanë shenja nifaku). Ai është namazi i munafikëve! Ai është namazi i munafikëve! Njëri prej tyre ulet për një çast dhe, sapo u duk se dielli po perëndonte dhe shejtani ishte futur mu në mes ngrihet, ulet e ngrihet katër herë me të shpejtë, sikurse zogu që mbledh ushqimin e tij në tokë, dhe kështu nxitimthi e fal namazin duke e përmendur shumë pak Allahun . (Muvatta, Kuran-I Kerim, 46; Muslim, Mesazhid, 195.)*

19. Abdulaziz Çavis, Përgjigje Kishës Anglikane, fq 96.



Sahabët i respektonin mjaft mirë të gjitha rregullat e namazit, pasi ishin këshillat e Pejgamberit. Një ditë, Huzejfe hyri në mesxhid dhe vuri re një person që po falej, por nuk po binte as në ruku e as në sexhde. Më të përfunduar e pyeti:

- Sa vite ke që falesh kështu?

- 40 vjet, iu përgjigj.

Ti paske 40 vjet që nuk paske falur namaz. Nëse vdes duke u falur në këtë mënyrë, ndahesh nga kjo botë me një natyre të ndryshme nga ajo e Pejgamberit ﷺ (ose nuk vdes në natyrën e Pejgamberit). Më pas i mësoi si duhej ta falte namazin dhe vijoi:

- Njeriu mund ta falë namazin nxitimthi, por me kusht që fjalët e rukusë dhe sexhdes t'i plotësojë paktjetër. (Pra të respektojë rregullat e namazit) (Ahmed, V, 384; Buhari, Ezan, 119; 132; Salat, 26.)

### **Nuk ngeleshin pas xhematit**

Çështja më parimore e shoqërisë së Epokës së Lumturisë është shmangia e konceptit të farefisit dhe vendosja në vend të tij e ndërgjegjesimit të vëllazërimit dhe krijimit të atmosferës së një bashkimi të mahnitshëm. Shembulli më i qartë dhe më i dukshëm i këtij vëllazërimi dhe bashkimi në të përditshmen tonë është namazi i falur me xhemat.



Profeti ﷺ e njihte mjaft mirë xhematin e tij, aq sa menjëherë e dallonte mungesën e ndonjërit prej sahabëve. Shpesh pyeste: - *A erdhi filani në namaz? Ku është shoku juaj? Ku është shërbyesi yt?* Nëse dikush ishte i sëmurë, merrte me vete një mikun e tij dhe i shkonte për vizitë, kujdesej nga afër për të, se e thirrste pranë dhe ia kryente punën që kishte.

Profeti ﷺ e nxiste ymetin e tij për t'iu bashkuar xhematit, duke u thënë:

*Kur ta shihni dikë që e ka bërë zakon të shkojë në xhami, dëshmoni për besimin e tij. Allahu ﷻ thotë:*

***“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit.”*** (Tevbe, 18,) (Ibn-i Maxhe, Mesaxhid)

Një nga shenjat e besimit është vijimësia në xhemate, nisur nga fakti i plotësimit të xhamisë me xhemat.

**Abdullah bin Mes'ud** , një nga sahabët e njohur të asaj kohe, thoshte:

Betohem për Allah se nuk kam parë kënd të mbesë prapa namazit, përveç një munafiku, nifaku i të cilit dihet. Betohem për Allah se njeriu, qoftë edhe i sëmurë, sillet në xhami dhe i bashkohet xhematit duke u vendosur mes dy njerëzve dhe me ndihmën



e tyre mbahet në rresht. (Muslim, Mesaxhid, 256-257)

Në kohën e Profetit ﷺ kishte dy myslimanë. Njëri ishte tregtar, ndërsa tjetri farkëtar. Tregtari, me të dëgjuar ezanin, linte mënjanë peshoren, nëse e kishte në dorë, e nëse e kishte në tokë e linte ashtu siç ishte dhe vraponte për në xhami.

Kurse mjeshtri i hekurit, nëse e kishte në dorë çekiçin e linte siç ishte, por nëse ishte në goditje e sipër e hidhte prapa dhe vraponte drejt mesxhidit të Profetit ﷺ. Për të kujtuar këta persona dhe të tjerë të ngjashëm, Allahu ﷻ zbriti këtë ajet kuranor:

**“Njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun, ata të cilët falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.”** (Nur, 37, Kurtubi, XII, 184.)

Një ditë **Ibn Mes’ud** ﷺ kishte parë njerëz që kishin lënë mallrat e tyre dhe kishin vrapuar në mesxhid. Më pas kishte menduar me vete:

Ja pra, këta janë ata që Allahu ﷻ përmend në ajetin 37 të sures Nur. (Hejthemi, VII, 83)

### **Zekatin e jepnin me kënaqësi**

Shoqëria e Epokës së Lumturisë i jepte shumë rëndësi zekatit. Allahu ﷻ në shumë ajete kuranore

urdhëron shpesh edhe dhënien e zekatit sikurse edhe faljen e namazit. Ata e bënë këtë me një emocion mjaft të madh, thuajse atë zekat ia jepnin në dorë vetë Allahut ﷻ. Xhaxhai i Profetit, Abbasi, pati pyetur nëse lejohej apo jo dhënia e zekatit pa u mbushur akoma viti, me qëllim të përshpejtonte në mirësi. I Dërguari i Allahut ﷺ, e pati lejuar për këtë veprim. (Ebu Davud, Zekat, 22/1624; Tirmidhi, Zekat, 37/678; Ibn-I Maxhe, Zekat, 7; Ahmet, I, 104; Darimi, Zekat, 12.)

Një grua nga të afërmit e Profetit ﷺ, bashkë me vajzën e saj, i kish bërë vizitë një ditë të Dërguarit. Në krahun e vajzës kishte dy bylyzykë të trashë floriri. Profeti pyeti:

- *A e jep zekatin e këtyre bylyzykëve?*

Jo, iu përgjigj.

I Dërguari i Allahut ﷺ vijoi:

- *A do të pëlqente sikur në ditën e gjykimit Allahu ﷻ të të vendoste në vend të tyre dy bylyzykë zjarri?*<sup>20</sup>

Gruaja i hoqi menjëherë dhe ia drejtoi Profetit ﷺ, duke thënë:

- *Këta janë të Profetit ﷺ (le t'i dhurojë ku të dëshirojë).* (Ebu Davud, Zekat, 4/1563.)

---

20. Lidhur me zekatin e sendeve për stoli dijetarët nuk kanë qenë të një mendimi. E rëndësishme është që të jepet.



Një delegacion prej trembëdhjetë vetësh nga fisi **Beni Tuxhib**, kishte shkuar te Profeti ﷺ, duke sjellë me vete edhe mallrat e tyre për zekat. Kjo i pëlqeu shumë Pejgamberit ﷺ, i cili u uroi mirëseardhjen mysafirëve. Më pas urdhëroi Bilal Habeshin që t'u rezervonte një pritje sa më të mirë.

Të deleguarit e Beni Tuxhib iu drejtuan Profetit ﷺ:

- O i Dërguari i Allahut! Të sollën atë që i takon Allahut ﷻ, nga pasuria jonë.

- *Merrini me vete dhe shpërndajuni të varfërve* - iu përgjigj Profeti ﷺ.

- O i Dërguar! Ne ju sollëm atë që teproi nga ajo që u dhamë të varfërve, - vijuan ata.

- O i Dërguar!, - foli Ebu Bekri ؓ, në fakt nuk ka njerëz më të drejtë se këta të deleguar të Tuxhibit.

- *Udhëzimi është në dorë të Zotit*, - u përgjigj Profeti ﷺ. *Allahu ﷻ ia hap zemrën atij që dëshiron ta udhëzojë në rrugë të drejtë.*

Të deleguarit Tuxhib e pyetën Profetin ﷺ rreth disa çështjeve nga Kurani dhe Suneti. Përgjigjet i dhanë me shkrim. Si rezultat i përpjekjeve të tyre, u rrit edhe interesimi i Profetit ﷺ ndaj tyre. Pasi qëndruan për ca ditë, kërkuan leje të largoheshin.

Përse nxitua? - i pyetën ata.






- Do t'u tregojmë njerëzve tanë që kemi lënë ato që pamë nga Profeti ﷺ dhe ato që mësuam nga përgjigjet e pyetjeve që bëmë, - u përgjigjën ata.

Erdhën tek i Dërguari dhe u përshëndetën për t'u ndarë. Profeti ﷺ dërgoi Bilali Habeshin tek ata. E urdhëroi që t'u jepeshin dhurata dhe të respektoheshin më shumë se të deleguarit e tjerë. (Ibn-i Sa'd, 1, 323; Ibn-i Kajjim, III, 650-651.)

Ja si tregon **Ibn-i Abbasi** :

- I Dërguari i Allahut ﷺ, një ditë Bajrami, shkoi në xhami dhe fali vetëm dy reqate namaz. Ai nuk fali ndonjë namaz tjetër, as para dhe as pas. Pasi përfundoi ligjëratën për meshkujt, u afrua pranë vendit ku ndodheshin gratë, meqenëse nuk e dëgjonin. Aty pranë ishte edhe Bilali. Edhe atyre u ligjëroi dhe i këshilloi të jepnin sadaka. Më pas nisën të hidhnin në prehrin e Bilalit bylyzykët, vathët e tyre prej floriri dhe sermi. (Shih Buhari, Zekat, 21, 33.)

**Ibn-i Abbasi**  pohoi se të tregohesh indiferecent ndaj adhurimeve financiare është një humbje e madhe dhe i këshilloi njerëzit duke u thënë:

- Kush ka pasuri për të shkuar në haxh apo për të dhënë zekatin dhe nuk i kryen këto farze, në momentin e vdekjes do kërkojë të kthehet sërish në këtë jetë. Më tutje lexon këto ajete:

**“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe**



fëmijët tuaj t'ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin. Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t'i vijë vdekja ndonjërit e ai të thotë: O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!” (El-Munafikun, 9-10) (Tirmidhi, Tefsir, 63/3316.)

Njerëzit e Epokës së Lumturisë ishin tepër të kujdesshëm për mallrat e zekatit që kishin në pronësi.

Një ditë, Ahmet bin Kajs kishte ardhur tek Omeri رضي الله عنه së bashku me të deleguarit e Irakut. Ishte një ditë shumë e nxehtë. Omeri رضي الله عنه kishte vënë një përparëse, po milte njërën prej deveve që e kishte për zekat dhe po kujdesej për të. Me t'i vënë re, u tha:

- Ahnef, ndërroi rrobat dhe eja të më ndihmosh! Ajo është deve sadakaje. Këtu kanë pjesë jetimët, gratë e veja dhe të vetmuarit.

Njëri prej tyre u ngrit dhe tha:


- Allahu الله të gjykoftë sipas mëshirës tënde, o prijësi i besimtarëve! A nuk është e mundur të urdhërosh njërin prej robërve të tu dhe ta bëjë ai këtë punë?


Omeri رضي الله عنه dha një përgjigje mjaft të hijshme:

- O njeri, a mund të ketë robër më të mirë se



Omeri dhe Ahmeti? Meqenëse ai i ka marrë përsipër punët e myslimanëve, atëherë ai mbetet të jetë edhe robi i tyre. Siç i nevojitet një robi të respektojë të zotin e tij dhe ta kryejë me përpikmëri detyrën e vet, ashtu i duhet të sillet edhe ndaj myslimanëve. (Al-i el-Muttaki, V, 761/14306.)

Ka edhe transmetime të tjera, përsëri lidhur me një veprim të Omerit , sipas të cilit, një ditë kish vrapuar të kapte devenë për zekat që i kish ikur nga duart, ndërkohë njerëzit e kishin këshilluar që t'i vinte në punë shërbyesit e tij, ai u ishte përgjigjur atyre me të njëjtën mënyrë.

Shoqëria e Epokës së Lumturisë, e cila i jepte një rëndësi të veçantë dhënies së zekatit, kishte arritur një formim shpirtëror të atillë që, kur halifeja i asaj kohe, **Omer bin Abdulaziz**  kishte dërguar në Afrikë nënpunësin e zekatit, ky i fundit ishte kthyer pa arritur t'i shpërndante mallrat, pasi s'kishte gjetur dikë që të merrte zekat. Më pas ai me ato para kishte blerë shumë robër.<sup>21</sup>

### **Infaku dhe tasaduku ishin boshti i jetës së tyre**

Shoqëria e Epokës së Lumturisë e kishte kuptuar më së miri se dhënia e sadakasë do ta mbronte

---

21. Said Ramazan el-Buti, Fikhu's Sire, Bejrut, 1980, fq 434.

njeriun prej shumë rreziqeve dhe fatkeqësive, duke e afruar më shumë me dashurinë hyjnore. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

**“Shpenzoheni pasurinë<sup>22</sup> në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”** (el-Bekare, 195.)

Një nga sahabët e asaj kohe **Ummu Buxhejd** رضي الله عنها vjen tek Profeti ﷺ dhe thotë:

- O i Dërguari i Allahut! Paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi Ty! Ka raste që na vjen ndonjë i varfër në derë dhe s’kemi ç’t’i japim...

- *Edhe sikur të mos kesh asgjë me vlerë për t’i dhënë, jepi diçka në dorë qoftë kjo edhe diçka pa vlerë. Mos e kthe bosh,* - u përgjigj i Dërguari ﷺ. (Ebu Davud, Zekat, 33/1667; Tirmidhi, zekat, 29/665; Nesai, Zekat, 70/2566; Ahmet, VI, 383.)

Një besimtar, edhe sikur të mos ketë asgjë për të dhënë, mjafton t’i thotë nevojtarit qoftë edhe një fjalë të ëmbël. Allahu i Lartmadhëruar, në një situatë të tillë, urdhëron të thuhet një fjalë e ëmbël që të ngroh shpirtin dhe të lumturon.

**Ebu Mes’ud el-Ensari** رضي الله عنه e shpreh kështu be-

---

22. Infaku (dhënia) përfshin zekatin si farz dhe çdo mirësi të bërë në mënyrë vullnetare. (Mustafa Çagrici, çështja Infak... Enciklopedia Islame e Komunitetit Mysliman XXII 289.)



gatinë e infakut:

- Me të na urdhëruar i Dërguari i Allahut ﷺ për sadaka, njëri prej nesh dilte në pazar, fitonte disa myd<sup>23</sup> (mall) nga ajo që shiste dhe ato i jepte sadaka. Një pjesë e tyre sot kanë njëqind mijë dinarë. (Buhari, Zekat, 10)

Profeti ﷺ pati thënë:

*“Secili të qendojë në hijen e sadakasë, deri në daljen e një ligji mes njerëzve.”*

Ebu'l-Hajr, i cili transmeton këtë hadith, çdo ditë përpiquej të jepte patjetër një sadaka, qoftë kjo një copë kek, një qepë apo edhe gjëra të tjera ushqimore... (Ahmet, IV, 147-8; Hejthem, III, 110.)

Tregon **Omeri** ﷺ:

I Dërguari i Allahut ﷺ, na ka urdhëruar të japim sadaka. Atë kohë kisha edhe pasuri, - Nëse do t'ia kaloj Ebu Bekrit këtë mund ta bëj vetëm sot, mendova me vete dhe kështu gjysmën e pasurisë ia dhashë Profetit ﷺ:

- *Ç'i le familjes?* - pyeti.

- Atyre u kam lënë sa ç'kam sjellë këtu.

Ndërsa **Ebu Bekri** ﷺ, ç'kishte nga pasuria e tij e mori dhe e solli aty. I Dërguari pyeti:

---

23. Njësi matëse në peshën 687 gr.



- Ç'i le familjes? - ndërsa Ebu Bekri ؓ vijoi e tha:

- U lashë Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

Ishte ai moment, ku unë thashë me vete: “Be-tohem për Allah se atë s’mund ta kaloj për asgjë.” (Tirmidhi, Menakip, 16/3675.)

Sipas rrëfenjës së **Abdurrahman bin Ebu Amre** ؓ, e ëma kishte dashur të lironte një rob dhe këtë punë e kishte lënë ta kryente në mëngjes, por kishte ndërruar jetë. pa u gdhirë. Kishte shkuar më pas te Kasim bin Muhamed dhe e kishte pyetur:

- A mund të liroj një rob në emër të nënës sime?

Kasimi qe përgjigjur:

- **Sa’d bin Ubade** ؓ kishte ardhur tek Profeti ؓ dhe e kishte pyetur:

“- Ime më vdiq. A ka ndonjë dobi për të nëse liroj një rob në emër të saj?”

“- Po!” - i qe përgjigjur Profeti ؓ. (Muvatta, itk 13.)

Po kështu kemi edhe një transmetim të **Aishes** ؓ, sipas të cilit një person vjen te Profeti ؓ dhe e pyet:

- Ime më ndërroi jetë papritur. Kam përshtypjen se, nëse do të kishte mundësi të fliste, do të jepte sa-

daka patjetër. A mund të jap unë në vend të saj?

- *Po, jep në vend të saj. Iu përgjigj Profeti ﷺ.*  
(Buhari, Vasaja, 19; Ebu Davud, Vasaja, 15/2881.)

Një nga sahabët e njohur, **Haris bin Numan** ﷺ kishte humbur shikimin. Kishte lidhur një pe nga mesxhidi deri në dhomën e tij dhe m'u pranë, kishte vendosur një kosh, brenda të cilit kishte vënë hurma dhe gjëra të tjera. Kur një i varfër kalonte andej dhe jepte selam, merrte diçka nga koshi, mbahej për pe dhe vinte deri në derën e dhomës së tij dhe vetë ia jepte të varfërit. Familjarët insistonin, duke i thënë:

- Japim ne në emrin tënd.

- Kam dëgjuar Pejgamberin ﷺ tek thoshte: - *Ai që i jep të varfërit me dorën e tij mbrohet nga vdekja e rëndë, u thoshte ai.* (Ibn-i Sa'd, III, 488; Taberani, Kebir, III, 229, 231; Hejthemi, III, 112.)

**Aishja** ﷺ tregon:

Profeti ﷺ u kishte thënë grave:

- *Ajo që do më arrijë më shpejt dhe më herët është ajo që krahët i ka më të gjatë.*

Ato matnin krahët me njëra-tjetrën se cila i kishte më të gjatë. Krahët më të gjata i kishte **Zejnebi** ﷺ, ajo punonte me duart e veta dhe, në të njëjtën kohë, jepte sadaka. (Muslim, Fedailu'l Sahabe, 101.)



Pra njeriu i epokës së lumturisë bëhej pjesë e kësaj sadakaje me të varfrin e me të pasurin, me të shëndetshmin dhe me të sëmurin.

Një ditë, një i varfër kishte ardhur te **Osmani** dhe e kishte pyetur:

- O njerëz të pasur! Kini marrë gjithçka dhe jepni sadaka nga pasuria juaj, lironi robërit, shkoni në haxh dhe jepni sadaka.

- Ju në të vërtetë, a na kini zili? - pyeti Osmani.

- Po, për atë Zot, ju kemi zili, - u përgjigjën

- Betohem për Allah se, një dirhem i dhënë sadaka nga një njeri në kushte shumë të vështira, është shumë më me vlerë se mijëra dirhemë të dikujt që ka pasuri të madhe, vijoi Osmani. (Bejhaki, Shuap, III, 251; Al-i el-Muttaki, VI, 612/17098.)

### **E kishin kuptuar se s'ka të ngjashëm me agjërimin**

**Ebu Umame** i kishte kërkuar Profetit:




- Më këshillo për një vepër për të cilën Allahu do të më shpërblejë.

- *Të këshilloj agjërimin sepse nuk ka diçka tjetër të ngjashme me të, i qe përgjigjur Profeti.*


(Nesai, Sijam, 43.)










**Ummu Ejmen**  ish nisur për Hixhret tek Allahu  dhe i Dërguari i Tij . Ishte agjërueshëm. Me vete s'kishte as për të ngrënë, as për të pirë dhe as mjet udhëtimi. Po udhëtonte në të nxehtin e tmerrshëm të shkretëtirave Tihane. Po vdiste nga uria dhe etja. Me të afruar koha e iftarit, ndjeu mbi kokë një shushuritje. Me të ngritur kokën vuri re një kovë të varur me një pe. Ja si e tregon:

- Mora kovën dhe piva deri sa shova etjen. Më vonë nuk ndjeva më etje.

Ummu Ejmen  agjëronte dhe bënte tavaf Qaben nën diellin përvëlues, duke menduar me vete nëse vallë ndiente apo jo etje. Megjithëse bënte tavaf, sërisht nuk ndiente etje. Kjo vijoi deri sa vdiq. (Abdurrazzak, Musanned, IV, 309; Ebu Nuajm, Hilje, II, 67; Ibn-i Haxher, Isabe, VIII, 170; Ibn-i Sa'd, VIII, 224.)

**Hamza**  kishte bërë nijet për agjërim, ndërkohe po nisej për në luftën e Uhudit. Kishte menduar me vete që, nëse binte dëshmor, do të dilte para Allahut  agjërueshëm.

Enes bin Malik  thotë:

Njerku im, **Ebu Talha** , në kohën e Pejgamberit , nuk agjëronte shumë nafile, për të luftuar më lehtë me armikun. Me vdekjen e Pejgamberit , e kam vënë re se përherë rrinte agjërueshëm. Nuk agjëronte vetëm në ditët e Bajramit të Ramazanit

dhe të Kurbanit. (Buhari, Xhihad, 29.)

Ebu Talha رضي الله عنه ishte një nga heronjtë më të guximshëm të fushës së betejës. Për të qenë i fuqishëm ndaj armikut, nuk agjëronte shumë nafle, preferonte më shumë xhihadin në vend të agjërit. Por kur erdhi koha për të dalë në xhihad, u mor më shumë me agjërim dhe pjesën më të madhe të kohës e kalonte agjërueshëm. Transmetohet se pas vdekjes së Pejgamberit صلى الله عليه وسلم, ka jetuar edhe 24 vite në këtë gjendje.


Nisur nga një transmetim i Enesit, **Ebu Talha** رضي الله عنه, aty nga fundi i jetës së tij pati lexuar këtë ajet kuranor:

**“O besimtarë! Dilni në luftë, qofshi të shëndoshë ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e Allahut! Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit!”** (et-Teube, 41.)

- Allahu الله kërkon prej nesh të jemi të gatshëm për luftim, si në rini edhe në pleqëri. Më përgatitni mjetet e luftës! - tha më pas.

- Bëjmë ne xhihad në vendin tënd, - i thanë fëmijët, por ai nguli këmbë në të tijën. Ia përgatitën mjetet dhe Ebu Talha u nis në një udhëtim në det, ku edhe ndërroi jetë. Vetëm pas shtatë ditësh arritën ta varrosnin. Gjatë kësaj kohe trupi i tij nuk pësoi asnjë deformim. (Ibn-i Haxher, Ferhu'l Birr, Xhihad, 29.)




Në një udhëtim e kishin shoqëruar **Ebu Burde**  dhe Jezid bin Ebi Keshhe. Jezidi i jepte një rëndësi të veçantë agjërimit, prandaj edhe këtë herë ishte agjërueshëm. Ebu Burde iu drejtua:

E kam dëgjuar shumë herë babanë tim (Ebu Musa) të thoshte:

I Dërguari i Allahut  ka thënë:

*Kur robi është i sëmure apo në udhëtim, i jepen të njëjtat sevape të adhurimeve nafle që ka bërë kur ka qenë në gjendje të mirë.* (Buhari, Xhihad, 134.)

Muajt e Ramazanit në epokën e lumturisë përjetoheshin me mjaft emocione dhe këtë atmosferë shpirtërore besimtarët ua përcillnin edhe bijve të tyre. Omeri  në kohën e hilafetit të tij i kishte thënë njërit që ish dehur në muajin e Ramazanit:

- Turp të kesh! Edhe fëmijët tanë agjërojnë!  
(Buhari, Savm, 47.)

Nuk do të isha në këtë botë, po të mos ekzistonin tri parime: të vendosja ballin në sexhde ditë natë për Krijuesin tim dhe të përgatitesha në këtë mënyrë për jetën e amshueshme, **të përballesha me etjen, me agjërime në momentet më të nxehta të ditës**, të qëndroja me ata njerëz të cilët dinë të zgjedhin fjalët ashtu siç zgjedhin edhe më të mirat e frutave. (Munavi, Fejzul kadir, II, 11/1193.)



## Ata jepnin jetën për të kryer haxhin dhe umren

Sahabët i jepnin shumë rëndësi haxhit dhe umres. Ata jepnin jetën për të bërë tavaf Qaben dhe nuk i linin asnjëherë këto adhurime. E shijonin thellësisht ajrin shpirtëror të atyre qyteteve të bekuara, ngopnin shpirtrat me ushqimet shpirtërore të Haremejnit. Ndiqnin gjurmët shpirtërore të gjithë pejgamberëve, duke nisur që nga Ademi عليه السلام, duke u ushqyer me kujtimet domethënëse të tyre dhe, në vendet ku ndodheshin, në çdo moment përmendnin Allahun ﷻ.

**Bera bin Ma'rur** رضي الله عنه, njëri nga dymbëdhjetë përfaqësuesit që mori pjesë në fushatën e parë të pranimit, një vit më vonë premtoi se në kohën e haxhit do të shkonte në Mekë për t'i bërë një vizitë Profetit dhe Qabes, por para se të afrohej koha për të cilën kish dhënë fjalën, ra i sëmurë në shtrat. I ndodhur në atë gjendje u tha familjarëve:

- Më ktheni drejt Qabes, pasi i kam dhënë fjalën të Dërguarit të Allahut ﷺ! Unë i pata thënë se do të shkoja duke u bërë kështu i pari që iu drejtua Qabes, si në këtë jetë edhe në tjetrën.

Kur Profeti ﷺ shkoi në Medinë së bashku me sahabët e tij, shkuan për vizitë në varrin e Bernas, formuan një rresht, i falën xhenazen dhe bënë këtë lutje:



- *O Zoti im, fale atë! Mëshiroje dhe pajtohu me të!* (Ibn-i Abdulber, I, 153; Ibn-I Sa'd, III, 619-620.)

**Aishja** ﷺ thotë:

Pyetën Profetin ﷺ:

O i Dërguar! A s'është e mundur të vijmë edhe ne në xhihad së bashku me Ty?

*Xhihadi më i mirë për ju është haxhi, u përgjigj Ai. Që kur e dëgjova këtë fjalë nga Profeti nuk e kam lënë asnjëherë haxhin!* (Buhari, Xhezau'l Sejd, 26.)

Omeri ﷺ një ditë i kërkoi leje Profetit të bënte umre:

- *Vëllai im i dashur, mos na harro edhe ne në lutjen tënde!*

Me të dëgjuar këtë, Omeri ﷺ tha:

- Kjo mënyrë komunikimi e Pejgamberit ﷺ me mua, vlen sa e gjithë bota. Sikur gjithë botën të ma jepnin, nuk do të isha gëzuar kaq shumë, - duke shprehur kështu domethënien kaq të madhe që kishte kjo shprehje e profetit për sahabët. (Shih, Ebu Davud, Vitir, 23/1498; Tirmidhi, Deavat, 109/3562; Ibn-i Maxhe, Menasik, 5.)

Ata nuk nguronin të sakrifikonin për të kryer haxhin dhe umren. Aishja ﷺ, e cila nuk arriti të



shkonte në umre për arsye shëndetësore, pati thënë:

- O i Dërguar! Njerëzit sapo janë duke u kthyer nga haxhi dhe umreja, ndërsa unë përfundova vetëm haxhin.

- Prit, - vijoi Profeti ﷺ, kur të pastrohesh (bashkë me vëllaun tënd Abdurrahmanin), shkoni deri në Ten, që aty hyni në ihram me qëllim kryerjen e umres dhe kryeni telbije! Pasi të përfundoni umren, ejani tek ne në filan vend. **Ta dish se sevapi i kësaj umreje është sa ai i sakrificave që do bësh për këtë umre.** (Buhari, Umre, 8.)

Sahabët ishin shumë të kujdesshëm gjatë haxhit. Profeti e këshilloi **Omerin** ؓ të bënte kujdes gjatë tavafit:

- O Omer! Ti je një burrë i fortë. Mos i shtyj dhe mos i mundo njerëzit e dobët për të arritur te Haxheru'l Esved. As mos u shqetëso as mos i shqetëso të tjerët. Nëse gjen qetësi, afrohu Haxheru'l Esvedit dhe puthe atë, në të kundërt, bëji nga larg një shenjë sikur e ledhaton dhe e puth, thuaj fjalën e dëshmisë dhe largohu! (Ahmed, I, 28; Hejthemi, III, 241.)

Gratë gjatë tavafit nuk futeshin në mesin e burrave. Aishja ؓ bënte tavaf në një vend larg burrave dhe nuk futej në mesin e tyre. Një grua pranë saj i tha:

- O nëna e besimtarëve! Eja të shkojmë së bash-



ku ta prekim dhe ta puthim Haxheru'l Esvedin, por Aishja ﷺ nuk e pati pranuar.

**Aishja** ﷺ me disa mikeshja të saj, mbuloheshin mirë që të mos i shihte kush dhe natën dilnin të bënin tavaf. Kur dëshironin të hynin në shtëpinë e Allahut ﷻ për të kryer adhurimet përkatëse, burrat prisnin përjashta deri sa ato të përfundonin. (Buhari, Haxh, 64.)

Një herë, Profeti do largohej nga Meka, por e shoqja **Ummu Seleme** ﷺ akoma s'kish bërë tavaf. Duke marrë shkas nga kjo, i Dërguari i tha:

*- Kur të thirret ikameti për namazin e sabahut, ndërkohë që njerëzit falin namazin, ti bëj tavaf mbi deve prapa tyre.* (Buhari, Haxh, 71.)

**Ummu Seleme** ﷺ thotë:

Gjatë kohës së haxhit i tregova Profetit ﷺ se isha e sëmurë. Ai më tha: - *Hip në deve dhe bëj tavaf prapa njerëzve!* Unë ashtu veprova. Ai po falte namazin e sabahut pranë shtëpisë së Allahut ﷻ dhe lexoi suren që fillonte kështu: 've-turi ve kitabi mestur' (Buhari, Haxh, 64.)

Nga këto ajete kuptohet se gratë mund të bëjnë tavaf me burrat, por shihet më e përshtatshme që ato të jenë prapa tyre. Tavafi është një adhurim, sikurse namazi. Ashtu sikurse në namaz gratë falen prapa burrave, edhe në tavaf duhet respektuar një rregull i tillë.



## I jepnin rëndësi mësimimit të Kuranit dhe haditheve

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur Ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.” (Sad, 29.)

“Dilni në luftë, qofshi të shëndoshë ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e Allahut! Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit!” (Fatir, 29.)

I Dërguari ua lexonte ajetet dhe hadithet fillimisht burrave dhe më pas grave.<sup>24</sup> Myslimanët e mësonin përmendsh shpalljen, ndërsa një pjesë e tyre e shkruanin dhe e ruanin pranë vetes.

Shkrimi i Kuranit ishte i përhapur në mesin e sahabëve. Secili i ishte përkushtuar kësaj pune. Ata që s’dinin të shkruanin, shkonin tek shkruesit e njohur dhe i shkruanin.<sup>25</sup>

Kështu Kurani u shkrua dhe u vu në jetë që në epokat e para të Islamit, e madje që në kohën kur Kurejshitët u përballën me vështirësi të shumta të papërbalueshme. Në vitet e para, **Omeri** ﷺ kishte besuar duke lexuar disa ajete kuranore të shkruara


24. Shih: Ibn-I Ishak, Siret, fq 128.

25. Shih: es-Sunenu'l Kubra, VI, 6.





në një fletushkë.<sup>26</sup>


Profeti i kishte dorëzuar **Rafi bin Malik**  në beslidhjen e parë një tekst kuranor ku kishte të gjitha ajetet dhe suret e shpallura deri atëherë. Ndërsa Rafi, kur u kthye në Medinë, u pati lexuar këto gjithë myslimanëve të mbledhur në xhaminë e parë që kishte ndërtuar në lagjen e vet.<sup>27</sup>

**Abdurrahman bin Mes'ud**  kishte thënë:

Sapo një nga sahabët po hynte në shtëpi, e shoqja e pyeste menjëherë:

1) Sa ajete u shpallën sot?

2) Ç'hadithe mësove nga Profeti? (Abdulhamid Kesh, fi Rihabi't Tefsir, 1, 26.)

Edhe kjo shprehje e mëposhtme e **Abdullah bin Mes'ud** , shpreh qartë lidhjen e ngushtë të sahabëve me Kuranin:

- Betohem për Allah që është një dhe s'ka tjetër, nuk ka sure të Kuranit që të mos e di se kur dhe ku ka zbritur. Nuk ka sure të Kuranit që të mos di se kujt i është zbritur. Nëse del dikush që e di këtë

26. Shih: Ibn-I Hisham, 1, 369-371.

27. Shih: Ibn-I Haxher, Isabe, II, 189, 190; Ibn-I Kethir, el-Bidaje, III. 152; Ibnu'l Esir, Usdu'l Gabe, II, 157, Kettani, Teratip, Bejrut, st, 1, 44; Prof. Dr. M. M. Al Azami, Historia e Kuranit, fq 106; Prof. Dr. M. Hamidullah, Historia e Kuranit. Fq 44.



gjë më mirë nga unë dhe, nëse është e mundur të shkoj tek ai me deve, menjëherë nisem për rrugë.

(Buhari, Fedailu'l Kuran, 8.)

**Abdullah bin Mes'ud** ﷺ u lexonte nxënësve një ajet, ua mësonte dhe më pas u thoshte: - ***Ky ajet është më i vlefshëm se çdo gjë në tokë apo edhe se lindja e diellit!*** Këtë e thoshte për çdo ajet kuranor. (Hejthemi, VII, 166.)

Kjo fjalë e tij është shumë e rëndësishme për të treguar se sa të lidhur ishin sahabët me Kuranin.

Kush e do shkencën, le të mendojë mbi kuptimin e Kuranit dhe të intensifikohet në komentimin e tij. Aty është shkenca e të mëparshmëve dhe e atyre që do të vijnë më pas. (Hejthemi, VII, 165; Bejhaki, Shuab, II, 331.)

Sahabët mblidheshin me njëri-tjetrin dhe diskutonin për ajetet kuranore.<sup>28</sup> **Ashabi Suffi** rrinin shpesh në xhaminë e Profetit ﷺ, lexonin Kuran dhe diskutonin rreth ajeteve përkatëse.<sup>29</sup>

**Omeri** ﷺ futej thellë në meditim për të kuptuar Kuranin dhe për t'i vënë ato në zbatim. Kjo fjalë e tij e mëposhtme është një dëshmi për këtë:


**- E kam përfunduar suren Bakare për dymbëdhjetë vite. (pra arrita ta vë në jetë) dhe**

28. Hatip el-Bagdadi, el-Fakih ve'l Mutefaqih, II, 126.

29. Buhari, Xhihad, 9; Muslim, Imare, 147.




**për këtë bëra kurban një deve.** (Kurtubi, I, 40.)


Sipas një transmetimi të Imam Malikut, **Abdullah ibn Omeri**  ish orvatur plot tetë vjet për të mësuar ajetet e sures Bakare. Ai i lexonte ajetet kuranore, duke i mësuar dhe vënë në jetë.<sup>30</sup>

**Ebu Bekri**  pati thënë:

- Shpjegimi i një ajeti më jep më shumë kënaqësi se sa thjesht ta mësoj përmendsh. (Ibnu'l Inbari, Kitabu'l Izahil Vakf, 1, 23.)

Dikush kishte shkuar tek **Zejd Bin Thabit**  dhe e kishte pyetur se çfarë mendonte lidhur me hatmen për një javë të Kuranit.

- Shumë mirë është, - qe përgjigjur, - por mua më pëlqen të bëj hatme për pesëmbëdhjetë apo njëzet<sup>31</sup> ditë. Nëse pyet arsyen, mund të them se në këtë mënyrë mendoj më thellë rreth Kuranit, duke u thelluar edhe më shumë në kuptimet e tyre. (Muvatta, Kuran, 4.)

**Osmani**  me të përfunduar mbledhjen e Kuranit i nxiti njerëzit ta shkruanin atë për të plotësuar edhe nevojat personale të njerëzve.<sup>32</sup> Me sa duket, njerëzit më parë nuk kanë arritur ta shkruanin të plotë, duke u mjaftuar vetëm me regjistrimin e disa

30. Shih: Muvatta, Kuran, 11; Kettani, Teratip, II, 191.

31. Shih: Ibn-i Abdilberr, Istizkar, II, 477.

32. Shih: Ibn-i Shebbe, Tarihu'l Medine, fq 1002.



ajeteve dhe sureve. Me përfundimin e shpalljes, të gjitha ajetet dhe suret u grumbulluan në një libër nga një delegacion i sigurt dhe, pasi mijëra hafizë morën edhe miratimin e sahabëve, tashmë të gjithë njerëzit lehtësisht mund ta shkruanin Kuranin edhe për vete.

**Ubejdullah bin Abdullah** ؓ njofton se në kohën e Osmanit ؓ Mus'hafi i Medinës, është ruajtur në xhaminë e Profetit ﷺ dhe çdo mëngjes i është lexuar xhematit.<sup>33</sup>

I Dërguari i Allahut ﷺ dhe halifët dërguan mësues në qendra të ndryshme të botës Islame për t'u mësuar njerëzve Kuranin dhe Sunetin.<sup>34</sup> Psh **Mus'ab bin Umer** ؓ është dërguar në Medinë dhe në çdo moment u shpjegonte njerëzve Islamit dhe u lexonte Kuran.<sup>35</sup>


**Ebu Derda** ؓ u dërgua në Stamboll, ku jetoi për një kohë shumë të gjatë dhe krijoi një grupim të fortë. Kishte mbi 1600 nxënës. I ndau në dhjetë grupe dhe në secilin prej tyre vuri mësuesit që e kishin mësuar më parë, duke ndjekur nga afër punën e tyre. Kush e kalonte fazën e parë kishte shansin të merrte mësim drejtpërsëdrejti nga vetë sahabiu. Në



33. Ibn-I Shebbe, Tarihu'l Medine, fq 7; Ibn-i Kutejbe, Te'vilu'l Mushkili'l Kuran, fq 51.


34. Darimi, Synen, 1, 135; (thk Dahman) Ibn-i Sa'd, VI, 3

35. Ibn-i Hisham, II, 43-46; Ebu Nuajm, Delailu Nubuvve, 1, 307; Hejthemi, VI, 41; Dhehebi, Sijer, 1, 182.



këtë mënyrë nxënësit, të cilët ngriheshin në nivele më të larta, merrnin mësim edhe nga Ebu Derda , por njëkohësisht u jepnin mësim edhe atyre që ishin në nivele më të ulëta.<sup>36</sup> E njëjta metodë u aplikua edhe nga sahabët e tjerë në vende të tjera.<sup>37</sup>

**Omeri**  dërgoi Jezid bin Abdullah në vende shumë të largëta nga qendra për t'u mësuar Kuran endacakëve, duke caktuar **Ebu Sufjanin**  të përcaktonte nivelet përkatëse. Nga ana tjetër, dërgoi në Medinë tre sahabë që t'u mësonin Kuranin fëmijëve duke u dhënë edhe nga një rrogë prej 15 dirhemësh dhe urdhëroi që të mësonte secili nga pesë ajete përmendsh, përfshi këtu edhe të rriturit.<sup>38</sup>

**Ibn-i Abbasi**  ishte mësues i Kuranit për nivele të larta. Kudo që shkonte, njerëzit mblidheshin përreth tij. Kur shkoi në Basra, u ngrit para njerëzve dhe u foli, u lexoi suren Bakare dhe u shpjegoi për çështjet përfshirëse.<sup>39</sup>

36. Dhehebi, Sijeru A'lami'n Nubela, II, 344-346.

37. Belazuri, Ensab, 1, 110; Hakim, 1, 220.

38. Prof Dr. M. M. el-Azami, Historia e Kuranit, fq 127; Lidhur me këtë çështje mund të shfrytëzohen edhe këto vepra: **Prof Dr. M. M. el-A'zami**, The History of the Curanc Text from Revelation tu Compilation A Comparative, Study ëith the Old and Neë Testaments, Leicester, UK Islamic Academy, 2003, (Historia e Kuranit Një studim krahasues me Epokën e re dhe të vjetër Stamboll, 2006) **Prof Dr. M. Hamidullah** Historia e Kuranit, Stamboll 2000, (Pjesa hyrëse e Le Saint Coran)

39. Hakim, II, 300/3083



Një herë **Aliu** ﷺ dëgjoi të vinin zëra nga Mesxhidi i Kuffes dhe pyeti se ç'kishte ndodhur. Më pas mori një përgjigje të tillë:

- Disa po lexojnë dhe mësojnë Kuran.

Aliu ﷺ vijoi:

**- Sa të lumtur janë ata! Ata ishin njerëzit më të dashur të Profetit!** (Hejthemi, VII, 162.)




Muxhahidi, një nga komentatorët e njohur të Kuranit të kohës së Tabiinëve (v. 103 h.), njofton se **Ibn-i Ebu Lejla** ﷺ (v. 83 h.), një dijetar i njohur i hadithit, fikhut dhe leximit të Kuranit, kishte hapur një bibliotekë vetëm me Kurane, me qëllim që njerëzit të mblidheshin dhe të lexonin.<sup>40</sup>

**Ebu Abdurrahman Es-Sulemi** ﷺ ishte njëri nga ata që kishte nisur detyrën e mësuesit të leximit të Kuranit në kohën e halifatit të Osmanit ﷺ, detyrë, të cilën e vijoi për një kohë të gjatë.



- Arsyeja e vetme për të cilën ndodhem këtu, është dëshira për t'iu bindur fjalës së Profetit: - *Më i vlefshmi në mesin tuaj është ai që mëson dhe ua mëson të tjerëve Kuranin*, - thoshte ai duke nënkuptuar mesxhidin, në të cilin ai ishte prijës dhe mësues Kurani. (Buhari, Fedailu'l Kuran, 21; Tirmidhi, Fedailu'l Kuran, 15/2907.)

Shoqëria e Epokës së Lumturisë ka bërë përpjekje të shumta për të mësuar Kuranin dhe hadithet profetike. Le të japim një shembull konkret:

**Urve Bin Zubejr**  thoshte:


Një ditë tezja ime **Aishja** , më tha: - O djali i tim vëllai! **Abdullah bin Amr**  do të na bëjë një vizitë para se të niset në haxh. Takohu me të dhe pyete! Ai ka fituar shumë prej Pejgamberit .

U takova me të dhe pyeta shumë gjëra të transmetuara nga Profeti... (Muslim, Ilim, 14.)

Abdullah bin Amr  i shkruante hadithet edhe kur Pejgamberi  ishte gjallë dhe për rrjedhojë, pas një periudhe kohe, nxori në pah një vepër madhështore të haditheve.<sup>41</sup>

Duhet theksuar që, jo vetëm të rinjtë sahabë, por edhe më të moshuarit, bënë përpjekje të shumta për dije.<sup>42</sup>

### **Ata shëroheshin me begatitë e Kuranit**

Kurani ishte bërë një pjesë e pandarë për sahabët, aq shumë sa ata për çdo çështje bazoheshin në fjalën e Allahut . Kur kërkonin shërim për sëmundjet e tyre, këtë e bënin me Kuranin.

---

41. Buhari, Dije, 39.

42. Buhari, Dije, 15.

**Ebu Said** ﷺ tregon:

- Ishim në një garnizon ushtarak, të cilin e dërgoi Pejgamberi ﷺ. Gjatë udhëtimit qëndruam një natë diku. Aty erdhi një shërbyes, i cili na tha:

- Një gjarpër helmoi prijësin tonë. As ata që duhet të merren me këtë punë nuk i kemi këtu. A di ndonjëri prej jush të lexojë Kuran dhe të lutet që të shërohet i helmuari? Dikush nga mesi ynë, të cilin nuk e dinim që merrej me këtë punë, u ngrit dhe shkoi menjëherë me grupin në detyrë. Burri i sëmurë u bë më mirë. Mikut tonë i dhanë tridhjetë dele. Ai na gostiti me qumështin e tyre. E pyetëm:

- A dije të lexoje për të sëmurët?

Jo, tha, - unë e kreu këtë detyrë vetëm duke lexuar **suren Fatiha**.

- Mos vër dorë në këto dele pa pyetur të dërguarin e Allahut ﷻ, e këshilluam atë.

Me të mbërritur në Medinë ia shpjeguam situatën Profetit ﷺ, i cili na tha:

- *Kush të tha ty që mund të gjesh shërim me Fatihanë? Ndani mes njëri-tjetrit delet dhe më veçoni edhe mua një pjesë.* (Muslim, Selam, 66, 65; Bukhari, Fedailu'l Kuran, 9; Ixhare, 16; Tip, 33, 39.)

Shprehja e të Dërguarit “*Më jepni edhe mua një hise*”, është përdorur për të kënaqur sahabët





dhe për të dëshmuar qartë se malli i marrë është hallall, pra për të përforcuar veprimin e kryer. (Ajni, Umdetu'l Kari, XXI, 271-272.)

Në një tjetër hadith i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Sureja Fatiha është shërim për çdo sëmundje.*” (Darimi, Fedailu'l Kuran, 12.)

**Ilaka bin Sahar** ﷺ pati ardhur tek Profeti dhe u bë mysliman. Në kthim shkoi vizitë në një fis. Njëri prej tyre ishte sëmurë rëndë dhe e kishin lidhur pas hekurave. Familjarët e të sëmurit erdhën tek ky zotëri dhe e pyetën:

- Nga sa na është treguar, ky miku juaj ka sjellë disa mirësi nga Profeti ﷺ. A ka diçka për ta shëruar këtë të sëmurë?

Ilaka vijoi e tha:

- Unë i lexova atij **suren Fatiha**. Burri u përmirësua. Si shpërblim më dhanë njëqind dele. Erdha tek Profeti ﷺ dhe i tregova ndodhinë. (pyeta nëse i kam apo jo hallall këto dele).

Më pyeti nëse kisha lexuar diçka tjetër nga Kurani apo jo?

- Jo, - iu përgjigja.

- *Merri ato! Beto hem për jetën time se kush paguhet dhe ushqehet në shpërblim të leximit të diçkaje të rremë do ta vuajë dënimin. Ndërsa*



*ti po ushqehesh me pagën e marrë në shpërblim të një shërimit të drejtë!* (Ebu Davud, Tib, 19/3896; Buyu, 37/3420; Ahmet, V, 211.)

### **Ngriheshin në mesin e natës dhe pendoheshin**

**“Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).”** (Dharijat, 17-18.)

Shoqëria e Epokës së Lumturisë, në vend të qëndronte ngrohtë në shtrat, preferonte të ngrihej, të falte namaz, të adhuronte dhe të lexonte Kuran. Kjo kohë në atë shoqëri njihej si **“koha e pendimit dhe e lutjes”** dhe nisur nga kjo, ata e respektonin.<sup>43</sup> Madje, kush kalonte pranë shtëpive të tyre në errësirën e natës, dëgjonte lehtë leximin e Kuranit.

**Kadi Bejdavi** ﷺ tregon:


Pesë kohët e namazit për umetin janë bërë farz, ndërsa kur vjen puna për sunetin e namazit, të natës i Dërguari i Allahut ﷺ kalonte natën nëpër shtëpitë e sahabëve dhe dëgjonte si ata lexonin Kuranin. (Envarul Tenzil, IV, 111.)



I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

*- I njoh shumë mirë notat kuranore të Esha-*

43. Hejthemi, VII, 47; Mubarekfuri, Tuhfetu'l Ahfezi, II, 473-474; Ibn-I Haxher, Telhisu'l Habir, IV, 206.

*rijve zemërbutë kur hyj në shtëpitë e tyre. Edhe nëse nuk i shoh ku banojnë ditën (ndërkohë që udhëtoj), i dalloj menjëherë vendet e tyre nëpërmjet zërave të Kuranit që vijnë prej tyre...* (Buhari, Megazi, 38.)


Aishja  thotë:

Pejgamberi , ndërkohë që ishte në dhomën time, u ngrit për tehexhut. Dëgjoi zërin e **Abbad bin Abdullah** , i cili po falej në mesxhid.


- O Aishe, zëri i Abbadit është ky?, - më pyeti. Ndërsa unë ia ktheva:


- Po.

Më pas iu lut Zotit: - O Zoti im! Mëshiroje **Abbadin**. (Buhari, Shehadat, 11.)

I Dërguari për tetë apo nëntë netë radhazi e pati falur namazin e jacisë deri në një të tretën e natës. Nisur nga kjo, **Ebu Bekri**  e kishte këshilluar:

- O i Dërguari i Allahut! Sikur ta falnit pak më herët jacinë do të ishte më e lehtë për ne të ngrihshim natën.

Që këtej e tutje, Profeti , e fali jacinë më herët. (Ahmed, V, 47.)

Kur **Omeri**  ngrihej natën për namazin e tehexhudit, lutej në këtë mënyrë:



- O Zoti im! Ti e di vendin ku ndodhem dhe nevojat që kam! O Zoti im! Më bëj një rob të atillë, nevojat e të cilit të jenë të përmbushura prej Teje, i shpëtuar nga çdo lloj frike dhe rreziku, i bindur menjëherë ndaj urdhërave të Tua, lutja e të cilit është e pranuar, gabimet e të cilit i ke pranuar dhe të cilin e ke mëshiruar.

Në përfundim të namazit tha:

- O Zoti im! Nuk shoh diçka të përjetshme në këtë botë. Atje nuk ka diçka krejt të drejtë. Zoti im, më bëj një rob të atillë, që flet me dije dhe pushon me urtësi! O Zoti im! Mos më jep shumë nga kjo botë, që mos ta përkeqësoj, mos më lër në një moment të vështirë duke më pakësuar pasurinë në mënyrë që të mos ngelem prapa me adhurime. S'ka dyshim që pasuria e pakët ka më vlerë se e shumta që të largon nga adhurimet. (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VII, 82.)

Pyetën **Aishen** ﷺ:

- Kë do Profeti ﷺ më shumë nga njerëzit?

Ajo u tha për Fatmën ﷺ.


- Po nga burrat?


- Bashkëshortin e saj, - u tha dhe vijoi më tutje duke theksuar një çështje shumë të rëndësishme:

- Me sa di, ai është një person që agjëron shumë




dhe fal shumë namaze nate. (Tirmidhi, Menakis, 60/3874.)

**Amir bin Rabia**  gjatë gjithë jetës së tij i pati dhënë një rëndësi të posaçme tehexhudit dhe ndërroi jetë në momentin kur po ngrihej për namazin e natës. Duke qenë se njerëzit ishin bërë pre e një shpifjeje të pashërueshme, Amrit një herë në ëndërr iu tha:

- Ngrihu dhe kërko nga Allahu  të të mbrojë edhe ty prej shpifjes, sikurse mbrojti edhe robërit e devotshëm.

Ai u ngrit menjëherë dhe fali namaz. Pas faljes u sëmur dhe nga shtëpia doli xhenazja e tij. (Hejthemi, IX, 301; Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VI, 362/32044.)

**Amir bin Abdikajs**  prej Tabiinëve, kur iu afrua vdekja nisi të qante.

- Përse qan? - e pyetën.

- Nuk qaj as nga frika e vdekjes dhe as nga malli për këtë botë. Por qaj se nuk do mund të agjëroj më në ditët e nxehta dhe të ngrihem netëve në namazin e tehexhudit. (Zehebi, Sijer, IV, 19.)

Transmetohet se njerëzit shpirtërorë shpreheshin kështu, lidhur me kohët e namazeve të natës, ku adhurimet ishin shumë frytdhënëse lutjet dhe pendimet pranoheshin, gjynahet fshiheshin dhe trupi gjente qetësi:



Përjetimi i netëve është një pasuri e vërtetë ku Allahu ﷻ thotë në ajetin kuranor: **“O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash...”** (Al-i Imran, 26) (Hadimi, Mexhmaatu Resail, fq 194.)

### **Ata dridheshin kur kryenin adhurimet**

Shoqëria e Epokës së Lumturisë i kryente me një bindje të madhe adhurimet përkatëse, por asnjëherë nuk e shihte veten të mjaftueshme në këto adhurime. Ata jetonin përherë mes frikës dhe shpresës.

**Aishja** ﷺ thotë:

Kur u shpallën ajetet **“...dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre, ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët.”** (El-Mu'minun, 60-61), e pata pyetur Profetin:

- Mos vallë ata që përmenden në ajet janë ata që bëjnë zina, merren me hajdutëri, me alkool apo kumar?

- *Jo, o e bija e Besnikut!* - m'u përgjigj, - *ata që përmenden në ajet janë ata të cilët, edhe pse falin namaz, agjërojnë dhe japin zekatin frikësohen se mos vallë adhurimet e tyre nuk pranohen. Këta garojnë në punë të mira dhe ecin përpara.* (Tirmidhi, Tefsir, 23/3175; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 20.)



Për një mysliman, nuk ka rrugë tjetër vetëm kryerja e të gjitha adhurimeve me një përpikmëri të madhe dhe mbështetja në mëshirën e Allahut ﷻ, pasi ashtu si lutjet edhe veprat kanë nevojë të pranohen nga ana e Allahut ﷻ.

Nga sa transmetohet, **Aliu** ﷺ po dridhej një ditë kur po afrohej koha e faljes. Më pas e pyetën:

- Ç'të ka ngjarë o udhëheqësi i besimtarëve?

- Erdhi koha e amanetit që na ka lënë Allahu ﷻ, u përgjigj. Ky amanet iu dha tokës, qiejve dhe maleve, ndërsa ata u frikësuan dhe iu shmangën. Njeriu e mori përsipër këtë amanet.<sup>44</sup> Nuk e di nëse do ta kryej apo jo këtë amanet. (Serraxh, Luma, fq 139.)

### **Ata garonin në mirësi**

Shoqëria e Epokës së Lumturisë garonte në vepra të mira dhe devotshmëri. Abdurrahman bin Ebu Bekir ﷺ thotë:

**I Dërguari i Allahut** ﷺ me të falur namazin e sabahut, iu drejtua sahabëve dhe u tha:

- *A është ndonjë prej jush sot agjërueshëm?*

**Omeri** ﷺ iu përgjigj:

- O i Dërguari i Allahut! Mbrëmë nuk e kisha

44. Shihni: el-Ahzap, 72.



në mendje të agjëroja, prandaj sot nuk jam agjërueshëm.

- Mbrëmë mendova të agjëroj dhe sot jam agjërueshëm, - vijoi **Ebu Bekri** ﷺ.

I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

- *A ka në mesin tuaj, nga ata të cilët kanë vizituar sot një të sëmurë?*

Omeri ﷺ iu përgjigj:

O i Dërguari i Allahut! Sapo e falëm namazin e sabahut dhe nuk jemi larguar për asnjë çast, si mund të vizitonim të sëmurin?

Ndërsa Ebu Bekri ﷺ vijoi:

Dëgjova se vëllai ynë, Abdurrahman bin Avf ishte sëmurë. I shkova për vizitë, kur po vija këtu. I urova shërim të shpejtë dhe erdha.

I Dërguari tha:

- *Kush nga ju ka ushqyer një të varfër?*

Omeri ﷺ iu përgjigj:

- O i Dërguari i Allahut! Me të falur namazin e sabahut nuk jemi larguar që këtu.

Ebu Bekri ﷺ vijoi:

- Kur hyra në mesxhid, vura re një nevojtar. Biri im Abdurrahmani kishte në dorë një copë bukë. Ia





mora dhe ia dhashë të varfrit.

Pejgamberi ﷺ vijoi:

- *Ti e meriton xhenetin.*

Ndërsa Omeri ﷺ foli si nën zë:

- Ah xheneti!

I Dërguari i Allahut ﷺ i tha disa fjalë Omerit ﷺ që do e gëzonin dhe vijoi:

- *Allahu ﷻ e mëshiroftë Omerin ﷺ. Allahu ﷻ e mëshiroftë Omerin ﷺ. Sa herë kërkon të bëjë një të mirë, Ebu Bekri ﷺ ia kalon.* (Hejthemi, III, 163-164; Veçanërisht shihni Ebu Davud, Zekat, 36/1670; Hakim, I, 571/1501.)

Kjo ndodhi na shtyn të mendojmë se çdo çast duhet ta vlerësojmë për hir të Zotit dhe çdo gjë shfaqet në bazë të qëllimit që kemi.

Në Kuran thuhet:

**“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiku fort (në adhurim) dhe përkushtohu vetëm ndaj Zotit tënd!”** (El-Inshirah, 7, 8.)

**Ata e ndiqnin sunetin hap pas hapi**

Fudalj bin Ijad ﷺ thotë:

- Nëse një punë bëhet me urtësi, por jo në



përputhje me kushtet përkatëse dhe jo në mënyrë të drejtë, nuk pranohet. Nëse bëhet në mënyrë të drejtë, por jo me urtësi, as këtë herë s'pranohet. Ajo nuk pranohet deri sa të kryhet edhe me urtësi edhe në përputhje me kushtet. **Urtësia** apo **Devotshmëria** është kur një punë bëhet vetëm për hir të Allahut ﷻ, ndërsa **mënyra e drejtë** e një pune ka lidhje me bazat e sunetit.<sup>45</sup>

Bindja ndaj Pejgamberit ﷺ është bindje edhe ndaj Allahut ﷻ. Në ajet thuhet:

**“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut ﷻ...”** (En-Nisa, 80.)

Njeriu i Epokës së Lumturisë, i cili e ka kuptuar këtë të vërtetë, tregohet mjaft i kujdesshëm në kryerjen e veprave në përputhje me sunetin.

**Xhabiri** ﷺ u thotë të rinjve që kishin ardhur të merrnin ca informacione prej tij:

**- Ishte këtu i Dërguari i Allahut. I zbritet Kurani, kuptimin e të cilit e dinte shumë mirë. Siç vepronte ai me Kuranin, vepronim edhe ne në përputhje të plotë me të.** (Muslim, Haxh, 147.)



Umeje bin Abdullah i pati thënë **Abdullah bin Omerit** ﷺ:

45. Ibn-I Kajjim el-Xhevziye, A'lamu'l Muvakkîn, Bejrut, 1996, II, 159.




Ne mund ta gjejmë në Kuran se si mund të falet namazi në momente të vështira, por nuk po mundemi ta gjejmë si mund të falim namazin e udhëtarit.

**Abdullah bin Omer**  iu përgjigj:

Allahu  na dërgoi Pejgamberin, ndërkohë që nuk dinim asgjë. **Nëse kemi parë si ka vepruar Pejgamberi** , **edhe ne do veprojmë në të njëjtën mënyrë.** (Ibn-i Maxhe, Ikame, 73; Ahmet, II, 65, 94, IV, 78.)

Në ajetin kuranor thuhet:

**“O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshtëm.”** (El-Huxhurat, 1.)

**Said bin Musejjed** , një nga Tabinët e mëdhenj të kohës, pas namazit të iqindisë vuri re dikë që po falte dy reqate më shumë. (Nuk e pëlqeu veprimin e këtij burri, i cili po falte nafille në të ashtëquajturën vakti për të pirë. Burri që po falej nisi të mbrohej duke thënë:

- O Ebu Muhamed! A më dënon Zoti se po fal namaz?

Said bin Musejjed iu përgjigj:

- Jo! Zoti nuk të dënon se fal namaz, por se nuk je në përputhje me sunetin! (Darimi, Mukaddime, 39/442)



**Aliu** ﷺ ishte i lidhur shumë me sunetin e Profetit ﷺ. Një ditë u pyet:

- Një person a mund t'i hipë devesë të cilën e dërgon në haxh për kurban?

Ja si ishte përgjigja:

- Këtu s'ka ndonjë problem. I Dërguari i Allahut ﷺ i urdhëroi disa njerëz që po ecnin në rrugë me devetë e tyre, të hipnin në to. ***Ju s'mund të vlerësoni diçka më mirë dhe më saktë se Profeti dhe nuk mund t'i viheni punës më mirë se Ai.***

(Ahmet, I, 121.)

Janë shumë domethënëse edhe këto fjalë të tij:

***Pamë të ngrihej në këmbë i Dërguari i Allahut ﷺ edhe ne u ngritëm. Pamë të ulej edhe ne u ulëm.*** (Ahmed, I, 83.)

***Të gjitha rrugët janë të mbyllura për njerëzit, me përjashtim të atyre që shkojnë pas gjurmëve të Tij.*** (Bursevi, Ruhul Bejan, Nisa, 28.)

Aliu ﷺ një ditë pasi bëri mest'h mbi mest, pati thënë:

- Sikur mos ta shihja të Dërguarin e Allahut ﷺ të bënte kështu, do kisha menduar si më të drejtë mestin mbi mest. (Ahmet, I, 148, 95, 124)

**Abdullah bin Ebi Evfa** ﷺ, në xhenazen e së



bijës kishte marrë katër herë tekbir. Pas tekbirit të katërt kishte qëndruar aq sa kishte qëndruar edhe pas tekbirit të dytë, i kishte kërkuar falje së bijës dhe ish lutur.

Xhemati kishte pandehur se do merrte tekbirin e pestë. Më pas dha selam në të djathtë dhe në të majtë. Pas namazit e pyetën:

- Ç'ishte kjo që bëre?

- Nuk kam bërë asgjë më tepër nga ç'kam parë Profetin ﷺ të bëjë. Ai vepronte kështu. (Shihni Hakim, I, 360, Ibn-I Maxhe, Xhenaiz, 24)

Një herë **Ebu Musa el-Eshari** ؓ qe sëmurë dhe i kish rënë të fikët në prehërin e së shoqes. E shoqja ulëriti nga ajo që pa dhe nisi të qante. Ebu Musa s'ishte në gjendje ta qetësonte gruan dhe kur erdhi në vete e këshilloi:

- Atë që nuk e pëlqen i Dërguari i Allahut ﷺ nuk e pëlqej as unë. Pejgamberit ﷺ nuk i pëlqenin gratë e parregullta. (Buhari, Xhenaiz, 37, 38; Muslim, Iman, 167, Nesai, Xhenaiz, 17.)

Përpjekja për t'u qëndruar besnik urdhrave të Profetit ﷺ është një përpikmëri e madhe.

Pejgamberi ﷺ me t'u kthyer nga udhëtimi, fillimisht kalonte në mesxhid. Atje falte dy reqate dhe

më pas kthehej në shtëpi. Edhe **Ibn-i Omeri** ﷺ gjithë jetën kështu bëri.<sup>46</sup>

Ibn-i Omeri ﷺ në përfundim të haxhit ndaloi në Batha të Zulhulejfe që të pushonte deveja, pasi ashtu kishte vepruar edhe i Dërguari i Allahut ﷺ.<sup>47</sup>

Ibn-i Omer ﷺ falte drekën, iqindinë, akshamin dhe jacinë në Muhassab<sup>48</sup> dhe më pas pushonte pak duke pohuar se kështu vepronte edhe Profeti.<sup>49</sup>

I Dërguari e kishte marrë kafshën për kurban në Kubejd (një vend mes Mekës dhe Medinës) Edhe Ibn-i Omeri ﷺ kishte vepruar kështu.<sup>50</sup>

Sa herë që pyetej se përse vepronte kështu, përgjigja ishte e ngjashme:

**- E kam parë Profetin ﷺ tek vepronte në këtë mënyrë.**<sup>51</sup>

Ebu Rafi tregon:

Fala namazin e jaxisë me **Ebu Hurejren** ﷺ.

46. Ebu Davud, Xhihad, 166/2781, 2782.

47. Buhari, Haxh, 38, 29, 148, 149; Muslim, Haxh, 226; Muvatta, Haxh, 6.

48. Muhassab, Mes Minës dhe Mekës, është një vend më afër Minës.

49. Buhari, Haxh, 149; Muslim, Haxh, 337; Muvatta, Haxh, 207.

50. Tirmidhi, Haxh, 68/907.


51. Buhari, Vudu, 30; Haxh, 16, 38, 149; Muslim, Haxh, 25, 245, 521; Elfaz, 21; Tirmidhi, Haxh, 39/864; Ebu Davud, Hatem, 5/4227; 4228; Nesai, Haxh, 174, Ibn-I Maxhe, Haxh, 43; Muvatta, Haxh, 31.



Lexoi suren “idhes’semaun shek-kat” dhe bëri sexhden. E pyeta:

- O Ebu Hurejra, ç’sexhde është kjo?

- ***Kam bërë sexhde në këtë sure, kur jam falur pas Profetit ﷺ dhe do vijoj kështu deri në vdekje***, u përgjigj. (Muslim, Mesaxhid, 110; Ahmet, II, 229)

Ebu Harun el-Abdi  kishte thënë:

Ne shkonim tek **Ebu Said**  të mësonim diçka. Sapo na shihte thoshte:

- Mirë se erdhët, o njerëz që na jeni lënë amanet nga Profeti . I Dërguari i Allahut  ka thënë:

*Njerëzit do t’ju binden. Do t’ju vijnë njerëz nga katër anët e botës dhe do t’ju kërkojnë të mësojnë fenë. Kur t’ju vijnë, tregohuni të sjellshëm dhe jepuni atë çfarë kërkojnë.* (Tirmidhi, Ilim, 4/2650; Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 17, 22; Darimi, Mukaddime, 26; Hakim, 1/164/298)

**Një zonjë nga Gifari** e kishte pyetur Profetin  si mund të fshihej gjaku në rrobat e saj. Ja si qe përgjigjur:

- *Merr një enë me ujë, hidhi kripë, më pas lage një garzë dhe pastroje gjakun me të.*

Kjo zonjë më pas, gjatë gjithë jetës, e kishte



ndjekur porosinë e Profetit dhe sa herë që lante rrobat i hidhte ujit kripë. Kur vdiq, kishte lënë amanet që t'i hidhej kripë ujit me të cilin do të lahej. (Evu Davud, Teharet, 102/313)

Ja pra, ishte ky brez i Epokës së Lumturisë, të cilët çdo sjellje dhe veprim e bënin në përputhje me sunetin e Profetit ﷺ dhe e bënin këtë me kënaqësinë më të madhe.







*“Dhe Ti o i Dërguar, padyshim që je  
me një moral të lartë” (El-Kalem, 4)*

MATURIA  
ETIKE  
NË SHOQËRINË  
E EPOKËS SË LUMTURISË



## MATURIA ETIKE NË SHOQËRINË E EPOKËS SË LUMTURISË

Periudha më e veçantë në historinë e njerëzimit përsa i përket virtytit, drejtësisë, mirësjelljes dhe moralit të lartë, padyshim është ajo e Epokës së Lumturisë. Ajo kohë e bekuar ishte koha ku jetoi Profeti ynë, Muhamedi ﷺ si arsyeja e krjimit të gjithë botëve. Ishte një kohë që merrte formë me sjelljet, veprimet dhe anën e tij shpirtërore. Gjithashtu, ajo ishte koha e njohjes e Allahut ﷻ dhe e të Dërguarit nga afër me dashuri dhe një emocion në një atmosferë të thellë meditimi.

Le të mendojmë një mal të lartë... Kur shihet nga larg të shfaqet si një vijë e hollë. Por sa më shumë i afroresh aq më i qartë bëhet dhe po kaq të dukshme bëhen edhe pemët, frutat, zogjtë, ujërat e rrjedhshëm. Sa herë që njeriu i sheh nga afër këto bukuri të mrekullueshme, aq më shumë i shtohet etja për admirim.

Nisur nga kjo, për ta njohur Profetin në kuptimin e vërtetë të fjalës, nuk mjafton vetëm të lexojmë thëniet e Tij. Ai mund të kuptohet vetëm në sajë të



dashurisë që rrënjosim në zemër dhe në sajë të kësaj dashurie, krijojmë edhe afrimitetin e duhur. Ja pra, vetë sahabët që i qëndruan pranë me shumë dashuri, tregoheshin të gatshëm në plotësimin e kërkesave të Tij, sado të vogla qofshin ato, duke i thënë:

**- O i Dërguari i Allahut! Të qofshin falë nëna, babai, shpirti, pasuria dhe çdo gjë e imja.**

Treguesi më i qartë i dashurisë sonë ndaj Tij është dashuria ndaj Kuranit dhe Sunetit<sup>52</sup>, të cilat Pejgamberi ﷺ i ka shprehur në hadithin e tij “*Juve po ju lë dy amanete...*” Duhet të përpiqemi ta përhapim Kuranin dhe Sunetin në çdo aspekt të jetës dhe në këtë rrugë plot ndriçim të fitojmë pëlqimin e Allahut ﷻ dhe dashurinë e Profetit. Duhet të edukohemi me moralin më të mirë të Islamit, duke jetuar me dashurinë për Librin dhe Sunetin dhe ta transmetojmë sa më mirë këtë në shoqëri.

### **Ata ishin shumë modestë**

Sa herë që sahabët lartësoheshin me edukatën islame, bëheshin po aq modestë. Ngjarja e mëposhtme është shembulli tipik i kësaj:

**Selman el-Farisiut** ﷺ i kishte ardhur një mysafir nga Egjipti, anëtar i fisit Bijt e Tejmit, ndërkohë

që ishte vali në Medain. Kishte sjellë me vete edhe një thes me fiq. Mbi shpatulla mbante një rrobë dhe një shajak. Mysafiri nuk e njohte Selmanin. Me ta parë në atë gjendje, i tha:

- Eja, merre edhe këtë!

Selmani shkoi dhe mori ç'kishte për të marrë. Sa e panë njerëzit, e njohën dhe menjëherë i folën mysafirit:

- Ai zotëri që po mban mbi supe atë peshë është drejtues vendi. Mysafiri i kërkoi të falur dhe i tha:

- Ju kërktoj ndjesë, nuk ju njoha!

Selman-i Farisi iu përgjigj:

- S'ka gjë, nuk e heq këtë peshë deri sa ta çoj në shtëpi. (Ibn-i Sa'd, IV, 88)

Allahu i Lartmadhëruar i lartëson këta njerëz si Selmani në ajetin e mëposhtëm:

***“E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë...”*** (Furkan, 63)

### **Ata ishin si një det i gjerë mëshire**

Mëshira ishte një nga virtytet më të dukshme të njerëzve të Epokës së Lumturisë. Ndoshta e mëposhtme përbën një shembull mjaft të bukur që tregon sa bujarë dhe të mëshirshëm ishin:



**Hasani** ﷺ një ditë kish vajtur në Medinë. Atje vuri re një skllav zezak që mbante në dorë një copë bukë, një pjesë të së cilës po e hante, ndërsa pjesën tjetër, ia jepte një qeni që ishte aty pranë. Në këtë mënyrë ai e ndante bukën me qenin.

- Kush je ti?, - pyeti Hasani ﷺ.

- Jam shërbëtori i Eban bin Osmanit ﷺ, iu përgjigj.

- E kujt është kjo vreshtë?, - e pyeti.

- Është e Eban bin Osmanit ﷺ, - iu përgjigj.

Hasani ﷺ vijoi:

- Mos u largo që këtej, do kthehem sërish tek ti, dhe u largua për të shkuar tek i zoti i vreshtës. Ai bleu edhe vreshtën edhe skllavin. Më pas iu afrua skllavit dhe i tha:

- Djalosh! Unë të kam blerë.

Skllavi u ngrit menjëherë në këmbë dhe tha:


- Si të urdhëroni! Bindja është ndaj Allahut ﷻ, ndaj të Dërguarit dhe ndaj teje!

Këto fjalë e emocionuan akoma edhe më shumë Hasanin, i cili në vijim tha:

- Ti je i lirë për hir të Allahut ﷻ! Këtë vreshtë po ta dhuroj ty!



Skllavi iu përgjigj:

- Zotëri!, unë ia dhuroj këtë kopsht Allahut  për hir të të cilit më more. (Ibn-i Manzur, Muhtasaru Tarihi Dimeshk, VII, 25.)

Pra ky njeri, që për nga paraqitja ishte një skllav, por në të vërtetë ishte një sulltan i urtë, nëpërmjet sjelljes së tij bujare dhe të mëshirshme, u bë shembull i virtyeteve shumë të larta njerëzore.

**Abdullah bin Mubarek** (v. 181 h), një nga dijetarët më në zë të brezit të Tabiinëve, qe dijetari më i madh i hadithit. Qe nisur në haxh bashkë me miqtë e tij. Në rrugë e sipër vuri re dy vogëlushe të cilat jetonin në një kasolle. Ato vogëlushe të vetmuara ishin aq të uritura, sa donin të hanin mishin e një zogu të ngordhur aty pranë tyre. Si dëshmitar i një ndodhie të tillë, **Abdullah bin Mubarek** e ndërpreu udhëtimin e tij. Nga një mijë dinarë që kishte me vete, njëzet i ndau për t'u kthyer në Merve ndërsa pjesën tjetër ua dha fëmijëve.

- Përse veprime kështu?, - e pyetën miqtë e tij të ngushtë.

- Kjo që bëme tani ka më shumë sevape se haxhi i këtij viti.<sup>53</sup>

53. M. Sait Hatipogllu, "Mbi botëkuptimin e Sufive të parë për hadithin dhe sunetin" Islamijat, V 2, no 3, Korrik-Shtator 1999, fq 13.



Një ditë **Rejbi bin Hajthem** po falej dhe ndërkohë, para syve të tij iu vodh kali që kushtonte një mijë dirhemë. Në vend të ndiqte hajdutin, preferoi të vijonte namazin në qetësi të plotë. Miqtë e tij të ngushtë, me të marrë vesh lajmin, i erdhën menjëherë pranë për ta ngushëlluar.

- E pashë atë njeri tek po merrte kalin, - iu përgjigj, por në atë moment po merresha me një punë shumë më të rëndësishme, prandaj nuk arrita ta kapja grabitësin.

Miqtë e tij të ngushtë nisën ta mallkonin grabitësin, por ai ndërhyri:

- Qetësohuni, askush nuk ka ushtruar presion ndaj meje. Ai ka dhunuar nefsën e tij. Mos ta dhunojmë akoma më tepër, sikur të mos i mjaftonte ajo që ka bërë! (Shih Bebanzade Ahmet Naim, Bazat e Etikës Islame, fq. 85-86)

Poeti e shpreh mjaft bukur këtë situatë në vargjet e mëposhtme:


*Shko në ndihmë të besimtarëve me mëshirën tënde  
Por mëshiroji edhe më shumë të pafetë.*



Shoqëria e Epokës së Lumturisë ishte e mëshirshme edhe ndaj kafshëve dhe bimëve. I Dërguari i Allahut ﷺ pati takuar një person tek po milte delen e tij dhe i pati thënë:








- *O zotëri! Kur ta mjelësh, lër qumësht edhe për zogëzën e saj!* (Hejthemi, VIII, 196.)


Një prej sahabëve të njohur **Ebu Derda**  pati rastisur me njerëz që ngarkonin devetë e tyre shumë më tepër se ç'duhej. Devetë s'mund të ngriheshin nga pesha e rëndë. Ebu Derda, me të lehtësuar peshën e deveve, iu drejtua njerëzve me këto fjalë:

- Nëse Allahu  ua fal vuajtjet që u jepni kafshëve, ju në këtë rast mund të merrni një falje të madhe. Kam dëgjuar Profetin  tek thoshte:

- *Allahu  na urdhëron të sillemi mirë me këto kafshë të pagojë! Nëse kaloni nëpër një tokë pjellore, lërini kafshët të kullosin pakëz! Nëse kaloni nëpër një zonë të thatë, ikni menjëherë prej aty dhe mos i torturoni shumë!* (Ibn-i Haxher, el-Mutalibu'l Alije, II, 226/1978)

### **Kënaqeshin kur falnin për hir të Allahut**

Njeriu duhet t'i falë shumë të tjerët, që Allahu  ta falë atë. Të gjithë kemi shumë gabime të bëra, si ndaj Allahut  edhe ndaj robërve, gabime këto që presin falje.

**Ebu Bekri**  ndihmonte përherë një të varfër të quajtur Mistah. Kur pa se edhe ai ish përfshirë në mesin e atyre që hodhën shpifje në ndodhinë ndaj



vajzës Aishe ﷺ, të njohur si “ndodhia Ifk”, u betua se nuk do ta ndihmonte më. Pas kësaj, Allahu ﷻ zbriti ajetin e mëposhtëm:

**“Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të Allahut lanë vendlindjet e tyre, po le t’ua falin (gabimin) dhe mos t’ua pranojnë. A nuk dëshironi që Allahu t’ju falë? Allahu fal dhe mëshiron shumë”** (en-Nur, 22)

Me zbritjen e këtij ajeti, Ebu Bekri ﷺ tha:

- Natyrisht, dua që Allahu ﷻ të më falë. Pasi prishi betimin, rinisi ndihmesën. (Buhari, Megazi, 34; Muslim, Tevbe, 56; Taberi, Tefsir, II, 546)

**Aliu** ﷺ i kishte përgatitur një emërim Malik bin Harisit si vali në Egjipt, duke treguar mjaft qartë botëkuptimin e faljes së njeriut të Epokës së Lumturisë.

***Mos i shih njerëzit si një kafshë e egër që sheh gjahun e saj! Ushqeje zemrën tënde me dashuri, mëshirë dhe mirësi ndaj tyre! Pasi të gjithë njerëzit pa dallim ose janë vëllezërit e tu për nga feja ose bashkëkombësit që nga lindja. Njerëzit mund të gabojnë, mund t’u ndodhë ndonjë e papritur. Jepu një dorë atij që rrëzohet, Nëse do faljen prej Allahut ﷻ fali njerëzit dhe mos u vëre gabimet e tyre!***



***Mos ngre krye ndaj Allahut ﷻ! Mos u pendo për faljen tënde! As mos u gëzo për dënimin e dhënë!***<sup>54</sup>

Isam bin Mustalik ﷺ tregon shembullin e një faljeje dhe të një mëshire marramendëse:

Erdha në Medinë dhe pashë **Hasanin** ﷺ, të birin e Aliut ﷺ. Paraqitja e jashtme dhe prezenca e Hasanit ﷺ më la pa fjalë dhe kjo më pëlqeu shumë. Por kjo situatë më acaroi edhe më shumë kur mu kujtua ajo urrejtje që kishte fshehur i ati ndaj Aliut. Para se të më thoshte emrin e të atit, e pyeta:

- Mos vallë ti je nipi i të birit të Ebu Talibit ﷺ?

- Po!, - më tha.

- Dhe në atë moment nuk lashë gjë pa e sharë dhe ofenduar. Hasani më vështroi me shumë mëshirë, tha besmelenë dhe më pas lexoi ajetin e mëposhtëm:

**“Ti (Muhammed) bëhu falës, urdhëro për mirë dhe hiq prej të padijshmëve. E nëse të godet shejtani me ndonjë mendim të keq, menjëherë kërko strehim tek Allahu, sepse vërtet Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë. Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga**

54. Muhjidin Sejdi Çelebi, Bazat e drejtimit tek Buhariu, Haz, Doç. Dr. Mehmet Erdogan, Stamboll 2000, fq 47.



**djalli, përkujtojnë (Allahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën)."** (el-A'raf, 199-201)

Më pas Hasani ﷺ më tha:

- Përpiqu të jesh më i matur dhe më i kujdes-shëm! Kërko mbështetje dhe falje prej Allahut ﷻ si për vete edhe për mua! Nëse ti do kërkosh ndihmë prej nesh, ne ta ofrojmë, nëse kërkon të jesh mysafiri ynë, me shumë kënaqësi e pranojmë, nëse kërkon të të udhëzojmë në rrugë të drejtë, të udhëzojmë, do të përpiqemi të të tregojmë rrugën e drejtë!

Hasani ﷺ me të kuptuar se isha penduar për atë që kisha bërë, lexoi ajetin e mëposhtëm:

**“Ai tha: ‘Sot nuk ka qortim kundër jush, Allahu ﷻ ju faltë, Ai është më mëshirues i mëshiruesve!’** (Jusuf, 92.) (E kuptoi se isha nga anët e Muavijes si i deleguar i Aliut.)

- Mos vallë je nga ata të Shamit?, - pyeti.

- Po!, - i thashë.

Më lexoi një poezi shumë domethënëse me të cilën tregoj se kishte pasur edhe më parë të tilla ndodhi.

Hasani ﷺ më tregoi lidhjen farefisnore, duke më thënë:

- Mirë se erdhe! Paqja e Zotit qoftë mbi ty!



Allahu ﷻ të faltë dhe të ndihmoftë. Mos nguro, për çdo gjë që të kesh na njofto. Thuaje atë që ke përbrenda. Le të shpresojmë të jemi më mirë se ato që ke menduar për ne.

Ky i huaj, i ardhur nga Shami, nisi të shprehte ndjenjat e tij:

E ndjeva veten mjaft ngushtë përpara një sjelljeje të tillë. Shpresova me vete: “Ah sikur të hapej toka dhe të futesha në të! Më pas u largova. Tashmë për mua s’kish njerëz më të dashur se Aliu dhe Hasani. (Kurtubi, Tefsir, El-A’raf, 211.)

Njeriu përherë mbetet i mundur ndaj mirësive. Në ajetin e mëposhtëm thuhet:

**“E mira dhe e keqja nuk bëhen një. Ti mbroje sa më mirë (të keqen)! Atëherë vë re se armiku yt të është bërë miku më i mirë.”** (Fussilet, 44.)

Kjo ngjarje domethënëse e shpreh mjaft bukur fundin e begatë të moralit të bukur. Kjo do të thotë që të falësh, t’i fitosh zemrën dikujt dhe të sillesh me etikën islame, lë një influencë mjaft pozitive tek njerëzit.

**Mejmun bin Mihran** ﷺ iahte një dijetar i njohur i brezit të Tabiinëve, i dhënë shumë pas adhurimit. Një ditë Mejmuni kishte mysafirë. Ndërkohë që po përgatitej tryeza, njërit prej shërbyesve i ngec këmba në një qoshe, rrëzohet dhe për rrjedhojë supa



iu derdh në prehrin e Mejmunit, i cili u nervozua shumë për një çast. I frikësuar nga një situatë e tillë, shërbyesi tha:

- Zotëri, ço në vend fjalën e Allahut ﷻ të lartë kur thotë: **“Ata e frenojnë veten!”**<sup>55</sup>

- Në rregull!, - tha Mejmuni dhe u qetësua. Pasi lexoi vazhdimin e ajetit

**“I falin njerëzit!”**

Shërbyesi tha:

- Çoje në vend edhe këtë urdhër!

- Të kam falur! - tha. Këtë herë shërbyesi lexoi pjesën tjetër të ajetit:

**“Allahu i do të mirët!”**

- Edhe unë po të bëj një mirësi!, - vijoi Mejmuni. Për hir të Allahut ﷻ je i lirë! Kështu e la të lirë. (Kurtubi, IV, 207; Al-i Imran, 134.)<sup>56</sup>

### **Ata ishin pjesë e cilësive të Pejgamberit el-Emin (i sigurtë) dhe es-Sadik (Besnik)**

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ çliroi Mekën, të gjithë atyre që kishin hyrë në Islam u dha nga pasuria e

55. Al-I Imran, 134.

56. Në një tjetër transmetim thuhet se ky individ që mposhti mllefin e tij ishte Xhaferi Sadik.



fituar në Hunejn. Të shqetësuar nga kjo që ndodhi, të rinjtë **ensarë** reagueshan duke thënë:

- Me të vërtetë është diçka shumë e çuditshme! Akoma nga shpatat tona pikon gjaku (i Kurejshitëve) e megjithatë pasuritë u jepën sërisht atyre! Pejgamberi ﷺ me të dëgjuar këto fjalë, mbledhi ensarët dhe u tha:

- Ç'janë ato fjalë që thuhën për ju?


Ensarët e ndjenë veten mjaft të turpëruar dhe ashtu kokëulur thanë:

- Po, ka ndodhur ashtu siç e keni dëgjuar. **Ata nuk gënjenin.** (Muslim, Zekat, 134.)

Enesi  tha:

- Betohe mi për Allah se, të gjitha ato që treguam nuk i kemi dëgjuar direkt nga i Dërguari. (Hadithet e Profetit i mësonim edhe nga njëri-tjetri) **Asnjëherë nuk gënjenim njëri-tjetrin.** (Hejthemi, I, 153.)

Edhe armiqtë e myslimanëve ndikoheshin nga ky moral i lartë duke e parë atë me shumë zili. Me mbarimin e Luftës së Uhudit, Ebu Sufjani, lideri i armiqve, pyeti nga larg:

- O Omer! Betohe mi në emër të Allahut , a e vramë ne Muhamedin?

Omeri  u përgjigj:



- Betohem për atë Allah që jo! Nuk e vratë!  
Tani ai i dëgjon këto që po thua!

Ebu Sufjani ﷺ tha:

**- Ti je më i mirë dhe më fjalëdrejtë se Ibn-i Kamia, i cili tha se kanë vrarë Muhamedin!**

(Ibn-i Hisham, III, 45; Vakidi, I, 296-297; Ahmed, I, 288; Hejthemi, VI, 111.)

Këtu na shfaqet një skenë mjaft e mahnitshme, besimi ndaj individualitetit të një myslimani të rënë në pritë dhe, jo i një mushriku që lufton me një mushrik tjetër të të njëjtit grupim. Njeriu admiron të ketë personalitet dhe karakter dhe respekton njerëzit me individualitet dhe karakter.

Populli i Jemenit pati ardhur tek Profeti ﷺ duke iu lutur:

- Dërgoje njërin që na mësojë Sunetin dhe Islamin! I Dërguari i Allahut ﷺ e zuri për dore **Ebu Ubejde bin Xherrah** ﷺ:

- Ky është një person i besueshëm i ymetit, të cilin e dërgoi së bashku me jemenasit. (Muslim, Fedailu'l Sahabe, 54; Ahmed, III, 146.)

Kjo ngjarje shpreh qartë se zotërimi i një individualiteti të sigurtë është një cilësi mjaft e madhe që njeriu të fitojë kënaqësinë edhe të Profetit ﷺ.



## Ata ishin sikurse erërat mëshiruese të begatshme në bujari dhe altruizëm

Sahabët e edukuar me edukatën e Pejgamberit ﷺ kishin përfituar shumë nga bujaria e tij.

**Xhabiri** ﷺ ka thënë:

Nuk di të ketë një person të vetëm nga Muhahirët dhe Ensarët që të ketë mundësi dhe të mos ketë pasuri. (Ibn'u Kudame, el-Mugbi, V, 598.)

**Ibn-i Hazm** ﷺ thotë:

Abdullah bin Omeri ﷺ, Fatma ﷺ dhe shumë sahabë të tjerë kanë lënë shumë pasuri në Medinë. Kjo çështje është e dukshme si rrezet e diellit dhe s'ka njeri të mos e dijë. (M. Abduh Jemani, Fatimatu Zehra, Bejrut, 1996, fq 330.)

Një nga komandantët e mëdhenj të Islamit, **Halid bin Velid** ﷺ dhuroi në rrugë të Allahut ﷻ të gjithë pasurinë e luftës që kishte. (Buhari, Zekat, 49, 33; Xhihad, 89; Muslim, Zekat, 11.)

**Ubejdullah bin Abbas** ﷺ ishte nisur në një udhëtim. Pranë kishte edhe shërbyesin. Në rrugë e sipër vunë re shtëpinë e një bedeviu. Ubejdullahu ﷺ i foli shërbyesit:

- Si thua, të shkojmë në atë shtëpi? Bëhemi mysafirë të tyre dhe kështu kalojmë edhe natën aty.

U nisën. Ubejdullah ishte një njeri me një karak-



ter shumë të fortë. Bedeviu u gëzua shumë për atë që pa e që dëgjoji dhe ia tha me plot zell të shoqes:

- Sot na erdhi mysafir një person shumë i nderuar.

Bedeviu i priti mjaft mirë dhe shkoi tek e shoqja. Mes tyre vijoi një bisedë e tillë:

- A kemi diçka për darkë për mysafirët?

- Jo, vetëm këtë dele si burim jete të vajzës sonë të vogël, pasi prej saj marrim qumështin.

- Duhet ta presim atë dele.

- Do e vrasësh vajzën?

- Duhet ta presim delen, edhe sikur të na vdesë vajza.

Bedeviu mori thikën dhe delen dhe nisi të lutej:

*- O komshijtë e mi, mos e zgjoni vajzën time!  
Nëse e zgjoni ajo nis të qajë me të madhe dhe do  
ma marrë thikën prej dore.*

Më pas e preu delen. Përgatiti darkën dhe ua serviri miqve. Ubejdullahu kishte dëgjuar bisedën e bedeviuut me të shoqen. Me të gdhirë mëngjesi, i foli sërish shërbyesit:

- A ke para me vete?

- Po, kemi pesëqind dinarë të mbetur nga shpenzimet e rugës.



- Jepja bedeviut.

- Subhanallah! Pesëqind dinarë po i jepni atij?  
Ai preu një dele për pesë dinar.

- Turp të kesh! Beto hem për Allah se ai është shumë më bujar nga ne. Ne i dhamë atij një pjesë nga pasuria jonë. Kurse ai na e dha me plot bujari gjithë pasurinë ç'kishte. Në vend të jetës dhe fëmijës së vet na zgjodhi ne.

Kjo ngjarje mbërriti deri tek Muavija, i cili tha:

- Hallall të qoftë Ubejdullah! Ai e ka treguar veten se i biri i kujt është dhe se ku është edukuar. (Ibnu'l Esir, Uslu'l Gabe, Bejrut, 1417; III, 543; Ibn-i Asakir, Tarihu'l Dimeshk, XXXVII; 483-484.)

Ubejdullah ﷺ është i biri i Abbasit ﷺ, xhaxhait të Pejgamberit ﷺ.

Le t'i kushtojmë vëmendje edhe ngjarjes së mëposhtme:

Një ditë, kur **Aishja** ﷺ, bashkëshortja e Pejgamberit ﷺ, ishte agjërueshëm, i vjen pranë një i varfër, i cili i kërkon diçka për të ngrënë. Në shtëpi s'kishte gjë tjetër veçse një bukë.

- Jepja bukën atij, - i tha shërbyesit.

- Nuk keni diçka tjetër me se të bëni iftar në darkë, i tha.

- Jepja bukën atij, përsëriti sërish.



Shërbyesi vijon dhe tregon ndodhinë:

Ia dhashë bukën me urdhër të Aishes. Dikush na dërgoi një dele të pjekur. Aishja më thirri dhe më tha:

- Urdhëro e haje, kjo është më e shijshme se buka që kishe. (Muvatta, Sadaka, 5.)

Transmetohet se **Ibn-i Omeri** ﷺ nuk ulej asnjëherë në sofër për të ngrënë pa pasur edhe një jetim, (Buhari, el-Edebu'l Mufred, no 136; Ebu Nuajm, Hilje, 1, 299.)

**Hasan el Basriu** ﷺ, i cili ka jetuar në kohën e sahabëve dhe Tabiinëve, thotë:

Kam jetuar në një periudhë për myslimanët, kur dikush në mëngjes thoshte:

**- O banorë të këtij vendi, kini kujdes jetimët, të varfërit dhe komshijtë tuaj, kujdesuni për ta!** Sot njerëzit më të dobishëm u ndanë shumë shpejt nga mesi juaj dhe ju çdo ditë e më shumë dobësoheni... (Buhari, el-Edebu'l Mufred, 139)

## I shmangeshin shpërdorimit

**Akil bin Ebi Talip** ﷺ transmeton se e ka dëgjuar Pejgamberin ﷺ të thotë:

- *Për të marrë abdest mjaftojnë dy grushta ujë ndërsa për gusël një litër.*<sup>57</sup>



Dikush i pranishëm aty e pyeti:

- Nuk na mjafton kaq ujë?

- Kjo sasi uji i mjaftonte atij që ishte më i dobishëm se ti dhe që kishte më shumë flokë, - u përgjigj Akili duke nënkuptuar Pejgamberin ﷺ (Ibn-i Maxhe, Taharet, 1.)

Tregon Kesir bin Ubejd, robi i Ebu Bekrit dhe njëkohësisht vëllai i qumështit i Aishes ﷺ:

Shkova tek Aishja ﷺ, por ajo më tha të prisja jashtë sa të qepja rrobën.

- O nëna e besimtarëve! Nëse dal dhe u them të tjerëve për këtë, ty të quajnë dorështrenguar, - tha.

- Ti shiko punën tënde! Kush nuk përdor rrobën e vjetër, nuk e gjen të renë! - iu përgjigj ajo. (Buhari, el-Edebu'l Mufred, no 471; Ibn-i Sa'd, VIII, 50.)







*"Në të Dërguarin e Allahut  
është usve-i hasene  
(Shembulli më i mrekullueshëm)..."*  
(El-Ahzab, 21)

## JETA SOCIALE

NË SHOQËRINË  
E EPOKËS SË LUMTURISË





# JETA SOCIALE

## NË SHOQËRINË E EPOKËS SË LUMTURISË

### I dhanë rëndësi Arsimit Islam

I Dërguari i Allahut ﷺ përpiquej të përhapte shkrim - këndimin dhe në çdo rast e vlerësonte këtë mundësi. Një shembull i tillë është edhe kushti që u kish vënë Pejgamberi ﷺ robërve të marrë në luftën e Bedrit, ku si fidje (para që jepet për lirimin e robërve) për t'i lënë të lirë, ata që dinin shkrim - këndim do ua mësonin atë dhjetë fëmijëve myslimanë. Këto shkolla, ku mësohej shkrim - leximi, si nga ana e këtyre robërve ashtu edhe nga ana e dijetarëve të njohur të kohës, u quajtën “**Kuttab**”.<sup>58</sup>

Në atë kohë u hapën shumë shkolla të tilla, ku mësohej shkrim - leximi dhe dijet fetare.<sup>59</sup>

Sahabët i kishin kthyer edhe shtëpitë e tyre në shkolla. Nisur nga fakti që Suffe në Mesxhid-i Nebevi ishte e pamjaftueshme për aktivitetet arsimore dhe edukative në Medinë, në disa shtëpi ishin hapur

58. Muhamed Hamidullah Pejgamberi I Islamit 1, 141.

59. A. Shelebi, Tarihu'l Terbijeti'l Islamiye Kahire, 1960, fq 38-39.



disa shkolla të quajtura “**Daru’l Kurra**” Sipas një transmetimi, një pjesë e shtëpisë apo e gjithë shtëpia e **Mahreme bin Nevfel** ishte rezervuar për mësimdhënien e Kuranit. Abdullah bin Umme Mektum kishte qenë një herë mysafir në Daru’l Kurra dhe atje kishte dhënë mësim.<sup>60</sup>

I Dërguari i Allahut ﷺ ia pati dhënë Aliut ﷺ njërin nga robërit, Hevazin dhe i tha:

- Mësoi diçka nga Kurani! (Ibnu’l Esir, Usdu’l Gabe, VII, 105; Ibn-i Haxher, el-Isabe, IV, 292.)

### **Ata shfaqën një drejtësi të paparë në marrëdhëniet tregtare**

Një nga sahabët e njohur, **Xherir bin Abdullah** ﷺ donte të blinte një kalë në treg. Me të pëlqyer njërin prej kuajve shitësi i ofroi një çmim prej pesëqind dirhemësh. Xherir reagoi duke thënë se mund të jepte gjashtëqind dirhemë edhe shtatëqind dirhemë për këtë kalë. Kjo, pasi vlera e kalit ishte e lartë dhe shitësi nuk ishte në dijeni për këtë.

- Pse do ta ngresh çmimin deri në tetëqind dirhem, kur ke mundësi ta marrësh me pesëqind? - e pyetën. Ja ç’përgjigje të mahnitshme dha:

60. Kettani, Teratip, 1, 56; Ibn-I Abdilberr, el-Istiab, 1, 247; Makrizi, el-Mevaiz, ve’l Itibar, bi Zikri Hilati, ve’l A’sar, II, 362, Egjipt, 1270h.

**- Ne i kemi dhënë fjalën të Dërguarit të Allahut ﷺ, se nuk do bëjmë hile në tregti.**<sup>61</sup>

Në Epokën e Lumturisë, i Dërguari i Allahut ﷺ dhe halifet, e kanë mbajtur tregun nën kontroll duke mbyllur të gjitha rrugët e përfitimeve të padrejta. Profeti ua kishte ndaluar tregtarëve zotërimin e vendeve të rëndësishme, duke u rezervuar atyre një vend të caktuar, në mënyrë që të ndalonte formimin e një klase të privilegjuar dhe me përparësi dhe nisur nga kjo, ia kishte shembur edhe çadrën një tregtari, i cili e kishte kundërshtuar këtë vendim.<sup>62</sup>

### **Ata u bënë të njohur edhe për vëllazëri**

I Dërguari i Allahut ﷺ nëse për tre ditë radhazi nuk e shihte vëllain e tij besimtar, pyeste për të. Nëse ndodhej larg lutej për të, nëse ishte në shtëpi i bënte vizitë e nëse ishte sëmure shkonte për t'i uruar shërim të shpejtë.<sup>63</sup>

Profeti më pas krijoi të ashtëquajturën “**Aktin e Vëllazërisë**” mes muhaxhirëve që bënë hixhret nga Meka dhe ensarëve Medinas. Muhaxhirët, për hir të fesë kishin emigruar në Medinë duke u lënë armiqve çdo gjë që kishin (punët, shtëpitë dhe pasuritë). Kjo sakrificë e madhe u shpërblye me bujarinë e madhe

61. Ibn-I Hazm, el-Muhalla, Egjipt, 1389, IX, fq 454 vd.

62. Semhudi, Vefa, Egjipt, 1327, 1, 540.

63. Hejthemi, II, 295.



të ensarëve. Familjet e muhaxhirëve morën secila nga një familje medinase. Në këtë mënyrë, sahabët nëpërmjet këtij akti vëllazërimi do të jetonin së bashku dhe fitimin do ta ndanin me njëri-tjetrin.

Madje ensarët ia dhanë Profetit ﷺ tokat e tepërta duke kërkuar t'i ndanin ato mes tyre. Ensarët nuk u mjaftuan me kaq, por bënë edhe një propozim tjetër:

- O i Dërguar! Na e ndaj mes nesh edhe kopshin e hurmave. Pejgamberi ﷺ nuk e pranoi një gjë të tillë, e megjithatë ensarët iu drejtuan muhaxhirëve duke u thënë:

- Atëherë merrni përsipër përkujdesjen ndaj pemëve dhe të bëhemi ortakë edhe në marrjen e fryteve. Pejgamberi ﷺ e pranoi këtë reagim dhe të dy palët njëherazi u shprehën:

- E dëgjuam dhe u bindëm! duke pranuar kështu propozimin e bërë. (Buhari, Hars, 5.)

Ensarët i grumbullonin hurmat dhe i ndanin në dy pjesë, në njërën anë vendosnin shumë, ndërsa në tjetrën më pak. Në anën ku kishte më pak hurma, vendosnin degë hurmash poshtë tyre që të dukeshin më shumë dhe më pas u thonin Muhaxhirëve?

- Merrni cilën të dëshironi? Ata zgjidhnin për ensarët pjesën që dukej më shumë, ndërsa pjesën që dukej më pak e mbanin për vete dhe kështu pjesa



më e madhe i shkante muhaxhirëve, ndërsa ensarët merrnin pjesën më të vogël. (Hejthemi, X, 40.)

Një ditë Profeti ﷺ i ftoi ensarët të ndanin së bashku tokën Bahrejnit. Ensarët u treguan shumë të mirësjellshëm duke thënë:

- O i Dërguari i Allahut! Nëse nuk u jepni shumë më tepër se ç' duhet vëllezërve tanë muhaxhirë, neve mos na jepni aspak.

Profeti ﷺ vijoi:

*O Ensarë! Meqë nuk dëshironi t'i merrni (duke preferuar vëllezërit tuaj), atëherë bëni durim deri në ditën kur do takoheni me mua në Keuther. Pasi pas meje do vijë një kohë e tillë qo do zgjidhen të tjerët në vendin tuaj.* (Buhari, Menakibu'l Ensar, 8.)

Në fakt, kjo etikë që shfaqën ensarët ishte një shkallë më lart e bujarisë, pra ishte një virtyt i Isarit. Ata preferonin vëllezërit para tyre, megjithëse ishin nevojtarë për vete, fillimisht mendonin për të tjerët. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë:

**“Edhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërngulëshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre**



**para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, është i shpëtuar.**

**Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: “Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues!”** (el-Hashr, 9-10)

- Jo vetëm ensarët, por të gjithë besimtarët kishin të njëjtën etikë në Epokën e Lumturisë. Allahu i Lartmadhëruar i ka përgëzuar edhe ata.<sup>64</sup>

Kjo drejtësi e vëllazërisë që solli Pejgamberi ﷺ kishte një rëndësi të madhe edhe në udhëtime, siç ndodhte edhe në paqe. Kur i Dërguari i Allahut ﷺ nisej në ndonjë udhëtim, merrte me vete njërin prej vëllazërve, ndërsa dy të tjerët i linte në Medinë që t'u plotësonte nevojat familjarëve.<sup>65</sup>

Shumë domethënëse është edhe kjo fjalë e **Aliut** ﷺ që pasqyron mjaft qartë botëkuptimin dhe vizionin e vëllazërisë së asaj kohe.

- Ka dy mirësi që nuk e di as vetë se cila më gëzon më shumë. E **para**, kur dikush vjen tek unë me shpresën se do e ndihmoj dhe me gjithë sinqeritet kërkon ndihmë prej meje dhe e **dyta**, kur

64. Shihni: el-Insan, 8-11.

65. M. Ali Kapar, Marrëdhënia e Muhamedit ﷺ me mushrikët. Stamboll 1987, fq 145.



Allahu ﷻ ose ia plotëson kërkesën këtij nevojtari nëpërmjet meje ose ia lehtëson. ***Preferoj më tepër t'ia lehtësoj dhimbjen një myslimani, sesa të kem një grusht me florinj apo argjend.*** (Al-i el Muttaki, VI, 598/17049.)

**Enes bin Malik** ﷺ u jep këtë këshillë bijve të tij, që të forcojnë më shumë shpirtin vëllazëror:

*“Bijtë e mi, gostitni njëri-tjetrin dhe ndani mes vete dhurata, pasi kjo është një nga gjërat më të fuqishme që u rrit dashurinë mes vete.”*  
(Buhari, el-Edebu'l Mufred, nr. 595)

**Abdullah bin Abbas** ﷺ një ditë ishte në itikaf në xhaminë e Profetit ﷺ dhe ndërkaq, dikush i erdhi pranë, i dha selam dhe u ul. Ibn-i Abbasi i tha:

- Vëllai im, të shoh të mërzitur.

- Po, o djali i xhaxhait i të Dërguarit të Allahut ﷺ! - vijoi ai, jam i mërzitur: I kam hyrë në hak dikujt, por pasha të zotin e këtij varri (të Dërguarin e Allahut ﷺ), nuk kam mundësi t'ia shlyej tani.

- A të flas unë me të, në vendin tënd?

- Fol nëse dëshiron.

Ibn-i Abbasi ﷺ mbathi këpucët dhe doli nga mesxhidi. Ndërkaq burri pyeti i habitur:

- Harrove që je në itikaf, pse dole nga mesxhidi?



Ibn-i Abbasi ﷺ vijoi:

- Unë e kam dëgjuar këtë zotëri të nderuar që ndodhet në këtë varr (në këtë kohë sytë i mbushen me lot), i cili ka thënë:

*- Kush mundohet ta ndihmojë vëllanë e tij besimtar dhe ia plotëson kërkesat që ka, kjo vlen më shumë se qëndrimi për dhjetë vjet i tij në itikaf. Kurse kush hyn në itikaf, qoftë edhe për një ditë për hir të Allahut ﷻ, Krijuesi i gjithësisë krijon tre hendekë mes tij dhe xhehenemit ku distanca e secilit prej tyre është sa largësia mes lindjes dhe perëndimit. (Bejhaki, Shuajb, III, 424-425; Veçanërisht shihni Hejthemi, VIII, 192.)*

Ja se ç'thotë **Ibn-i Omeri** ﷺ lidhur me vëllazërinë e asaj periudhe:

Ne kemi parë kohë të atilla, në të cilat askush nga mesi ynë nuk mendonte të ishte floriri dhe argjendi më me vlerë se vëllai i vet mysliman. Tani jetojmë në një kohë të atillë ku floriri dhe argjendi janë bërë më të vlefshëm se vëllai ynë mysliman. Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ tek thoshte:

*- Në ditën e gjykimit do ketë sa e sa komshinj që do të qëndrojnë shumë pranë komshijve të tyre.*

*- O Zoti im! Ky komshiu im më përplasi de-*





*rën në fytyrë dhe nuk më ndihmoi.* (Buhari, el-Edebu'l Mufred, nr. 111; Hejthemi, X, 285)

## **Në shoqëri mbizotëronte finesa, mirësjellja dhe eleganca**

Shoqëria e Epokës së Lumturisë ishte shoqëri e finesës, mirësjelljes dhe elegancës. Ata silleshin me finesë, si ndaj njerëzve ashtu edhe ndaj kafshëve dhe bimëve dhe nuk i lëndonin.

Këtë e shohim më qartë gjatë kohës së haxhit. Të veshur me ihrame të bardha, ata bëheshin pjesë e dhuntive engjëjllore. Besimtarët burra dhe gra, gjatë kohës që bënin tavaf, vakfe dhe sa'j, e ruanin veten nga sjelljet e pahijshme, nisur edhe nga bindja ndaj urdhëresave hyjnore, ecnin përherë kokëulur me shikim tek majat e gishtërinjve, duke iu shmangur ngatërresave.

Kur ishin me ihram, nuk merreshin me gjueti, madje nuk këpusnin qoftë edhe një fije bari për gjuetinë. Kështu vinte një kohë, kur ata e ndienin thellë në shpirtrat e tyre se duhet t'u qëndronin larg gjërave të dyshimta dhe haramëve, si gjëra të ndaluara. Ata ishin të vetëdijshëm se përveç Krijuesit, duhet të tregoheshin sa më të mirësjellshëm, të njerëzishëm dhe të mëshirshëm edhe ndaj krijësive. Në këtë mënyrë zemrat e tyre zbuteshin dhe ngriheshin në shkallat e një modestie dhe një finese



të madhe, duke përfaqësuar kështu fytyrën e buzëqeshur të Islamit.

Vetë i Dërguari i Allahut ﷺ këshillonte për një vëmendje dhe përkujdesje ndaj kafshëve dhe në mënyrë të veçantë kërkonte pastrimin e deleve dhe të dashit.<sup>66</sup>

**Sevade bin Rebi** ﷺ tregon një shembull të mrekullueshëm të finesës dhe mëshirës:

- Shkova tek Profeti ﷺ dhe i kërkova diçka. U tha të tjerëve të më jepnin disa deve (3-10 krerë). Më pas më këshilloi:

*- Kur të kthehesh në shtëpi, thuaju familjarëve të sillen mirë me kafshët dhe t'i ushqejnë sa më mirë! Urdhëroi ata që t'i presin thonjtë, në mënyrë që kur t'i mjelin, të mos i lëndojnë!* (Ahmet, III, 484; Hejthemi, V, 168, 259, VIII, 196.)

I Dërguari i Allahut ﷺ e pati shpallur **Medinej-i Munevvere (Medineja e shndritshme)** si zonë harem, duke thënë:

*- Pemët e pyllit të të Dërguarit të Allahut ﷺ nuk mund të goditen e as të priten. Por në rast nevoje për ushqim kafshësh, lehtazi dhe në mënyrë mjaft delikate mund të shkunden gjethet e tyre.* (Ebu Davud, Haxh, 95-96/2039.)



**Ebu Du'shum el-Xhiheni** ﷺ transmeton se ka dëgjuar nga i ati dhe ky i fundit nga gjyshi i tij, të ketë thënë:

- I Dërguari i Allahut ﷺ kishte parë njëherë një bedevi teksa po godiste me sopatë degët e pemës për të ushqyer kafshët. U thotë atyre që kishte pranë:

*- Ma sillni atë bedevi, por silluni mirë dhe mos e frikësoni!*

Kur i erdhi pranë, Profeti ﷺ vijoi:

*- O bedevi! Shkundi gjethet me lehtësi dhe kujdes dhe jo duke i thyer!*

Më duket sikur akoma i shoh gjethet e pemës tek bien mbi bedeviun. (Ibnu'l Esir, Usdu'l Gabe, Bejrut, 1417, VI, 378.)

I Dërguari i Allahut ﷺ në çdo rast e ka ftuar umetin e tij të tregohet i sjellshëm, me finesë dhe i mëshirshëm ndaj çdo gjëje. Ja se ç'ka thënë edhe për bimët:

*- Nuk ka asnjë bimë të pajetë në tokë, të cilën të mos ta ketë marrë meleku dhe mbrojtur në krahët e veta. Kjo vijon deri në të korrura. Kush i shtyp me këmbë këto bimë, meleku e mallkon atë.* (Ali el-Muttaki, Kenz, III, 905/9122.)



## Ata ishin të edukuar dhe të ndershëm

Në Epokën e Lumturisë mbizotëronte edukata, nderi, mirësjellja dhe morali mes burrave dhe grave. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“(Profeti im) **Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, se kjo është më e pastër për ta. Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.**

**Thuaju edhe besimtarëve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt, përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre ose shërbëtorëve nga meshkuj, të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”**

(en-Nur, 30-31.)



Sipas njoftimit të **Aishes** ﷺ kur u shpall ky ajet, gratë sahabe nuk pritën të shkonin në shtëpi, por aty ku ishin, prenë pjesët e tepërta të rrobave dhe me to mbuluan pjesët e duhura të trupit. (Buhari, Tefsir, 24/12; Ebu Davud, Libas, 31-33/4102.)

Sipas një transmetimi të Safijje binti Shejbe ﷺ, kur zbritën ajetet e lartpërmendura, burrat u kthyen në shtëpitë e tyre dhe ua lexuan këto ajete grave, motrave dhe të gjitha femrave të farefisit. Menjëherë të gjitha gratë morën veshjet e tyre më të bukura, i bënë mbulesa, me të cilat u mbuluan nga lart poshtë. Në këtë mënyrë ata i miratuan menjëherë parimet që Allahu i Lartmadhëruar kish zbritur duke treguar kështu besimin e tyre me shpirt. Në namazin e sabahut ato siç ishin të mbuluara fund e krye, zunë një saf pas Pejgamberit ﷺ. (Ibn-i Kethir, Tefsir, [Nur, 31])

Shoqëria e Epokës së Lumturisë ishte shumë e kujdesshme edhe përsa i përket mosmarrëveshjeve mes grave dhe burrave. Pra gratë dhe burrat që s'njiheshin me njëri-tjetrin nuk rrinin së bashku në mënyrë që mos të viheshin në pozicione të vështira. Në jetën sociale kishte përherë një distancë mes burrit dhe gruas dhe në marrëdhënie me njëri-tjetrin silleshin me masë dhe ishin mjaft të disiplinuar. Islami siç ka ndaluar të këqijat, si një nga parimet e tij, ashtu ka ndaluar edhe sjelljet që të çojnë drejt këtyre të këqijave, duke vendosur kështu një distancë



të madhe mes njerëzve dhe të këqijave dhe duke mbyllur në këtë mënyrë edhe rrugët që të çojnë drejt këtyre gabimeve.

Islami, megjithëse i ka dhënë një rëndësi të madhe faljes me xhemat të namazeve dhe posaçërisht të namazit të Xhumasë, për të penguar keqkuptimet mes grave dhe burrave, gratë i ka përjashtuar nga ky detyrim duke u bërë të ditur se për to është më me vlerë falja e këtyre namazeve në shtëpitë e tyre se në xhami.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

*“Mesxhidet më me vlerë të grave janë qoshkat e shtëpive të tyre.”* (Ahmed, VI, 297)

I Dërguari i Allahut ﷺ nuk i ka penguar ato gra të cilat duan të vijnë në xhami, përkundrazi i ka lejuar. I ka urdhëruar që, kur të vijnë në xhami, të mos falen së bashku me burrat, por prapa tyre.

I Dërguari i Allahut ﷺ me të përfunduar namazin priste për pak çaste deri sa gratë të shpërndahehin dhe të shkonin në shtëpitë e tyre, në mënyrë që gratë dhe burrat të mos përziheshin me njëri-tjetrin, dhe më pas ngrihej edhe ai vetë, ndërsa burrat e ndiqnin nga pas. Në mënyrë të veçantë, namazi i sabahut falej pa aguar dita, kështu që gratë, me të dhënë selam ngriheshin menjëherë, mbështilleshin dhe shkonin në shtëpitë e tyre dhe kështu askush



nuk i njihete, madje ato s'arrinin të njihnin as njëra-tjetrën.<sup>67</sup>

I Dërguari i Allahut ﷺ në lidhje me një derë të Mesxhid-i Nebevi (Mesxhidi i Profetit ﷺ) pati thënë:

- *Sikur ta linim një derë për gratë! Dhe që në atë moment e tutje, burrat nuk e patën përdorur më atë derë.* (Ebu Davud, Selat, 53/571.)

Gratë vinin edhe në namazin e Bajramit, por vendi i tyre në xhami ishte veç. I Dërguari i Allahut ﷺ me të përfunduar hutben për burrat, u shkante grave pranë dhe u jepte edhe atyre këshilla. (Buhari, Ijdejn, 7-8.)

Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ vuri re, teksa po dilte nga xhamia, se gratë qenë përzier me burrat, i thirri ato dhe u tha:

- *Largohuni! Mos ecni në mes të rrugës, por anash! Më pas gratë nisën të ecnin anash rrugës, ngjitur me mure dhe në mënyrë të atillë sa veshjet e tyre u ngjiteshin për mure.* (Ebu Davud, Edep, 167-168/5272.)

Aishe ؓ në kohën e Emevive, kur pati parë gratë me burrat së bashku, pati thënë:

Nëse do i shihte i Dërguari i Allahut ﷺ bëmat e

---

67. Shihni: Buhari, Ezan, 162-166.



grave, në këtë rast do i ndalonte ato sikurse ndaloi gratë e bijve të Israilit nga xhamia. (Buhari, Ezan, 163)

### **S'u mungonte buzëqeshja**

Dikush pyeti **Sufjan bin Ujajne** (v. 198 h):

- A është shakaja diçka e turpshme? Ja si qe përgjigjur:

- Pse të jetë turp, përkundrazi është sunet. Pasi i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

*- Unë bëj shaka, por përherë them të drejtën!*

(Nuvejri, Nihajetu'l Ereb fi fununi'l Edeb, Kahire, IV, 2.)

Pra të bësh shaka është sunet, por pa lënduar askënd, përkundrazi duhet fituar zemra e tjetrit.

**Ibn-i Kajim el-Xhevzij** (v. 751) pati thënë:

- I Dërguari i Allahut ﷺ bënte shaka dhe në këto raste thoshte përherë të vërtetën. Edhe kur fliste me nënkuptime thoshte vetëm të vërtetën.


(Ibn-i Kajim el-Xhevzij, Zadu'l Mead, 1, 58.)


Sahabët e Profetit ﷺ ishin njerëz plot energji dhe të hareshëm. Ata e dinin mjaft mirë se si dhe ku do vepronin. Kur nevojitej, flisnin me sarkazëm, me nënkuptime dhe bënë shaka, e kur nevojitej flisnin edhe seriozisht. Bënë një jetë të ekuilibruar dhe tregoheshin të kujdesshëm ndaj gjërave të tepërta.








Bekir bin Abdullah  thotë:


- Sahabët e të Dërguarit të Allahut  bënin shaka me njëri-tjetrin, por kur kishin punë të rëndësishme, bëheshin seriozë dhe i përkushtoheshin maksimalisht punës. (Buhari, el-Edebu'l Mufred, nr. 266)

Ebu Seleme bin Abdurrahman  e tregon kë-shtu pozicionin e sahabëve:

- Sahabët e të Dërguarit të Allahut  nuk ishin njerëz të mbyllur dhe të vetmuar. Ata lexonin poezi në mesxhide dhe flisnin për periudhën e injorancës, por kur dikush merrej me ndonjë çështje fetare, ishte tepër serioz sa humbiste edhe veten. (Pra atë punë e merrte me shumë seriozitet.) (Buhari, el-Edebu'l Mufred, nr. 555.)

Sabit bin Ubejd  thotë:

- Nuk kam parë njeri më të hareshëm dhe më të këndshëm në biseda se **Zejd bin Thabit**  kur rrinte me njerëzit. (Buhari, el-Edebu'l Mufred, nr. 286.)

Omeri  po shihte një bedevi tek po falte namazin shumë shpejt dhe shkurt dhe menjëherë dëgjoi të bënte një lutje të tillë:

O Zoti im! Më marto me hyrijet e xhenetit!

Ndërkaq buzëqeshi dhe tha:

O zotëri, edhe pagove pak edhe shpërblimin e do të madh. (Nuvejri, Nihajetu'l Ereb, IV, 3)



Sipas një transmetimi të **Ebu Bekir es-Sakafi**, sahabët lexonin pak Kuran e pak poezi. (Ketani, et-Teratib, II, 236.)

**Ibn-i Abbasi** رضي الله عنه, kur ulej së bashku me nxënësit e tij, transmetonte për pak kohë hadithe dhe më pas vijonte:

- Lëvizni pak! Pra bëni shaka, lexoni poezi, padyshim që edhe shpirti është mërziur sikurse dhe trupi. Dhe niste të tregonte problemet e arabëve. Më pas i rikthehej sërishit mësimi dhe kështu, sa herë që e shihte të nevojshme, i rikthehej sërish humorit. (Ketavi, et-Tevatib, II, 237.)

Kur Ebu'd Derda رضي الله عنه thoshte diçka, patjetër buzëqeshte. Një ditë e shoqja i thotë:

Kam frikë se një ditë do të të turpërojnë njerëzit.

- I Dërguari i Allahut ﷺ kur thoshte diçka patjetër buzëqeshte, ia ktheu ai. (Ahmed, V, 198, 199)

**Abdullah bin Muhammed** رضي الله عنه prej Tabiinëve, kishte një natyrë shumë gazmore. Madje i kishte bërë shaka edhe hallës së tij Aishes رضي الله عنها, kur ajo rënkonte në shtrat në momentet e fundit të jetës së saj. Kur Aishja رضي الله عنها ndodhej në këtë gjendje, Abdullahu رضي الله عنه shkoi ta vizitonte dhe e pyeti:

- Nëna ime! T'u bëfsha kurban, si ndihesh?



Aishja ﷺ qe përgjigjur:

- Vallahi kjo është një çështje vdekjeje.

Abdullahi ia kthen me shaka:

- Atëherë s'është ndonjë gjë shumë e rëndësishme.

Aishja ﷺ e ndodhur në këtë situatë ia kthen:

- Ti s'do heqësh dorë asnjëherë nga kjo natyrë që ke! (Ibn-i Sa'd, VIII, 76.)





## PËRFUNDIM

I Dërguari i Allahut ﷺ u bë mëshirë për gjithë njerëzimin, madje për të gjitha krijesat në gjithësi. Me ardhjen e Pejgamberit ﷺ u ndriçuan errësirat e botës dhe lindi kështu një mëngjes i ri, të cilin njerëzimi e priste. Zemrat u ndriçuan, u zgjerua largpamësia, u ndërpre në mjegullitë e jetës. Me begatinë e atij Pejgamberi të Lartësuar, bota arriti në një pranverë të përjetshme. Ai e çoi njeriun në nderin e vërtetë, e drejtoi atë për në mirësi dhe drejtësi. Ai ia mësoi të fshehtë të jetës dhe të përjetësisë.

Ai Pejgamber i Lartësuar, erdhi në një shoqëri të paarsimuar, por me Librin Hyjnor që solli, u bë burim drite për bibliotekat e botës. Ai i mbushi shpirtat e njerëzve me urtësi, të fshehta dhe dije. Me ardhjen e atij Libri të Bekuar nisi t'u mësonte njerëzve të vërtetën e Zotit.

Ishte ai Pejgamber i Mëshirës, i cili na i paraqiti faqet e librit të kësaj gjithësie të pafjalë. Ai u bë referencë e dhikrit dhe e tesbihatëve të gjuhëve të fshehta dhe të panjohura. Ai u bë udhërrëfyes shpirtëror i sa e sa shoqërive që kishin humbur tiparet



njerëzore, të zhytur në një jetë kafshërore, duke i kthyer zemrat dhe shpirtrat e tyre drejt tipareve të vërteta njerëzore dhe nderit.

Allahu i Lartmadhëruar e kishte ekspozuar modelin e “njeriut të pjekur” të Islamit në personalitetin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Atë e bëri një personalitet shembull për gjithë njerëzimin. Morali i bukur dhe i lartë që pasqyrohet nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve që pëlqen Allahu ﷻ iu prezantua njerëzimit me gjuhën dhe praktikën e bekuar të Profetit ﷺ.

Si përgjigje të atyre që pyetën lidhur me moralin e të Dërguarit të Allahut ﷺ, Aishja ؓ pati thënë:

*Morali i Tij është vetë Kurani.* (Muslim, Musafirin, 139)

Profeti u bë një lloj tefsiri aktiv i Kuranit të zbritur në zemrën e tij gjatë jetës, e cila natyrshëm ishte një Kuran i gjallë. Allahu i Lartmadhëruar në Kuran thotë:

**“Dhe se ti, pa dyshim do të kesh shpërblim të pandërprerë! Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!”** (el-Kalem, 3-4)

Shembulli më i mirë i moralit për gjithë njerëzimin është Profeti ﷺ, ndërsa ndjekësit më të mirë janë sahabët dhe miqtë e ngushtë të Allahut ﷻ. Vetë besimtarët, të cilët jetojnë duke e kuptuar fuqinë që të jep ndjekja e gjurmëve të tij, kanë arritur një moral të lartë në përputhje me nderin njerëzor.



Sahabët i kanë mbushur shpirtat e tyre me dashurinë për të, duke iu bindur në çdo aspekt dhe duke u edukuar me moralin e Tij, duke u bërë pjesë e shpërblimit të Allahut ﷻ.

Në Kuran thuhet:

**“All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej en-sarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhenete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh.”** (Tevbe, 100)

Ne tashmë nuk kemi mundësi të zotërojmë shkallën e sahabëve. Por kemi mundësi të jemi prej atyre besimtarëve siç tregohet në ajetin kuranor: **“Kush u bindet atyre me mirësi”** dhe kështu të fitojmë pëlqimin e Allahut ﷻ. Ata që na e kanë pasqyruar më së miri jetën e Profetit ﷺ pas sahabëve, kanë qenë miqtë e ngushtë të Allahut ﷻ të cilët na i shfaq si shembull për ne. Ata janë në një shkallë mjaft të lartë siç thuhet në ajetin kuranor:

**“E dini se tek miqtë e ngushtë të Allahut ﷻ nuk ekziston frika. As që nuk do mërzhiten.”** (Junus, 62) Për të qenë pjesë e urdhëresave hyjnore është e nevojshme të ecim pas gjurmëve të këtyre miqve të ngushtë të Allahut ﷻ.



Nisur nga fakti që sahabët dhe miqtë e ngushtë të Allahut ﷺ janë bërë një me Pejgamberin ﷺ, duke marrë pjesë nga personaliteti i tij i bekuar, çdo sjellje e bukur dhe e hijshme që transmetuan gjatë gjithë jetës së tyre, në fakt përbëjnë shembuj të virtyteve të larta që pasqyrojnë morali i tij i lartë. Atje ku ka diçka të hijshme, prej atje ka edhe një prurje. Nuk ka lule që çel në këtë botë, që të mos jetë pjesë e dritës së tij! Është ai arsyeja për të cilin ne ekzistojmë... Ai është një gonxhe hyjnore që s'vëshket, përkundrazi dita ditës bëhet akoma edhe më e freskët dhe origjinale.

Edhe ne si ymeti i Muhamedit ﷺ jemi të detyruar të edukohemi me moralin e tij të Lartë dhe të ngrohemi me dashurinë për të, sikurse sahabët dhe pasardhësit e tyre Tabiinët. Megjithëse kanë kaluar shekuj, duhet të përpiqemi të jetojmë ato momente të këndshme, të cilat i bënë të paharrueshëm ata. Pasi ky është edhe kushti për të qenë ymet i këtij Pejgamberi.

Falënderimet i qofshin Allahut ﷻ, i cili na bëri të mundur të jemi ymeti i këtij Profeti. Rruga që të çon drejt së vërtetës së kësaj dhuntie hyjnore duke të bërë pjesë e “Vëllazërimit” dhe dashurisë peygamberore është mbështetja në Sunetin e tij dhe edukimi me moralin e tij.



syryn tonë të thjeshtë të Dërguarin e Allahut ﷺ si një krijesë e mrekullueshme dhe moralin e tij të Lartë, pasi përshtypjet e marra nga kjo botë mbeten të pamjaftueshme për ta konceptuar atë. Ashtu sikurse nuk është e mundur ta hedhim një det të tërë në një gotë, ashtu nuk është e mundur ta konceptojmë me përpikmëri Pejgamberin ﷺ. Çdo fjalë e dalë nga goja për të shpjeguar atë dhe Epokën e Lumturisë, s’janë gjë tjetër veçse thërmija hisesh që pasqyrohen nga hijeshitë e pashoqe të tij drejt konceptimit tonë të pafuqishëm.

**O Zoti im! Na mundëso t’i mbushim zemrat me hise nga morali i lartë dhe bota shpirtërore e Pejgamberit tonë! Na i mbush shpirtrat me ndjesitë e thella shpirtërore që thonë: “nëna, babai dhe shpirti im të qofshin falë!” o i Dërguari i Allahut!**

**Amin!..**





# PËRMBAJTJA

PARATHËNIE .....	5
SHOQËRIA E EPOKËS SË LUMTURISË .....	9
Parimet e besimit të Kohës së Injorancës e poshtëronin njeriun .....	11
Adhurimet dhe veprat qenë bërë kurban të interesave të së përbotshmes .....	16
Cilësitë e pashmangshme morale qenë të distancuara nga e vërteta .....	16
Mrekullia e madhe e Pejgamberit ﷺ: Njeriu i Epokës së Lumturisë .....	22
U formuan njerëz të paharrueshëm .....	23
Ç'kishin marrë Sahabët nga i Dërguari i Allahut ﷺ? .....	25
Islami u përhap me të shpejtë sikurse agimi i mëngjesit .....	26
U thelluan ndjenjat .....	28
Mendja dhe zemra ishin në harmoni të plotë .....	30



U zgjerua meditari .....	32
Predikimi u bë puna që u jepte më shumë kënaqësi në jetën e tyre .....	33
U mbështetën fort tek Kurani .....	35
Cilët qenë faktorët që i drejtuan sahabët drejt Kuranit? .....	37
I gjithë njerëzimi i admiroi .....	38
Etika Islame nuk qe sipërfaqësore, por praktike .....	39
<b>NDJESIA E BESIMIT</b> .....	43
Ata nxituan të bëheshin pjesë e parimeve Islame .....	46
Për hir të besimit nuk hezituan të jepnin as jetën .....	47
Ata morën rrugën e hixhretit dhe të xihadit për të mbrojtur besimin e tyre .....	53
<b>ENTUZIAZMI I ADHURIMIT</b> .....	59
Tregoheshin të kujdesshëm të ishin përherë me abdest .....	61
Namazi ishte drita e syve të tyre .....	65
Nuk ngeleshin pas xhematit .....	68
Zekatin e jepnin me kënaqësi .....	70



Infaku dhe tasaduku ishin boshti i jetës së tyre .....	75
E kishin kuptuar se s'ka të ngjashëm me agjërimin .....	80
Ata jepnin jetën për të kryer haxhin dhe umren .....	84
I jepnin rëndësi mësimit të Kuranit dhe haditheve .....	88
Ata shëroheshin me begatitë e Kuranit .....	95
Ngriheshin në mesin e natës dhe pendoheshin ...	98
Ata dridheshin kur kryenin adhurimet .....	102
Ata garonin në mirësi .....	103
Ata e ndiqnin sunetin hap pas hapi .....	105
<b>MATURIA ETIKE</b> .....	113
Ata ishin shumë modestë .....	116
Ata ishin si një det i gjerë mëshire .....	117
Kënaqeshin kur falnin për hir të Allahut ﷻ .....	121
Ata ishin pjesë e cilësive të Pejgamberit el-Emin (I sigurtë) dhe es-Sadik (besnik) .....	126
Ata ishin sikurse erërat mëshiruese të begatshme në bujari dhe altruizëm .....	129



I shmangeshin shpërdorimit .....	132
<b>JETA SOCIALE</b> .....	135
I dhanë rëndësi Arsimit Islam .....	137
Ata shfaqën një drejtësi të paparë në marrëdhëniet tregëtare .....	138
Ata u bënë të njohur edhe për vëllazëri .....	139
Në shoqëri mbizotëronte finesa, mirësjellja dhe eleganca .....	145
Ata ishin të edukuar dhe të ndershëm .....	148
S’u mungonte buzëqeshja .....	152
<b>PËRFUNDIM</b> .....	157

